

Nëntor 2022
Numri: 176
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.progresibotime.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

I DËRGUARI I ALLAHUT

DHURATA MË E MADHE



revistaetika



progresibotime

Fjala më e bukur është Libri i Allahut. Rruga më e mirë është sunneti profetik. Streha më e sigurt është devotshmëria. Të folurit më me virtyt është përmendja e Allahut.

Tregimet më të bukura gjenden në Kuran. Rrugët më të ndritura janë rrugët udhëzuese të profetëve.

Dija më e mirë dhe më e dobishme, është ajo që kthehet në kulturë. Justifikimi më i keq është ai që bëhet në momentin e vdekjes. Pendimi më i keq, është ai në ditën e kiametit. Pasuria më e mirë, është ajo e zemrës.



Besimtarët janë në trupa të ndryshëm, ata janë të detyruar ta konsiderojnë njëri-tjetrin si organet e një trupi që jetojnë me një zemër të vetme. Ashtu siç i gjithë trupi e ndjen dhimbjen e një organi, edhe perceptimi i vuajtjeve të vëllezërve të fesë, është një sprovë ndërgjegjeje për të gjithë besimtarët.

Allahu i Lartëmadhëruar i ka krijuar njerëzit nevojtarë ndaj njeri-tjetrit. Shoqëria, ashtu si ka klasën e pasur dhe të fortë, ka e do të ketë gjithmonë edhe klasën e të dobtëve, të njerëzve me probleme shëndetësore dhe të nevojtarëve. Ne duhet të pyesim veten: "Pse i krijoi Allahu i Lartëmadhëruar nevojtarët?" Përgjigjja dihet: "Nevojtarët janë amanet i Allahut (xh.sh.), që ua ka lënë jonevojtarëve." Këtë përgjegjësi e ka dhënë Vetë Allahu.



“Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u sollti një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kuranin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare), edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar.” (Alu Imran, 164)

Karakteristikat e Profetit të shprehura në ajet janë gjithashtu një shpjegim se çfarë lloj udhërrëfyese jete dhe planprogrami përgjatë gjithë jetës është bibliografia e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Bibliografia e Hz. Pejgamberit së pari na bashkon me ajetet e Allahut (xh.xh.), sepse jeta e Profetit (a.s.), është interpretimi i Kuranit Fisnik. Kurani është zbritur në zemrën e tij (a.s.). Një jetë e bërë me një zemër të brumosur nga Kurani Fisnik është një jetë në të cilën libri dhe urtësia gjenden në qendër. Libri është udhërrëfyese dhe mëshirë: ***“Ne ta kemi zbritur ty Librin, vetëm që ti t’u sqarosh atyre çështjet, për të cilat ata nuk pajtoheshin, si dhe që të jetë udhërrëfyese e mëshirë për njerëzit që besojnë.”*** (Nahl, 64)

Mësimi i jetës së Profetit (a.s.). Kurani e shpreh këtë në një ajet tjetër siç vijon: ***“Dhe atyre që ndjekin të Dërguarin Tonë, Profetin që nuk di shkrim e lexim, të cilin ata do ta gjejnë të shënuar në shkrimet e tyre, në Teurat dhe Ungjill. Ai do t’i urdhërojë ata të bëjnë vepra të mira dhe do t’i ndalojë nga të këqijat; do t’ua lejojë të mirat e do t’ua ndalojë të këqijat, duke i liruar nga barrët e rënda dhe vështirësitë që kanë pasur. Prandaj, ata që do ta besojnë, përkrahin dhe nderojnë atë, duke ndjekur dritën që është zbritur me të, pikërisht ata janë të fituarit.”*** (A’raf, 157)

Leximi i tij, leximi rreth Tij dhe të qenët me të kanë nivelet e veta të veçanta për çdo besimtar. Duke marrë parasysh se çdo rob mund të ketë nivele të ndryshme për sa i përket të djeshmes, të sotmes dhe të nesërme, mund të kuptohet lehtësisht se leximi i figurës së Profetit të Mëshirës, i cili u dërgua si mëshirë për botët, është një edukim i përjetshëm. Në kuptimin e kësaj bote, çdo edukim mund të mos prodhojë një rezultat të dobishëm. Mirëpo, nëse merret parasysh se ajeti që duhet lexuar nga njerëzit dhe se argumenti më madhështor dhe më i lartë i botës së njerëzimit është Hatemu’l-Enbija (Vula e Profetëve) sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, vështirësia e leximit të një ajeti të tillë dhe nderimi i tij, dhe sikundër kësaj, nderi dhe madhështia e interesit për ta bërë këtë nuk mund të krahasohet me asgjë. Lutja jonë ndaj Zotit (xh. xh.), është që të na japë begati edhe në këtë rrugë!

Nëntor 2022

VITI: XVI

NUMRI: 176

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 75 44226

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

ËËBSITE

ëëë.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VIJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.



Lindja e diellit në zemra
Dr. Murat Kaja

12

Përmbajtja




8

Të lexosh të Dërguarin e Allahut (a.s.)
Dr. Adem Ergyl




Korniza e personalitetit të besimtarit
Ahmet Tashgetiren

18




12

32



Rreth biografisë së
të Dërguarit të Allahut (a.s.)
Osman Nuri Topbash

- 5 Bibliografia e të dërguarit të Allahut
Kurrikula e jetës sonë
Mehmet Lutfi Arslan
- 10 Leximi në emër të Zotit,
edukimi me besmele
Prof. dr. Sulejman Derin
- 14 Ja, kjo është rruga ime e drejtë
Iskender Karajigit
- 16 Së pari, baza dhe mjedisi i shëndetshëm
Ali Riza Temel
- 20 Atyre që u zbardhet fytyra
me lutjen e Profetit (a.s.)
Abdullah Sert
- 22 Të jesh Karuni i dijës
Halit Serhan Erxhivelek
- 24 Sa më shumë japim,
aq më shumë ekzistojmë
Bestami Jazgan



26

- Dinjiteti njerëzor 26
Muhammad Hashim Kamali
- Rreziku i fshehur në ekrane: Drita Blu 31
Ramazan Maden
- Metodologjia e arsyetimit të Kuranit 44
Ibrahim Arpaxhë
- Pyetje rreth Koronavirusit 46
Doç. dr. Fërat Erdoan
- Shëndeti dhe mendja janë në rrezik 48
Fatma H. Saëm
- Një mik i vërtetë rend për të të ndihmuar
edhe në botën tjetër 55
M. Sami Ramazanollu
- A ekziston te fëmija ynë 56
vështirësia për të mësuar?
Psik. Tuba Sokmen

40

Mezashi i Kuranit
Abdullah Draz



Degë xheneti që zgjaten deri në këtë botë
Seher Ajdën

52

I DËRGUARIT TË ALLAHUT

DHURATA MË E MADHE

— Mehmet Lutfi Arsllan —

Të gjithë ne jemi studentë që marrim mësim në shkollën e jetës. Synimi ynë është që në çdo rrethanë të vdesim si myslimanë dhe horizonti (qëllimi) ynë është që të arrijmë lavdërimin hyjnor «sa rob i bukur». Periudha jonë e shkollimit do të vazhdojë përgjatë gjithë jetës dhe certifikata e diplomimit do të na jepet në frymën e fundit. Kurrikula e përbashkët e kësaj shkolle, ku secilit i jepet një arsim unik, është Sijeri Nebi (Bibliografia e të Dërguarit të Allahut). Jeta e kryemësuesit të shkollës sonë, të Dërguarit të Allahut, alejhi's-salam, është një udhërrëfyese se si duhet ta bëjmë jetën tonë. Ky udhëzues, i cili na është dhënë si një mirësi e mëshirës së Zotit (xh.xh.), përmban mësim thelbësorë që na tregojnë se si bëhet një jetë në të cilën do të dëshmojmë për njerëzit e tjerë dhe në të cilën Profeti (a.s.), do të dëshmojë për ne.


Kuptimi leksikor i fjalës Sijer është rrugë, sjellje, gjendje, histori jete dhe është shumësi i fjalës Siret. Në një kuptim të veçantë, sijeri është bibliografia e jetës së pastër dhe të bekuar të të Dërguarit të Allahut (a.s.), e cila është përcaktuar deri në detajet më të vogla. Ajo bibliografi është drita jonë, udhërrëfyese ynë dhe bekimi më i madh hyjnor mbi ne: *“Allahu u ka dhënë be-*

simtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kuranin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare), edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar.” (Alu Imran, 164)

Karakteristikat e Profetit të shprehura në ajet janë gjithashtu një shpjegim se çfarë lloj udhërrëfyese jete dhe planprogrami përgjatë gjithë jetës është bibliografia e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Bibliografia e Hz. Pejgamberit së pari na bashkon me ajetet e Allahut (xh.xh.), sepse jeta e Profetit (a.s.), është interpretimi i Kuranit Fisnik. Kurani është zbritur në zemrën e tij (a.s.). Një jetë e bërë me një zemër të brumosur nga Kurani Fisnik është një jetë në të cilën libri dhe urtësia gjenden në qendër. Libri është udhërrëfyese dhe mëshirë: *“Ne ta kemi zbritur ty Librin, vetëm që ti t’u sqarosh atyre çështjet, për të cilat ata nuk pajtoheshin, si dhe që të jetë udhërrëfyese e mëshirë për njerëzit që besojnë.»* (Nahl, 64) Edhe Sijeri Nebi (bibliografia e të Dërguarit të Allahut) është mëshirë për botët dhe shembulli më i mirë i Pejgamberit tonë, i cili është udhërrëfyese dhe mëshirë për mbarë njerëzimin.

Sijeri është një mjet pastrimi. Kurani e shpreh këtë në një ajet tjetër siç vijon: *“Dhe atyre që ndjekin të Dërguarin Tonë, Profetin që nuk di shkrim e lexim, të cilin ata do ta gjejnë të shënuar në shkrimet e tyre, në Teurat dhe Ungjill. Ai do t’i urdhërojë ata të bëjnë vepra të mira dhe do t’i ndalojë nga të këqijat; do t’ua lejojë të mirat e do t’ua ndalojë të këqijat, duke i liruar nga barrët*





Sireti i tij, pra mënyra e veprimit dhe e punës së tij, është një qëndrim shembullor njerëzor. Ky qëndrim përbëhet nga parimet e thjeshtësisë dhe qartësisë që mund të zbatohen në çdo kohë dhe terren. Këto parime, të cilat do ta udhëheqin njerëzimin deri në Ditën e Gjykimit, bazohen në natyrshmërinë njerëzore dhe burojnë nga ndërgjegjja.

e rënda dhe vështirësitë që kanë pasur. Prandaj, ata që do ta besojnë, përkrahin dhe nderojnë atë, duke ndjekur dritën që është zbritur me të, pikërisht ata janë të fituarit.” (A’raf, 157)

Sijeri është një shembull i bazuar në parime që i formojnë sjelljet dhe qëndrimet harmonike. I Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, pas këshillave si mbajtja e flamurit fort dhe mos prekja e grave dhe fëmijëve përgjatë dërgimit të ushtrisë nën komandën e Abdurrahman ibn Afit, e përfundoi fjalën e tij duke u shprehur: «Ky është sireti (moral) i të Dërguarit të Tij në mesin tuaj.» Sireti i tij, pra mënyra e veprimit dhe e punës së tij, është një qëndrim shembullor njerëzor. Ky qëndrim përbëhet nga parimet e thjeshtësisë dhe qartësisë që mund të zbatohen në çdo kohë dhe terren. Këto parime, të cilat do ta udhëheqin njerëzimin deri në Ditën e Gjykimit, bazohen në natyrshmërinë njerëzore dhe burojnë nga ndërgjegjja. Për këtë arsye, nuk e humbin kurrë rolin dhe kuptimin e tyre si shembull. Ato arrijnë në zemër, jo vetëm në mendje, sepse ato janë përjetuar, janë provuar dhe janë vërtetuar se të bëjnë të lumtur.

Bibliografia e të Dërguarit të Allahut (a.s.), përbëhet nga katër pjesë që duhet të tërheqin vëmendjen tonë si një kurrikulë e përjetshme. E para prej tyre

është lidhja ndërmjet Kuranit Fisnik dhe të Dërguarit të Allahut (a.s.). Si e thuri Kurani jetën e zotërisë së njerëzimit në zemrën e të cilit zbriti? Ne mund t’i përgjigjemi kësaj pyetjeje vetëm duke e vendosur këtë lidhje në axhendën tonë. Cili është raporti mes librit dhe njeriut që i drejtohet i pari ky libër? Çfarë do të thotë ta kesh zemrën të mbrujtur për 23 vjet me një libër që përfshihet në çdo moment të jetës tënde? Shkaqet e shpalljes së ajeteve dhe përvojat që pasuan do të na tregojnë rrugën drejt përgjigjeve të këtyre pyetjeve. Pjesa jonë e kësaj marrëdhënieje, e cila në njërin anë ka komplimentin: «**Vërtet ti ke një moral të lartë.**» (Kalem, 4) dhe në anën tjetër paralajmërimin: «**Allahu të faltë!..**» (Teube, 43), është aq sa kërkojmë ringjalljen e jetës sonë me bibliografinë profetike. Nuk mund të interesohemi pa kërkuar, nuk mund të mësojmë pa u interesuar, nuk mund të dimë pa mësuar dhe nuk mund të duam pa ditur.

Pjesa e dytë e bibliografisë profetike përbëhet nga marrëdhëniet e të Dërguarit të Allahut (a.s.), me njerëzit e tjerë si qenie njerëzore. Ai u dërgua si mëshirë për botët. Adresa e vetme e së vërtetës që i nevojitet gjithë njerëzimit është tek Ai. Është e vetëkuptueshme se çfarë përgjegjësie e madhe është kjo për një njeri. Në këtë kontekst, Sijeri Nebi është formuar me një përmbajtje që do të mbajë barrën e rëndë dhe të madhe të së vërtetës. Si një shfaqje e mrekullueshme e Zotit (xh.xh.), Sijeri Nebi është një kombinim i mrekullueshëm i poleve të kundërta të përvojës njerëzore. Ai, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, është zotëria i njerëzve, por ai u trajtua si jetim derisa arriti pjekurinë. Ai është më fisniku i njerëzve, por nuk ka harruar kurrë se është djali i një gruaje mekase që ha mish të thatë. Erdhi me një mrekulli letrare, kundër së cilës njerëzit dhe xhinët janë të pafuqishëm, por analfabetizmit është atribut i tij. Ai është një strateg dhe një gjeni politik, por ai është një njeri që ka kohë për t’u kthyer në xhami me fytyrë të vrenjtur nga frika prej Zotit kur qielli errësohet ose era është e fortë. Në mbrëmje është njeriu më i pasur në botë, por në mëngjes nuk ka asnjë dërrhem me vete. Shembujt mund të shtohen. Shkurtimisht, i Nderuari ynë, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, si manifestimi i mrekullueshëm i Zotit në llojin njerëzor, posedon një jetë madhështore që do të jetë shembull për të gjithë njerëzit, nga më i ulëti tek më i larti, nga më i dituri deri tek më injoranti, nga më i varfëri tek më i pasuri, me madhështinë e tij të mbledhjes së të kundërtave. Ajo jetë është e vetmja foltore që duhet të shkojë dhe të gjunjëzohet para saj kushdo që dëshiron të arrijë të vërtetën e vet dhe të gjejë atë që dëshiron.

Pjesa e tretë e bibliografisë së të Dërguarit të Allahut (a.s.), përbëhet nga dëshmitë e sahabëve të nderuar, të cilët Kurani Fisnik i nderon me qëndrimin përreth Profetit duke i lavdëruar si «Ata që qëndrojnë me Të». Dëshmia e tyre është përtej shikimit, dëgjimit, kuptimit dhe dashurisë. Jetët e tyre, si yjet, u bënë përsosmëria e dëshmisë së tyre. Me këtë dëshmi, në të cilën mendja e shoqëron zemrën dhe dashuria është e stolitur me përpjekje e sakrificë, janë shfaqur jetë shembullore që i mahnitin ata që shohin dhe sahabët e nderuar, të cilët janë të kënaqur me Allahun dhe Allahu është i kënaqur me ta, morën një kompliment me të cilin u lartësuan si zotërinjtë e njerëzimit deri në Ditën e Gjykimit. Aq sa edhe të qenët së bashku me ta (tabiinët) ishte një horizont lartësimi për umetin Islam, madje edhe shoqërimi i atyre që ishin me ta (tabiinëve) nga (etbau't-tabiinët) konsiderohej në klasën e jetëve shembullore që dëshironte Allahu (xh.xh.).

Përveç Kuranit Fisnik dhe jetës së tij shembullore, ndoshta mrekullia më e madhe e të Dërguarit të Allahut, alejhi's-salam, është brezi i sahabëve që ai edukoi. Nuk është e mundur të përfitohet nga bibliografia profetike pa kuptuar qëndrimin dhe sjelljen e sahabëve. Brezi i sahabëve, secili prej të cilëve përfaqëson dallimet e njerëzimit si llamba që shkëlqejnë dhe që është manifestim i mëshirës në këtë kuptim, përbëhet nga figura shembullore nëpërmjet të cilave ne do të kërkojmë të vërtetën tonë specifike në kurrikulën e Sijerit. Ka sekrete për të vërtetën tonë në çdo sahab të Profetit që e lexojmë dhe kaplohemi nga ndikimi i tij. Në këtë aspekt, për shembull, hetimi i faktit se pse njëri prej nesh ndikohet nga Hz. Omeri dhe dikush tjetër ndien një afrim shpirtëror me Halid ibn Velidin, është jetike për sa i përket zbulimit të së vërtetës së vetes sonë. Cila ndodhi për sahabët, secili prej të cilëve është bërë një njeri horizont me prirje të ndryshme, na ka prekur në shpirt, cilat fjalë kanë lënë vend të pashlyeshëm në mendjet tona dhe cila skenë është gdhendur në zemrat tona, duhet parë si mundësi përparimi në edukimin dhe zhvillimin tonë të adhurimit ndaj Zotit (xh.xh.). Secili prej nesh që përqendrohet në këto çështje dhe ndjek pjesën e tij, do të arrijë distanca që nuk mund t'i përshkojë për vite me radhë në rrugën drejt së vërtetës së tij.

Pjesa e katërt e bibliografisë profetike përbëhet nga pjesët e mbledhura prej njerëzve me fat që u takuan me korpusin e sijerit dhe arritën të zhvillojnë tri përmbledhjet e mësipërme. Kjo është një shfaqje e së vërtetës që i Dërguari i Allahut (a.s.), e ka shprehur në Haxhin e tij Lamtumirës: *“Mëshira e*

Allahut qoftë mbi ata që e dëgjojnë dhe e kuptojnë mirë fjalën time sot! Ata që janë këtu le t'ua përcjellin fjalët e mia atyre që nuk janë. Mund të ndodhë që ai i cili informohet, t'i kuptojë më mirë se ai që gjendet këtu dhe të bindet.” (Musned, VII, 307, 330, 376; Buhari, «Haxh», 132, «Magazi», 78.)

Gjithmonë kanë ekzistuar, ekzistojnë dhe do të vazhdojnë të ekzistojnë ata që e kuptojnë më mirë sijerin dhe që i binden më mirë Pejgamberit (a.s.). Prandaj, një nga mënyrat për ta bërë bibliografinë profetike një kurrikulë të përjetshme është të kërkojen dhe të gjenden ata njerëz që e kanë kuptuar më së miri sijerin. Si u gjallëruan këta njerëz të lumtur me atë mirësi dhe si e zbukuruan jetën e tyre? Detyra jonë është të gjejmë përgjigjen e kësaj pyetjeje duke zbuluar lidhjen që ata kanë formuar me sijerin. Edhe pse duket si një jetë e jetuar dhe e përfunduar për 63 vjet, jeta e Profetit (a.s.), do të vazhdojë të jetë një horizont për njerëzimin me ndikimin e saj që do të zgjasë deri në Ditën e Gjykimit. Ata që përfitojnë siç duhet nga ky horizont janë trashëgimtarët e Profetit. Shndërrimi i bibliografisë së të Dërguarit të Allahut në një plan mësimor përgjatë gjithë jetës ka të bëjë pak edhe me takimin me trashëgimtarët e Profetit dhe me vazhdimin e rrugëtimit të adhurimit nën bekimet e tyre profetike deri në frymën e fundit.

Sijeri Nebi (bibliografia e të Dërguarit të Allahut) është një kurrikul që do ta mësojmë gjatë gjithë jetës sonë. Ne do të përpiqemi të gjejmë pjesën tonë në këtë kurrikul. Nuk ka vepër pa qëllim. Qëllimi i leximeve tona të sijerit është që të kërkojmë begatinë Muhamedane e cila do të bien në jetën tonë. Nëse nuk e vendosim zemrën pranë mendjes, nuk do të kemi produktivitet. Ne nuk duam vetëm të njohim, por edhe të dimë. Të njohësh është punë e mendjes, kurse të dish është punë e zemrës. Puna e mendjes është të kuptuarit, kurse puna e zemrës është miqësia. Të kuptuarit kërkon dorëzimin e së drejtës, kurse miqësia kërkon dorëzimin e zemrës. Nëse e njohim dhe e duam, do ta ndjekim atë. Ndërsa ndjekja e të Dërguarit të Allahut është mënyra më efektive për të tërhequr dashurinë e Allahut: *“Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.”* (Al Imran, 31) Mënyra që Allahu Teala të na dojë është ndjekja e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ajo që duhet bërë për ta ndjekur atë është e qartë: Bibliografia e të Dërguarit të Allahut (a.s.), duhet të jetë planprogrami ynë përgjatë gjithë jetës.

ÇELËSI I LEXIMIT TË SAKTË TË LIBRIT TË TË DËRGUARIT TË ALLAHUT (A.S.) ËSHTË NË RADHË TË PARË BESIMI. PASTAJ ËSHTË DASHURIA DHE MË PAS ËSHTË DORËZIMI. NDËRSA BESIMI, DASHURIA DHE DORËZIMI RRITEIN, SHKALLA DHE THELLËSIA E LEXIMIT DO TË RRITEIN NË PËRPUTHJE ME TO.

Të lexosh të Dërguarin e Allahut **TË LEXOSH RRETH TIJ DHE TË JESH ME TË**

— Dr. Adem Ergyl —

Përgjatë gjithë historisë së njerëzimit, të dërguarit e Allahut janë lexuar në mënyra të ndryshme. Ka pasur lexime mosbesimi, lexime me mendjemadhësi e zili, lexime skeptike, lexime të zakonshme, lexime përmes nefsit, lexime hipokrite, si dhe lexime besimtare, lexime të sinqerta dhe lexime me dashuri e dëlirësi. Të gjithë kanë marrë atë që u takon në raport me cilësinë e tij të leximit. Ndërsa ky bekim u ka hapur disave dyert e xhenetit të kësaj bote dhe të botës tjetër, të tjerëve u ka hapur dyert e xehenemit. Në këtë artikull do të tërheqim vëmendjen te temat edukative që duhet të marrim përgjatë jetës për të lexuar të Dërguarin e Allahut si besimtar, për të lexuar rreth tij, për të qenë me të dhe për t'u pjekur me të. Është e natyrshme që çdo titull të tregojë një përmbajtje të gjerë sa një libër. Leximi i të gjithëve do të jetë aq i gjerë sa horizonti i zemrës dhe thellësia e largpamësisë dhe vizionit të tyre. Atëherë, leximet e djeshme nuk do t'i zëvendësojnë leximet e sotme dhe të gjithë do të vazhdojnë të lexojnë përsëri e përsëri, ndërsa besimi dhe njohuritë e tyre do të rriten.

Po, çelësi i leximit të saktë të librit të të Dërguarit të Allahut (a.s.) është në radhë të parë besimi. Pastaj është dashuria dhe më pas është dorëzimi. Ndërsa besimi, dashuria dhe dorëzimi rriten, shkalla dhe thellësia e leximit do të rriten në përputhje me to. Më së miri është që të fillojmë leximin e të Dërguarit të Allahut me prezantimin e Zotit (xh.xh.), sepse,



Zoti është ai që na e prezanton dhe tregon habibin (të dashurin) dhe halilin (mikun) e Tij, pra, të Dërguarin e Tij. Për këtë temë janë shkruar vepra të veçanta. Ato duhet t'i gjejmë dhe t'i lexojmë. Vepra e Kadi Ijazit e titulluar Shifai Sherif mund të jetë një fillim në këtë drejtim. Nëse ajetet rreth Habibullahut (të dashurit të Allahut) do të renditeshin në një tablo me përpikmërinë e një veprë, do të ishte një edukim i mrekullueshëm për jetën tonë të adhurimit nëse do ta shikonim herë pas here dhe ta lexonim atë tablo sipas gjendjes së zemrës sonë.

Në këto tablo duhet të lexojmë jetën e tij, ngjarjet që ka përjetuar ai, qëndrimin e tij përballë çdo ngjarjeje, gjuhën e tij verbale, gjuhën e tij trupit dhe gjuhën e personalitetit të tij. Të lexojmë thellësinë e tij në adhurimin ndaj Allahut, nderimin dhe nënshtrimin e tij, dhikrin, idenë, frikën dhe dashurinë e tij. Të lexojmë mesazhin, ftesën dhe udhëzimin, mëshirën dhe dhembshurinë, dashurinë e pamasë, drejtësinë dhe mirësinë e tij ndaj njerëzve. Të arrijmë ta realizojmë këtë lexim me synimin edhe për të mësuar, edhe për ta shndërruar në jetë për ne, me ndjenjat e besimit, dorëzimit dhe admirimit të shoqëruar me dashuri. Për të qenë në gjendje që ta kryejmë këtë mënyrë të leximit, duhet të jemi të vetëdijshëm për njohuritë e jashtme dhe të jemi shpirtërisht pranë të Dërguarit të Allahut (a.s.). Edhe pse është e rëndësishme të synohet leximi i të gjithë



librave të hadithit të njohur si Kutubu's-Sitte, pasi kjo nuk është e mundur për shumë njerëz, leximi i Rijazu's-Salihinit¹ i Imam Neveviut dhe el-Edhkar² nga i njëjti autor, do të formonte një bazë të mirë. Për të thelluar orientimin tonë shpirtëror, një marrëdhënie me Habibullah (të Dashurin e Allahut) e përqendruar në salate dhe selame, duhet të jetë në gjendje të vazhdojë gjithnjë e më shumë.

Për të lexuar nga i Dërguari i Allahut, është e rëndësishme të pyesim, hulumtojmë dhe hetojmë nëse ai ka një fjalë, sjellje, këshillë apo shenjë në lidhje me çdo situatë që hasim. Një veprim i tillë do ta tërheqë mbi ne udhëzimin e veçantë të Zotit (xh.xh.). Më tej, do të na bashkojë me mirësinë e dashurisë hyjnore. Parapëlqimi i të kuptuarit të ajeteve të Allahut përmes interpretimit dhe shpjegimit të të Dërguarit të Allahut (a.s.), kundrejt kuptimeve të tjera, dhe pranimit i adhurimit e jetës siç na ka mësuar ai, është një mësim që mund të realizohet nga ata që e konsiderojnë nder të qenët nxënës i tij. Ata që e shpërfillin interpretimin e Kuranit dhe Sunetit nga Habibullahu me një qasje moderniste dhe historiciste, nuk do ta kenë një nder të tillë.

1. Kjo vepër është përgatitur nga profesorët tanë Prof. Dr. Jashar K - ndemiri, Prof. Dr. Ismail Lutfi Çakani dhe Prof. Dr. Rashit Kycyku në tetë vëllime dhe është botuar nga Botimet Erkam.

2. Kjo vepër është përgatitur në dy vëllime nga Prof. Dr. Jashar K - ndemiri dhe është botuar nga Botimet Tahil.

Siç është e rëndësishme të lexohen ajetet fisnike nga sytë dhe zemra e të Dërguarit të Allahut (a.s.), po ashtu është një domosdoshmëri e natyrshme e qëndrimit prej besimtari që t'i shikojmë ekzistencën dhe ngjarjet nga e njëjta dritare dhe t'i zbatojmë të njëjtat kriterë vlerësimi. Një pjekuri e tillë para së gjithash kërkon një nijet të sinqertë, besim të fortë, njohuri të shëndosha dhe largpamësi të thellë. Sa bekim hyjnor është për një rob që synon pëlqimin e Allahut, të jetë në gjendje të ulet në hallkën e një mësuesi të tillë për të vlerësuar saktë familjen, brezin, shoqërinë, shtetin, varfërinë, pasurinë, rininë, pleqërinë, shkurtimisht, jetën dhe vdekjen.

Qëllimi përfundimtar i leximit të tij dhe leximit rreth tij është, pa dyshim, që të arrijmë të shkojmë aq larg sa aftësitë dhe mundësitë tona për të qenë si ai, dhe në fund të jemi me të. Hapi i parë për realizimin e këtij qëllimi është imani i fortë dhe besimi i plotë në profecinë e tij, në qenien e tij Usvetun Hasene (shembull i shkëlqyer) dhe në udhëheqjen e tij. Baza e të qenët si ai kërkon vendosjen e themeleve të një afirmimi të tillë. Së dyti, është të realizojmë gjendjen e të qenët i vendosur për të imituar fjalët dhe veprimet e tij me admirim të shoqëruar me ndjenja respekti dhe nderimi për Të. Së treti, është të kërkojmë një dashuri që mund ta dojë atë edhe më shumë se jetën tonë. Sepse mënyra më e shkurtër dhe më efektive për ta pasuar atë ashtu është dashuria. Një mjet tjetër që e lehtëson punën tonë në rrugën për ta pasuar atë është t'i kushtojmë rëndësi unitetit fizik dhe shpirtëror me dijetarët dhe të urtët që janë trashëgimtarë të të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Leximi i tij, leximi rreth Tij dhe të qenët me të kanë nivelet e veta të veçanta për çdo besimtar. Duke marrë parasysh se çdo rob mund të ketë nivele të ndryshme për sa i përket të djeshmes, të sotmes dhe të nesërme, mund të kuptohet lehtësisht se leximi i figurës së Profetit të Mëshirës, i cili u dërgua si mëshirë për botët, është një edukim i përjetshëm. Në kuptimin e kësaj bote, çdo edukim mund të mos prodhojë një rezultat të dobishëm. Mirëpo, nëse merret parasysh se ajeti që duhet lexuar nga njerëzit dhe se argumenti më madhështor dhe më i lartë i botës së njerëzimit është Hatemu'l-Enbija (Vula e Profetëve) sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, vështirësia e leximit të një ajeti të tillë dhe nderimi i tij, dhe sikundër kësaj, nderi dhe madhështia e interesit për ta bërë këtë nuk mund të krahasohet me asgjë. Lutja jonë ndaj Zotit (xh.xh.), është që të na japë begati edhe në këtë rrugë!

LEXIMI NË EMËR TË ZOTIT, EDUKIMI ME BESMELE

— Ahmet Hamdi Jëlldërëm —

KUR ISHA STUDENT, ÇDO DITË NË PUSHIMIN E MBRËMJES SHIHJA PLEQTË E MOSHUAR QË BËNIN MËSIMET ME LIBRA NËN POLTRONË PËR TË PËRJETUAR SIHARIQIN E KËTIJ HADITHI. SHQETËSIMI I TYRE I VETËM ISHTE TA PËRFUNDONIN JETËN SI NXËNËS TË DIJES. NË FAKT, NË TRADITËN TONË TË LASHTË, DIJETARËT TANË SADO TË SHTYRË TË ISHIN NË MOSHË, NUK E KANË LËNË PAS DORE ÇËSHTJEN E KËRKIMIT TË DIJES DHE ARSIMIMIT.

Edhe pse i Dërguari i Allahut (a.s.), ishte analfabet, pra nuk dinte shkrim e këndim, shpallja e parë që i erdhi ishte: “Lexo!” Ky fakt është një çështje interesante. Meqenëse Allahu nuk e ngarkon robin e Tij me asgjë përtej fuqisë së vet, vallë çfarë do të thotë urdhri «lexo» që i erdhi të Dërguarit të Zotit në moshën dyzetvjeçare?

Ajeti i parë që erdhi urdhëroi leximin, por nuk përmend gjërat që duhen lexuar. Ai tregon qartë se çfarë lloj leximi duhet bërë dhe qëllimin e leximit. Kjo tregon se çdo lexim i bërë në një mënyrë të duhur dhe të orientuar drejt objektivit është i pranueshëm.

Ajetet që u shpallën së pari zbulojnë qartë edhe metodën, edhe qëllimin:

“Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka), e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku! Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh, i Cili, me anë të penës ia mësoi, ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte.” (Alak, 1-5)

Këtu synohet një lexim i bërë në emër të Allahut të Plotfuqishëm dhe që të bashkon me krijimin. Është e domosdoshme që ky lexim, i cili do të bëhet për të kuptuar qëllimin e krijimit, të jetë në çdo fazë të jetës. Sa shumë konciz shprehet Junus Emre, i cili e ka kuptuar këtë urtësi:





«Dija është dituri, dituria është njohja e vetvetes,

Nëse nuk e njeh veten, pse gjithë ai lexim?»

Ai që lexon dhe e njeh sekretin e krijimit, e kupton dobësinë e tij. Kështu, njeriu që e kalon hapin e parë, mund të zhytet në lexime të pafundme duke marrë fuqinë e tij nga Allahu, poseduesi i universit. Në fakt, myslimanët, të cilët e kanë këtë fuqi pas vetes, jo vetëm që kanë lexuar botën, por edhe kanë hetuar thellësitë e universit. Nisur nga ky aspekt, leximi i parë duhet të jetë një lexim subjektiv. Njeriu leximin subjektiv introvert e realizon përmes njohjes së vetes. Pastaj vjen leximi objektiv. Ky lexim, i quajtur lexim i jashtëm, përfshin të gjithë universin.

Së fundi, detyra që quhet lexim, e cila do të vazhdojë për aq kohë sa do të ekzistojë njeriu, do të vazhdojë përgjithmonë si një përpjekje për të njohur Allahun Teala.

UDHËZUESI I XHENETIT: LEXIMI/STUDIMI

Detyra kryesore e qenies njerëzore, e cila erdhi në tokë si zëvendse e Allahut dhe iu dha qëllimi për të rindërtuar botën, është adhurimi ndaj Zotit. Shpërblimi në jetën e përhershme i adhurimit në këtë botë është xheneti dhe më shumë. Kurse rruga për të shkuar në xhenet është edukimi përgjatë gjithë jetës. Hz. Pejgamberi thotë:

“Nëse dikush nis një rrugë për të marrë dituri, edhe Allahu do t’ia lehtësojë rrugën për në xhenet.” (Muslimi, Dhikr, 38; Ebu Davud, Ilim, 1; Tirmidhi, Ilim, 19.)

Kur isha student, çdo ditë në pushimin e mbrëmjes shihja pleqtë e moshuar që bënin mësim me libra nën poltronë për të përjetuar sihariqin e këtij hadithi. Shqetësimi i tyre i vetëm ishte ta përfundonin jetën si nxënës të dijes. Në fakt, në traditën tonë të lashtë, dijetarët tanë sado të shtyrë të ishin në moshë, nuk e kanë lënë pas dore çështjen e kërkimit të dijes dhe arsimimit. Ndërsa mësuesi im, Emin Saraç Efendi fliste për rëndësinë e dijes përgjatë gjithë jetës së tij, na tregonte se një nga dijetarët

tanë të mëdhenj, Muhamed Zahid el-Kevseri, i cili migroi nga Turqia në Egjipt - edhe pse ishte një dijetar i madh - merrte pjesë në mësimet el-Hidaje të Muhamed Bahit el-Mutiit, një prej dijetarëve të famshëm atje.

Është e qartë që çdo mysliman duhet të kërkojë dituri deri në frymën e tij të fundit. Megjithatë, që ky edukim të merret në mënyrë solide, duhet të jenë të pranishme pesë pikat e mëposhtme:

a) Nxënës i zellshëm: Çdo mysliman duhet të jetë i zellshëm për të mësuar fenë e tij.

b) Mësuesi i përgatitur: Falënderimi i takon Allahut që ende nuk po përjetojmë mungesë mësuesish në vendin tonë. Është detyra jonë që ta kërkojmë dhe gjejmë atë mësues të përgatitur.

c) Një program cilësor: Fillimi i çdo pune është metoda. Është thënë se ai që nuk ka metodë, nuk mund të arrijë askund. Prandaj, është e domosdoshme që aktiviteti edukues që do të kryhet të lidhet me një program. Kjo do të dalë në pah me përpjekjen e mësuesit. Ne që jemi nxënës duhet ta konsiderojmë si detyrë ndjekjen me rigorozitet të këtij programi.

d) Librat që na shpjen te synimi: Edukimi duhet të bazohet në libra, në mënyrë që të jetë i shëndetshëm. Në këtë çështje, zgjedhja e librit duhet të bëhet në mënyrë korrekte.

e) Një mjedis inkurajues: Realizimi i të gjitha kushteve të sipërpërmendura është i mundur vetëm nëse ekziston një mjedis që inkurajon leximin. Nuk është e mundur të kesh një arsim cilësor në një mjedis ku leximi dhe edukimi nuk inkurajohen.

Si përfundim mund të themi se; motoja më e rëndësishme që do të sigurojë inkurajimin e mjedisit shkencor deri në frymën e fundit është parimi: “Ose bëhu dijetar, ose bëhu nxënës, ose bëhu dëgjues, ose bëhu i dashuruar pas tyre. Mos u bëj një i pestë përveç këtyre, në mënyrë që të mos shkatërrosh.” Nëse shoqëria nuk inkurajohet të angazhohet në dituri, atëherë është e pashmangshme që kjo shoqëri të humbasë/të bjerë nga skena e historisë.



LINDJA E DIELLIT NË ZEMRA

— Dr. Murat Kaja —

I Dërguari i Allahut (a.s.), e filloi edukimin në shtëpinë e tij dhe e vazhdoi me familjen e mikut të tij më të ngushtë, Hz. Ebu Bekrit. Kur Allahu i Madhëruar i tha: “(Së pari) *paralajmëro të afërmin tënd më të afërt. Mbroji dhe përkujdesu për besimtarët që të ndjekin.*”¹ i ftoi të afërmit e tij në të vërtetën. Pas një kohe e zgjeroi fushën e veprimtarisë dhe shtëpinë e Erkam ibn Ebi'l-Erkamit e shndërroi në një qendër. I Dërguari i Allahut (a.s.), kujdesej për njerëzit një nga një. Ai i pastronte ata nga papastërtia e mosbesimit dhe politeizmit dhe u vendoste besimin e njëshmërisë së Islamit në zemrat e tyre. Përkundër sjelljes jashtëzakonisht të vrazhdë dhe të keqe të popullit të tij, ai dhe besimtarët i ftuan njerëzit në Islam me urtësi, largpamësi dhe butësi dhe u jepnin këshilla të mira.² Ata nuk i fyenin haptazi idhujt e politeistëve. Përndryshe, edhe ata do të kishin thënë fjalë të pahijshme kundrejt Allahut.³

LARGOHU NGA MENDJEMADHËSIA!

Ajetet që zbriteshin gradualisht po e bënë moralin e besimtarëve më të mirë çdo ditë. Ato i paralajmëronin ashpër myslimanët kundrejt veprimeve të tilla të shëmtuara si përgojimi, thashethemet, stigmatizimi i njerëzve, fyerja e tyre dhe shfaqja e epërsisë ndaj tyre.⁴

KUJDES NDAJ VESVESIT TË DJALLIT!

Allahu i Madhëruar i urdhëroi besimtarët që të jenë falës, të ndjekin rrugën e lehtësismit, të mos jenë të ashpër me njerëzit, të urdhërojnë për vepra të mira dhe t'i shpërfillin injorantët. Duke urdhëruar që të jenë vigjilentë ndaj shejtanit, Ai tha: “*Nëse djalli përpiqet të të shtyjë drejt së keqes, kërko strehim tek Allahu, se vërtet, Ai dëgjon dhe di*

gjithçka. Ata që i frikësohen Allahut, kur u vjen ndonjë mendim i lig nga djalli, i kujtojnë (urdhurat e Tij), *e atëherë e shohin rrugën e drejtë. Ndërsa vëllezërit e vet* (prej njerëzve), *ata i shpien edhe më tej në humbje pa pushuar.*”⁵

BËHU ROB I DENJË PËR TË GJITHËMËSHIRSHMIN!

Pas një kohe, Allahu Teala shpalli cilësitë e robërve të Tij të dashur. Nisur nga kjo, robërit e denjë për të Gjithëmëshirshmin ishin ata që ecnin me dinjitet në tokë dhe kur njerëzit injorantë u hidhnin ndonjë fjalë, ata u thoshin «selam/paqe» dhe kalonin. Ata e kalonin shumicën e natës duke bërë sexhde për Zotin dhe duke qëndruar në audiencën e Tij. Ata i përgjroheshin Atij. “*O Zoti ynë! Na mbaj larg ndëshkimit të xhehenemit, sepse ndëshkimi i tij nuk ka fund. Sa vendbanim i keq është xhehenemi!*” Kur shpenzonin, nuk ishin as shpërdorues e as koprracë dhe mbanin një rrugë të moderuar mes këtyre të dyjave. Ata nuk adhuronin asnjë zot tjetër krahas Allahut. Ata nuk vrisnin dhe nuk bënë imoralitet. Ata e dinin se njerëzit që i bëjnë këto do të ndëshkoheshin rëndë. Nëse e bënë një gabim të tillë, pendoheshin menjëherë dhe i kërkonin falje Zotit (xh.xh.). Ata nuk jepnin dëshmi të rreme dhe kur ndesheshin me sjellje boshe e të pakuptimta, kalonin me dinjitet. Kur atyre u përkujtoheshin argumentet e Zotit, nuk silleshin si të verbër e as të shurdhër. Ata luteshin: “*O Zoti ynë! Na jep gra dhe fëmijë që do të jenë drita e syve tanë dhe na bëj prijës të të devotshmëve!*” Ata e dinin se, ata që nuk e adhurojnë Allahun dhe nuk i luten Atij, nuk kanë ndonjë vlerë tek Ai.⁶

QËNDRON LARG PUNËVE QË ALLAHU I SHEH TË SHEMTUARA!

1. Shu'ara, 214-215.
2. Shik. Kaf, 45; Muddeththir, 2; Asr, 3. Veçanërisht shik. En'am, 70; Jusuf, 108; Nahl, 125; Isra, 53; Ta-ha, 44; Ankebut, 46; Fussilet, 33.
3. Shik. En'am, 108; Ibn Hisham, Sire, I, 357.
4. Shik. Humeze, 1-3.

5. A'raf, 200-202; Taberi, Xhamiu'l-Bejan, X, 642-650. Veçanërisht shik. Isra, 53, 61-65.
6. Shik. Furkan, 63-77; Taberi, XVII, 489-537; Ibn Kethir, Tefsir, X, 319-335.

Allahu i Madhëruar i ka njoftuar robërit për sjelljet që Ai nuk i pëlqen. Ai i ka urdhëruar besimtarët që të adhurojnë vetëm Atë, të sillen mirë me prindërit, t'u thonë atyre fjalë të mira dhe të mos i mërzhitin kurrë. Ai tha: “Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuroni askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as “uh!”, mos i kundërshtoj, por drejtoju atyre me fjalë respekti. Lësho para tyre krahët e përluljes prej mëshirës dhe thuaj: “O Zoti im, mëshiroji ata, ashtu siç më kanë rritur, kur unë isha i vogël!” Zoti juaj e di më së miri ç'keni në shpirtrat tuaj. Nëse ju jeni të drejtë, sigurisht që Ai është Falës për ata që pendohen. Jepuni të afërmve, të varfrit dhe udhëtarit të drejtën e tyre, por mos bëni shpenzim të tepruar. Dorëshpuarit me të vërtetë, janë vëllezërit e djallit dhe djalli është mosmirënjohës ndaj Zotit të tij. Por, nëse shmangesh nga ata (kur nuk ke asgjë për të dhënë), duke shpresuar në mëshirën e Zotit tënd, atëherë thuaju atyre ndonjë fjalë të butë. Mos e shtrëngo dorën, as mos u bëj dorëshpuar e të mbetesh i qortuar dhe i mjerë. Me të vërtetë, Zoti yt i jep me bollëk e ia kufizon (riskun) kujt të dëshirojë; Ai i di dhe i sheh mirë robërit e Vet. Mos i vrisni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë! Ne u sigurojmë ushqim atyre dhe juve. Vërtet, vrasja e tyre është gjynah i madh. Dhe mos iu qasni kurvërisë, se ajo është shfrenim dhe rrugë e shëmtuar! Mos ia merrni jetën njeriu, gjë që Allahu jua ka ndaluar ta bëni, përveçse kur e kërkon e drejta! Nëse dikush vritet padrejtësisht, Ne i kemi dhënë pushtet trashëgimtarit të tij (të kërkojë shpagim). Por edhe ai të mos e teprojë në vrasje, sepse ai është i ndihmuar (nga ligji dhe drejtësia islame). Mos iu qasni pasurisë së jetimit, veçse me qëllim të mirë, derisa të arrijë moshën e pjekurisë. Dhe përmbushni zotimet. Me të vërtetë, për zotimet do të jeni përgjegjës. Saktësojeni matjen, kur matni dhe peshoni me peshore të rregullt. Kjo është e mira që çon në përfundimin më të bukur. Mos shko pas diçkaje për të cilën nuk ke dijeni. Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjithë këta do të merren në përgjegjësi. Mos ec nëpër tokë me mendjemadhësi, se ti, në të vërtetë, nuk mund ta çash tokën e as të arrish lartësinë e maleve. E keqja e të gjitha këtyre është e urreyer nga Zoti yt.”⁷

FOL ME EDUKATË!

Allahu i Madhëruar u mësoi besimtarëve edukatën e të folurit. Ai i tha të Dërguarit të Tij: **“Thuaju, robërve të Mi, që të flasni atë që është më e mira. Në të vërtetë, djalli mbjell ngatërresa ndërmjet tyre. Vërtet, djalli është armik i hapët i njeriut.”**⁸

7. Isra, 23-38.

8. Shik. Isra, 53; Taberi, XIV, 623-624; Ibn Kethir, IX, 28-29.

KUJDES NDAJ ASAJ QË HA DHE PI!

Zoti i Madhëruar i ka njoftuar besimtarët se mund të hanë vetëm mish të therur në emër të Allahut. Ai ua ndaloi mishin e kafshëve të therura në emër të dikujt tjetër përveç Allahut. Ai i urdhëroi ata që të thonë emrin e Allahut kur të hanë dhe të pinë.⁹ Ai e bëri haram mishin e ngordhur (mejte), gjakun e derdhur dhe mishin e dërrit, i cili është vetë fëlliqësi. Ai informoi se ata që detyrohen t'i hanë këto do të faleshin nëse do t'i hanin pa i dëmtuar të tjerët dhe pa e kaluar kufirin.¹⁰

Shpalljet që erdhën na kujtuan se Allahu ka krijuar një shumëllojshmëri frutash dhe perimesh për robërit e Tij. Ai ka urdhëruar: **“Kur secili të japë fruta, hani nga frutat dhe jepeni të drejtën në ditën e vjeljes!”** Menjëherë pas kësaj, Allahu e ndaloi shpërdorimin dhe deklaroi se Ai nuk i do ata që shpërdorojnë.¹¹

MOS IU AFRO GJËRAVE TË SHËMTUARA QOFSHIN TË HAPURA APO TË FSHEHTA!

Zoti i Plotfuqishëm i ka urdhëruar besimtarët që t'i lënë gjynahet dhe mëkatet e hapura apo të fshehta, të vogla apo të mëdha, madje as të mos iu afrohen atyre. Allahu ka deklaruar se ata që bëjnë mëkate do të dënohen patjetër për ato që bëjnë.¹²

DREJTËSIA: PESHORJA E ARGJENDARIT

Drejtësia është baza e gjithçkaje. Gjithë botës iu tregua se sa i ndjeshëm është Islami për këtë çështje. Allahu i Madhëruar ka thënë: **“...Kur të flisni dhe të gjykoni, jini të drejtë, edhe nëse bëhet fjalë për të afërmit tuaj. Përmbusheni siç duhet premtimin që ia keni dhënë Allahut...”**¹³

Edhe pse besimtarët kanë besim dhe vepra të mira, ata kanë respekt dhe frikë të thellë ndaj Allahut. Adhurimet dhe mirësitë që i bëjnë, i bëjnë duke iu dridhur zemrat e tyre nga besimi se do të kthehen te Zoti (xh.xh.). Ata kanë frikë se mos bëjnë ndonjë të keqe dhe veprat e tyre të shkojnë dëm.¹⁴

Si rezultat i edukimit islam, myslimanët tashmë e këshillonin njëri-tjetrin që të ishin të drejtë, të durueshëm dhe të mëshirshëm.¹⁵ Si rrjedhojë, ata u bënë vërtet një umet i drejtë, shembullor dhe mesatar, i cili meritonte lavdërimin hyjnor.¹⁶ Me këto cilësi, ata u bënë robër të dalluar të Allahut (xh.xh.).¹⁷

9. Shik. En'am, 118-119, 121; Taberi, IX, 511-512.

10. Shik. En'am, 145.

11. Shik. En'am, 141.

12. Shik. En'am, 120.

13. En'am, 152.

14. Shik. Mu'minun, 57-60; Ibn Kethir, X, 129-130.

15. Shik. Asr, 3. Veçanërisht shik. Nahl, 42; Ankebut, 59; Beled, 17.

16. Shik. A'raf, 181; Taberi, X, 600.

17. Shik. Neml, 59; Kurtubi, Xhami', XVI, 189.



JA, KJO ËSHTË RRUGA IME E DREJTË

— Iskender Karajigit —

Shprehja «Siratu'l-Mustekim» (Rruga e Drejtë) gjendet në shumë vende në Kuranin Fisnik. Mirë, por cila është rruga e drejtë e Zotit të Plotfuqishëm? Komentuesit tanë janë shprehur se me “rrugën e drejtpërdrejtë” nënkuptohet rruga e Allahut, rruga e drejtë, rruga e moderuar, libri i Allahut, besimi, Islami, sheriati Islam, rruga e Profetit tonë dhe shokëve të tij, sunetet, rruga e xhenetit dhe ura e xeheneemit. (Elmallëllë, Hak dini Kur'an dili, I, 121.)

Kurse përgjigja për pyetjen se si e përshkruan Kurani rrugën e drejtë është në ajetet 151 deri në 153 të sures En'am. Ndërsa Zoti na sugjeron rrugën e drejtë në suren Fatiha, Ai urdhëron të ashtuquajturat «dhjetë këshilla» ose «ahkami ashera» në suren En'am dhe në të fundit prej tyre e interpreton rrugën e drejtë duke thënë: **“Ja pra, kjo është rruga ime e drejtë. Tashmë ndiqeni atë. Mos ndiqni rrugë të tjera. Përndryshe, ato rrugë do t'ju përçajjnë dhe do t'ju ndajnë nga rruga e Tij. Ja pra, Allahu ua ka urdhëruar këto, në mënyrë që të ruheni.”** (En'am, 153.) Përveç kësaj, edhe «Siratu'l-Mustekim» është interpretuar në pjesë të ndryshme të Kuranit Fisnik, por ne duam të prekim «Siratu'l-Mustakim» këtu, pasi dispozitat në suren En'am janë të pandryshuara me ndryshimin e umeteve.

“Ja pra, kjo është rruga ime e drejtë. Tashmë ndiqeni atë. Mos ndiqni rrugë të tjera. Përndryshe, ato rrugë do t'ju përçajjnë dhe do t'ju ndajnë nga rruga e Tij. Ja pra, Allahu ua ka urdhëruar këto, në mënyrë që të ruheni.”
(En'am, 153.)

E para nga këto dispozita është urdhri: “Mos i bëni shok Allahut asnjë gjë.” Shirku është shpjeguar me urdhrin hyjnor: **«Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut (në adhurim), ka bërë gjynah të tmerrshëm.»** (Nisa, 48) Përsëri në suren Lukman përmendet këshilla e mëposhtme e Lukmanit për djalin e tij. **“O biri im! T'i bësh shirk Allahut në fakt është një zullum i madh.”** (Lukman, 13.) Atëherë, faza e parë e rrugës së drejtë që të shpie tek Allahu (xh.xh.), është kredoja e tevhidit.

Dispozita e dytë është urdhri: «Bëjuni mirë prindërve tuaj.» Një nga çështjet që Zoti i Lartësuar na këshillon me insistim neve robërve të Tij në Kuranin Fisnik është që t'u bëjmë mirë prindërve tanë dhe të mos i lëndojmë kurrë ata. Zoti (xh.xh.), ka bërë paralajmërime aq të rrepta për këtë çështje saqë, lëreni më t'i sfidojmë ata, por Ai e ka ndaluar edhe që t'u themi «of» duke u shprehur: **«Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as “of!”, mos i kundërshtoj, por drejtoju atyre me fjalë respekti.»** (Isra, 23) Përsëri, pas këshillës së lartpërmendur të Lukmanit drejtuar

djalit të tij që të mos i bëjë shirk Allahut, Zoti ka thënë: «**Ne i kemi dhënë këshilla njerëzve në lidhje me prindërit e tyre.**» (Lukman, 14) Fakti që në të tria suret (Isra, En'am, Lukman), përmendet mirësia ndaj prindërve menjëherë pasi theksohet besimi i tevhidit, është një çështje për t'u pasur kujdes.

Dispozita e tretë është urdhri: "Mos i vrisni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë." Në veçanti, vrasja e një fëmije për shkak të frikës nga sigurimi i jetesës do të thotë të dyshosh se thesari i Allahut është mjaft i pasur për të siguruar furnizim për të gjithë. Gjithash-tu, duhet pasur parasysh se këtu nuk nënkuptohet vetëm praktika e vrasjes së fëmijëve në periudhën e injorancës para Islamit, por ndalohet edhe vrasja e një fëmije në barkun e nënës, veçanërisht duke u bazuar në shprehjen «frika nga varfëria» apo "shqetësim për sigurimin e jetesës". Ajeti është i vlefshëm edhe për ditët e sotme në lidhje me çështjet e të tilla si kontrolli i lindjeve dhe planifikimi i popullsisë. Megjithatë, qëllimi kryesor i martesës është të ketë fëmijë për vazhdimin dhe zhvillimin e brezave. Për këtë arsye, nuk është e drejtë të ndërhyhet në rrjedhën natyrore të natyrshmërisë për arsye arbitrare si për shembull, përkeqësimi i bukurisë së gruas apo fëmija që konsiderohet pengesë, sepse kufizon lirinë e udhëtimit të çifteve të reja. Urdhri: "Mos i vrisni fëmijët tuaj", që përmendet në ajet, lidhet ngushtë me çështjen e abortit, e cila sot praktikohet gjerësisht dhe shkakton polemika të rënda. Shumica e dijetarëve të sotëm janë të mendimit se aborti është haram, pavarësisht nga faza e shtatzënisë.

Dispozita e katërt është urdhri: "Mos iu afroni të këqijave të hapura apo të fshehta." Fakti që në ajet thuhet «mos iu afroni» të këqijave të hapura apo të fshehta në vend që të thuhet "mos i bëni" apo "mos i kryeni", me fjalë të tjera, lëreni bërjen e të këqijave, por thënia as mos iu afroni, kërkon qëndrimin larg mjedisit dhe rrethanave që në mënyrë të pashmangshme mund t'i shtyjnë njerëzit ta kryejnë të keqen.

Dispozita e pestë është urdhri: "Mos e vrisni jetën (njeriun) që Allahu e ka ndaluar, përveç nëse ka një arsye të drejtë." I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: "Gjaku i myslimanit është hallall vetëm me njëërën nga këto tri gjëra. Një i martuar që bën zina (imoralitet), një jetë kundrejt një jete dhe një njeri që e lë fenë e tij dhe largohet nga shoqëria islame." (Buhari, Dijet, 6.) Në një ajet tjetër, duke përfshirë edhe jomyslimanët, i referohet dinjitetit të njeriut në formën: «**Kushdo që vret një njeri, është sikur të ketë vrrarë të gjithë njerëzit.**» (Maide, 32)

Dispozita e gjashtë është urdhri: «Parasë së jetimit qasuni vetëm me sjellje të mirë derisa të mbushë moshën e pubertetit.» Padyshim, edhe pse pasuria e të gjithë njerëzve është e pacenueshme brenda ligjshmërisë, ajeti tërheq vëmendjen për të qenë

veçanërisht të kujdesshëm në këtë drejtim, pasi pasuria e jetimëve është më e prekshme ndaj sulmit ose abuzimit për shkak të dobësisë dhe pambrojtjes së tyre. Përveç kësaj, për shkak se të qenët plotësisht indiferent ndaj pasurisë së jetimit do të bëjë që kjo pasuri të dëmtohet me kalimin e kohës ose të paktën të mos shtohet, lejohet që të merremi me këtë pasuri, madje inkurajohet në mënyrë implicite që të kujdesemi për të, siç mund të kuptohet nga shprehja «në formën më të mirë dhe më të bukur» (ahsen). Sepse të bësh më të mirën dhe më të bukurën është domosdoshmëri e virtytit.

Dispozita e shtatë është urdhri: "Matni dhe peshoni me drejtësi." Shitblerja, e cila është një praktikë e domosdoshme mes njerëzve, është një praktikë në të cilën njerëzit që janë të prirë ta duan pasurinë kanë më shumë gjasa t'i shkelin të drejtat e të tjerëve. Për këtë arsye, Zoti i Plotfuqishëm e ka paralajmëruar shpesh njeriun në librin e tij madhështor. Në suren Mutaffifin është deklaruar shëmtia e mashtrimit në matje dhe peshë në formën: "**Mjerë për ata që hanë në peshë (dhe matje), që, kur matin për veten, e marrin masën të plotë, ndërsa, kur u matin të tjerëve (me litër ose me kandar), ua pakësojnë.**» (Mutaffifin, 1-3)

Dispozita e tetë është urdhri: "Kur të flisni, jini të drejtë, edhe nëse janë të afërmit tuaj." Myslimani duhet të bëjë gjithmonë gjënë e duhur dhe të mos largohet nga drejtësia në fjalën, veprën, betimin dhe dëshminë e tij, shkurtimisht, në çdo gjendje dhe situatë, edhe nëse është kundër tij.

Dispozita e nëntë është urdhri: "Përmushni siç duhet besëlidhjen e Allahut." Myslimani ka bërë një lloj besëlidhjeje me Allahun për të përmushur detyrat e tij të adhurimit, sepse premtimi i dhënë në pafillimësi e kërkon këtë. Përveç kësaj, kur njerëzve u bëhet një premtim legjitim, është urdhër i Allahut që të përmushet, dhe ajeti në fjalë e përfshin edhe këtë urdhër.

Dispozita e dhjetë është urdhri: "Kjo është rruga ime e drejtë. Ndiqeni këtë, mos ndiqni rrugë (të tjera)." Ky urdhër, si një detyrë universale që përfshin nëntë urdhrat e mësipërm, e urdhëron njeriun të ndjekë rrugën e drejtë të Allahut (xh.xh.).

Ja pra, këta urdhra që përshkruajnë siratun-l-mustekimin quhen «Ahkami ashera». Këto janë dispozita fetare, civile dhe njerëzore që nuk ndryshojnë me ndërrimin e umeteve dhe shekujve. Siç transmetohet nga Ibn Abbasi (r.a.), ata që veprojnë me ta do të udhëzohen dhe do të futen në xhenet. Ata që i braktisin do të dërgohen në xhehenem. (Omer Nasuhi Bilmen, Përkthimi dhe Interpretimi i Kuranit në turqisht, 4, 980.)

SË PARI, BAZA DHE MJEDISI I SHËNDETSHËM



Për të parandaluar riprodhimin dhe përhapjen e sëmundjeve materiale dhe shpirtërore në mbarë vendin dhe botën, nuk ka zgjidhje tjetër veç fillimit të një mobilizimi për një sistem të drejtë ekonomik, një edukim të bazuar në besim dhe moral dhe një botëkuptim me në qendër ne, jo unë (egocentrik). Ndryshe, është e sigurt se nga ky qëndrim do të vuajnë edhe ata që kanë prioritet fitimin.

— Ali Riza Temel —

Profetët që ndryshojnë dhe transformojnë njerëzit dhe i formësojnë ata në një model të ri besimi dhe botëkuptimi, janë reformatoret më të mëdhenj të historisë. Po të dërgoheshin njëqind filozofë në vend të Profetit Muhamed (a.s.), në shoqërinë politeiste të Mekës, e cila dominohej nga injoranca, nuk do të edukonin dot as një Hz. Omer. Sjellja e njerëzve deri në pikën e shkatërrimit me duart e tyre të idhujve që ata i adhuronin është e mundur vetëm duke krijuar një bazë besimi dhe njohurie shumë të fortë dhe të rrënjosur thellë. Sepse zakonet dhe besimet e rrënjosura nuk ndryshojnë lehtë. Është e rëndësishme të ndryshosh brendësinë, mentalitetin e njeriut, jo të jashtmen e tij. Moda nuk është e përhershme, ajo është sezonale. Kurse besimi dhe idetë e rrënjosura janë të përhershme. Ato formojnë bazën e shoqërive të shëndetshme. Këto quhen vlera të pandryshueshme dhe statike. Ato janë elemente bartëse.

Në sufizëm thuhet: «së pari takhlije, pastaj tahlije.» E para shprehet me shkronjën «kha» në arabisht, kurse e dyta me shkronjën «ha». Do të thotë fillimisht të zbrazësh të keqen dhe të shëmtuarën dhe më pas të vendosësh të bukurën dhe të mirën në vend të saj. Fillimisht eliminohen ato të dëmshmet, pastaj përvetësohen ato të dobishmet. Kjo në Mexhel-le është formuluar në mënyrën: «Eliminimi i të dëmshmeve ka përparësi ndaj marrjes së të dobishmeve.»

Gjëja kryesore në mjekësi është mjekësia parandaluese, jo mjekësia terapeutike. Thelbësore është të përgatitet një mjedis i shëndetshëm, në mënyrë që njerëzit të mos sëmuren. Prania e papastërtisë, mushkonjave, ujit, ajrit dhe mjedisit të kontaminuar janë faktorë që shkaktojnë sëmundje. Ashtu siç është në plan të parë efekti i kushteve negative materiale në zhvillimin e sëmundjeve fizike, edhe negativitetet shpirtërore janë në plan të parë në ardhjen dhe përhapjen e sëmundjeve shpirtërore.

Është shumë e vështirë të jesh i ndershëm në një mjedis ku janë të përhapura mosbesimi, padrejtësia, mosrespektimi i normave haram-hallall, pabarazia dhe hendeku në shpërndarjen e të ardhurave, interesat, lojërat e fatit, tregu i zi, vjedhjet direkte apo indirekte.

Ekziston një kufi për atë që njerëzit mund t'i rezistojnë ndjekjes së rregullave. «**Allahu i mban të gjithë përgjegjës vetëm në masën që munden.**» (Bekare, 286) Këtë e shpreh edhe dispozita: “Domosdoshmëritë i bëjnë të lejuara ndalesat.”

Ashtu si jo çdo bimë rritet në çdo klimë dhe çdo gjallesë ka nevojë për një mjedis për të jetuar, edhe vlerat njerëzore dhe morale mund të jetojnë dhe zhvillohen në një mjedis të përshtatshëm.

Fakti që Islami nuk pati mundësi të zhvillohej në shoqërinë mekase, ku mbizotëronte politeizmi dhe injoranca, solli nevojën e emigrimit dhe për të bërë një jetë myslimane në një mjedis më të

rehatshëm dhe më të përshtatshëm, u bë migrimi në mënyrë kolektive së pari në Abisini dhe më pas në Medinetu'l-Munevvera. Nevoja për të kërkuar një mjedis të përshtatshëm u shfaq edhe në jetën e profetëve të mëparshëm.

Funksionimi i vlerave dhe rregullave që do ta mbajnë gjallë shoqërinë varet nga krijimi i një kuadri njerëzor që do t'i zbatojë vullnetarisht ato. Plotësimi i Islamit në njëzet e tre vjet është për trajnimin gradual të një kuadri që do t'i zbatojë me dëshirë rregullat. Nëse kjo bazë nuk do të ishte krijuar gjatë periudhës së Mekës, nuk do të ishte e mundur të jetohej dhe zbatohesh siç duhej Islami, i cili u shndërrua në një rend shtetëror, veçanërisht në periudhën e Medinës. Kur një shoqërie të varur nga alkooli i erdhi ajeti: «**Tani keni hequr dorë, apo jo?**» (Maide, 91), të gjithë thanë: “Ne hoqëm dorë, o Zot.” Ky është rezultati i këtij edukimi.

Në përgjithësi, funksionimi i rregullt i rendit shoqëror varet nga ekzistenca e njerëzve që besojnë në këtë rend dhe nga vazhdimi i praktikave që nuk do ta lëkundin këtë besim dhe iman. Prishja e shoqërisë i ngjan kalbjes graduale të një frute, e cila prishet dhe më në fund hidhet në koshin e mbeturinave.

Ashtu siç një mjedis steril dhe i pastër është i nevojshëm për mospërhapjen e sëmundjeve, po ashtu nevojitet një mjedis steril shpirtërisht për të parandaluar përhapjen e të këqijave. Para së gjithash, bëhet fjalë për eliminimin e mjedisit që i çon njerëzit në mëkat dhe planin e dytë të ndëshkimit për krimin e kryer. Le të japim një shembull të mrekullueshëm nga i Dërguari i Allahut (a.s.):

“Abbad b. Shurahbili, nga fisi Gaber, tregon: Kam ardhur në Medine me gjyshin dhe gjyshen nga ana e babait. Hyra në një arë me grurë, këputa disa kallinj dhe ndava disa nga kokrrat. Hëngra pak dhe të tjerat i futa në torbë. Në ato momente erdhi i zoti i arës, më rrahu, mi hoqi rrobat dhe mi mori. Edhe unë shkova te i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam dhe e informova për situatën. Profeti (a.s.), e solli atë njeri dhe e pyeti: «*Përse veprove kështu?*» Ai iu përgjigj: «O i Dërguari i Allahut! Ky njeri hyri në arën time, këputi kallinjët dhe i ndau kokrrat.” Nisur nga kjo përgjigje, Hz. Pejgamberi i tha: «*Ai ishte injorant. Ti nuk ia mësove atij haramin dhe hallallin. Ai ishte i uritur dhe ti nuk e ushqeve. Ktheja rrobat pas.*» Përveç të tjerash e urdhëroi që të më jepte një apo gjysmë vesk (lloj matjeje rreth 200 kg) gruri.” (Ibn Esir, Usdu'l-Gabe 3/153.) Kjo ngjarje është gjithashtu e transmetuar edhe te Nesai dhe Ebu Davudi.

Le të tregojmë një ngjarje interesante në lidhje me praktikën e Omerit (r.a.):

“Skllëverit e Hatib ibn Ebi Belteas vodhën devenë e një njeriu nga fisi Muzejne, e therën dhe e hëng-rën. Ata gjithashtu e pranuan fajin e tyre. Hz. Omeri thirri pronarin e skllëverve. Atij i tregoi se çfarë kishte ndodhur. Pastaj një burrë të quajtur Kethir ibn Salt, e urdhëroi që t'u priste duart skllëverve. Por ai hoqi dorë nga ky vendim, solli pronarin e skllëverve dhe i tha: Do t'ua prisja duart, por mendova: Ti i ke lënë aq shumë të uritur këta skllëver sa që atyre iu desh ta bënin këtë faj. Meqenëse i ke lënë të uritur, të betohem se do të të ndëshkoj dhe se do ta paguash shtrenjtë. Pastaj burrin nga Muzejne, të cilit iu vodh deveja, e pyeti: «Sa vlente deveja jote?» Kur ai tha: “Katërqind dërhëmë.”, Hz. Omeri i tha pronarit të skllëverve: “Jepi tetëqind dërhëmë pronarit të kësaj deveje.» Ai e ndëshkoi kështu atë ngaqë i linte skllëverit të uritur dhe bëhej shkak që ata të detyroheshin të vidhnin devetë. (Malik, Muvatta' Hadithi nr: 282.)

Roger Garaudy (Rozhe Garodi) i përmendi këto dy ngjarje interesante në librin e tij, Islami dhe e ardhmja e njerëzimit, dhe bëri komentin e mëposhtëm: Prerja e dorës së një hajduti vetëm për shkak të zbatimit të Sheriatit pa hequr kushtet sociale që i shtynjë njerëzit të vjedhin, do të thotë të fillosh nga fundi.

Gjithashtu dihet se në vitin e zisë, Hz. Omeri i pezulloi dispozitat për fajin e vjedhjes.

Kjo është ajo që nënkuptojmë me “mjedis të shëndetshëm” që e kemi përmendur në titullin e artikullit. Në një mjedis ku papastërtia është e përhapur, mikrobet riprodhohen e përhapen në maksimum dhe njerëzit nuk marrin asnjë masë paraprake shëndetësore, është budallallëk t'u thuash atyre: «Kujdes, mos u sëmurni!»

Rregulli më i rëndësishëm i mjekësisë është t'i japim imunitet trupit me ushqime të dobishme, ta mbajmë pastër mjedisin që shkakton riprodhimin e mikrobeve dhe t'i eliminojmë shkaqet e sëmundjes përpara trajtimit. Praktika e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ishte në këtë mënyrë. Këshilla: “Vlerësoje shëndetin para se të sëmuresh.”, e thotë qartë këtë.

Për të parandaluar riprodhimin dhe përhapjen e sëmundjeve materiale dhe shpirtërore në mbarë vendin dhe botën, nuk ka zgjidhje tjetër veç fillimit të një mobilizimi për një sistem të drejtë ekonomik, një edukim të bazuar në besim dhe moral dhe një botëkuptim me në qendër ne, jo unë (egocentrik). Ndryshe, është e sigurt se nga ky qëndrim do të vuajnë edhe ata që kanë prioritet fitimin. Ngjarja e fundit Korona është dëshmia më e qartë e kësaj.



KORNIZA

E PERSONALITETIT TË BESIMTARIT

— Ahmet Tashgetiren —

Llojet e personaliteteve përmenden në Kuran me termat, si: besimtar, monoteist, i devotshëm, musliman, ateist, mosmirënjohës, politeist, femohues dhe hipokrit.

Katër termat e parë shprehin tipet pozitive, kurse pesë termat e tjera shprehin tipet negative.

Kurani kërkon mbujtjen e personalitetit njerëzor me katër veçoritë e para dhe qëndrimin larg pesë veçorive të tjera.

Midis katër tipeve pozitive, tipi “besimtar” është më gjithëpërfshirësi. Besimi shpreh krijimin e komunikimit të njeriut me Zotin.

Besimi fillon me “amentu” (besoj), por nuk mbaron me “amentu”.

Në Kuran është një ajet që thotë: **“O besimtarë! Besoni!”** (Nisa, 136)

Por është edhe një ajet tjetër: **“Vërtet mendojnë njerëzit se do të lihen të thonë ‘Ne besojmë’, pa u vënë në provë?!”** (Ankebut, 2)

“Arabët e shkretëtirës deklarojnë: ‘Ne besojmë’. Thuaju: ‘Ju nuk keni besuar! Por më mirë thoni: ‘Ne përulemi’, pasi besimi ende nuk ka hyrë (si duhet) në zemrat tuaja.” (Huxhurat, 14)

Ajeti i parë u kujton besimtarëve besimin, u kërkon atyre forcimin, pastrimin, mbajtjen gjallë dhe

të freskët të besimit në zemrat e tyre. Ajeti sikur thotë që puna e besimit nuk mbaron thjesht me të qenit besimtar, por atij i duhet shtuar përpjekja dhe veprimi.

Edhe dy ajetet e tjera po të njëjtën gjë theksojnë.

Surja Ankebut na informon që pas besimit ka sprovë dhe vetëm pas këtij testi dhe provimi, besimi konsiderohet i vërtetë dhe i sinqertë.

Kurse ajeti i sures Huxhurat na informon se deklarimi verbal **“Amentu” (besova)** i siguron njeriut vetëm hyrjen në Islam, sepse çështja e besimit është shumë më e thellë dhe e gjerë, madje sipas ajetit nuk mjafton vetëm deklarimi verbal, nuk konsiderohet **“iman”** vetëm shqiptimi me gojë i besimit. Allahu në mënyrë të qartë dhe qortuese u thotë: **“Ju nuk keni besuar.”**

Pse nuk kanë besuar?

Sepse **“Besimi ende nuk ka hyrë në zemrat e tyre.”**

Nga kjo pjesë e ajetit kuptojmë që njeriu duhet të realizojë një udhëtim drejt zemrës së tij dhe besimi i tij do ta fitojë vlerën e vërtetë vetëm përmes realizimit të këtij udhëtimi.

Ajeti **“O besimtarë! Besoni...”** na tregon se për një besim cilësor duhet ndërtimi i një strukture të personalitetit sipas atij besimi.

Pra çështja nuk mbaron me deklarin verbal.

Në fakt shyllat e besimit, të cilat përfshihen në fjalën **“Amentu”** përcaktojnë dhe paraqesin një strukturë personaliteti. Besimi tek Allahu, librat, pejgamberët, melekët, Dita e Gjykimit dhe tek caktimi i Allahut... Të gjitha këto shtylla janë pjesë të domosdoshme të besimit. Deklarimi **“besoj në Ahiret”** dhe të jetuarit në këtë botë sikur nuk ke për të dalë një ditë para Allahut për të dhënë llogari, kurrë në fakt nuk është **“besim në Ahiret”**. E njëjta gjë është edhe me librat. Deklarimi **“besoj librat”** dhe bërja e një jete krejtësisht në kundërshtim me mësimet e Kuranit, deklarimi **“besoj pejgamberët”** dhe ndërtimi i një jetë në kundërshtim me mësimet e Pejgamberit (a.s.), nuk mund të konsiderohet një jetë brenda strukturës së imanit.

Udhëtimi nisët me **“amentu”**, por nuk mbaron me të. Duhet që personi që pretendon besimin dhe lidhjen me Allahun të ndërtojë një jetë sipas mësimëve të besimit.

Nëse beson ekzistencën e botës tjetër dhe gjykimin në të, atëherë përpigu të bësh një jetë të atillë në këtë botë, që të dalësh faqebardhë atje.

Për të ndihmuar njeriun, Allahu i ka treguar atij të mirën dhe të keqen, të drejtën dhe të gabuarën.

Në Kuran ekzistojnë me qindra ajete, që fillojnë me **“O Besimtarë”**. Të gjithë këto ajete përcaktojnë kornizën e jetës sipas kritereve hyjnore, përfshijnë të gjitha detajet e personalitetit të njeriut.

Ajetet përfshijnë një zinxhir sjelljesh, që zgjatet deri te mirësjellja dhe respektimi i prindërve.

Ecja me kryelartësi konsiderohet mendjemadhësi dhe diçka e padëshirueshme nga Allahu.

Thashethemet konsiderohen të pështira, të ngashme me ngrënien e mishit të vllait të vdekur.

Përkëdhelja e jetimit, kujdesi dhe ruajtja e pasurisë së tij, ndihma pa kushte ndaj nevojtarëve... janë shkaqe për të fituar dashurinë e Allahut dhe Xhenetin.

Ironia, qesëndia dhe përqeshja janë të ndaluara.

Vargu i zinxhirit që vizaton personalitetin e besimtarit vazhdon me përgjegjësinë për veten, për pasurinë, fëmijët dhe të gjitha mirësitë e dhuruara nga Allahu, për të vazhduar më tej me zhvillimin e një ndjeshmërie sikur e shikon Allahun dhe vetëdijshmëria për vëzhgimin e vazhdueshëm të Tij mbi ne dhe afrimitetit të Tij.

Pejgamberi (a.s.), na informon se besimi përbëhet prej 73 pjesësh dhe më e çmuara është fjala **“La ilahe ilallah”**, kurse më pak e çmuara është pastrimi dhe heqja e diçkaje që pengon njerëzit nga rruga. Dhe turpi është prej imanit.

Konkludimi i parë që nxjerrim prej hadithit është: Besimi nuk është i kufizuar vetëm me gjashtë kush-

tet e besimit, por zgjatet deri te pastrimi i rrugës nga një pengesë.

Në fakt, këto 73 pjesë përbëjnë gjithë kornizën e personalitetit të myslimanit.

Ajetet që fillojnë me **“O Besimtarë!”** një personalitet të tillë ofrojnë dhe thurin për besimtarin.

Nga kjo që parashtruam, arrijmë në përfundimin se personaliteti i myslimanit është një i tërë dhe të gjitha ajetet që fillojnë me **“O Besimtarë!”** u drejtohen atyre që e ndjejnë dhe e përkufizojnë veten si besimtarë.

Në të drejtën islame është debatuar dhe trajtuar gjerësisht marrëdhënia besim-veprim. A është vepra pjesë e besimit apo jo?

Në përgjithësi është pranuar se vepra nuk është pjesë e besimit. Për shkak se humbja, dobësimi, dhe pakësimi i besimit është si humbja e gjithë njerëzimit, është preferuar mendimi se mungesa e veprës nuk e dëmton besimin. Por është pranuar gjegjësisht se disa vepra e dëmtojnë rëndë besimin. Për shembull, një fjalë e vetme nënçmuese për Kuranin dhe Pejgamberin (a.s.), e çon njeriun drejt blasfemisë.

Shuma e sjelljeve të inkurajuara nga Kurani, për besimtarin përbën tërësinë e personalitetit të tij, prandaj braktisja e çdo sjelljeje të urdhëruar dhe përfshirja e çdo sjelljeje të gabuar çon në rrënimin e së tërës. Për shembull, nëse personaliteti i myslimanit quhet i përmbushur me praninë e 100 cilësive dhe në një person gjenden vetëm 50 cilësi, atëherë tërësia është dëmtuar në masën 50 %.

Një dietolog, në mënyrë që të arrihen rezultatet e dëshiruara, kërkon prej pacientit zbatimin me përpikmëri të dietës. E njëjta gjë vërehet edhe në jetën e njeriut. Islami është një dietë hyjnore për njerëzimin.

Për të gjitha organet e njeriut ka dietë, si për dorën, këmbën, syrin, veshin dhe zemrën. Mirëfunksionimi i organizmit bëhet i mundur përmes mirëushqyerjes dhe jetës së rregullt, kurse kequshqyerja dhe jeta e çrregullt e bën të pamundur funksionimin normal të tij. E njëjta gjë ndodh edhe me sjelljet e njeriut. Braktisja e sjelljeve të mira dhe mbingarkesa me sjellje të këqija e bën të pamundur funksionimin normal të shpirtit të njeriut.

Prandaj, duhet bërë përpjekje për rritjen cilësore të jetës sonë fetare. Duhet të përpiqemi me gjithë qenien tonë për një jetë brenda kornizave hyjnore.

Sepse **“Kthimi është tek Ai.”** (Gafir,3.)

Në fund **“do të ktheheni tek Ai.”** (Bekare, 28.)

Kurse të dështuar: **“Sigurisht që janë të humbur ata që mohojnë takimin me Allahun!”** (En’am, 31.)

Atyre që u zbardhet fytyra me lutjen e Profetit (a.s.)

— Abdullah Sert —

Njerëzimit i janë dhuruar mirësi të pafundme nga toka dhe qiejt. Më e madhja nga këto mirësi për njerëzimin, e veçanërisht për besimtarët, është t'i vijë një i dërguar nga Allahu i Madhëruar. Zoti i Plotfuqishëm përgjatë historisë i ka dërguar peygamberë njerëzimit, të cilin e ka krijuar në mënyrën më të përsosur dhe të cilit i ka dhënë krijesa të tjera nën komandë dhe shërbim. Këta peygamberë i ka zgjedhur nga mesi i njerëzve. Këta peygamberë kanë ushtruar detyrën e profecisë siç shprehet në ajetin fisnik: ***“Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kuranin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare), edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar.”*** (Al Imran, 164)

Ndërsa Allahu i Plotfuqishëm deklaroi se një profet i tillë duhet të dërgohet në umetin e profetit të fundit, si një «mirësi e madhe» e dhënë nga Zoti,

Ai gjithashtu e ka përshkruar marrëdhënien ndërmjet Profetit Muhamed (a.s.) dhe umetit të tij në formën: «Profeti për besimtarët ka përparësi edhe ndaj shpirttrave të tyre.» (Shik. Ahzab, 6.)

Kjo marrëdhënie ndërmjet Profetit dhe besimtarëve është dashuri, përkushtim, bindje, përparësi në mbrojtje dhe më tepër një ndjenjë dhe afërsi shpirtërore. I Dërguari i Allahut (a.s.), e shprehu këtë të vërtetë nga këndvështrimi i tij siç vijon: ***“Nuk ka asnjë besimtar që të mos jem më i afërti me të në këtë botë dhe në ahiret. Nëse mbetet një pasuri, le ta marrin kushdo që janë trashëgimtarë të saj. Nëse mbetet borxh ose një fëmijë në nevojë për mbrojtje, le të vijë tek unë, unë jam i afërmi i tij.”*** (Muslim, Feraid, 14-15.) Përsëri ka thënë: ***“Beto hem në Allahun, në dorën e të Cilit është jeta ime, se nëse nuk jam më i dashur për një njeri se vetja, pasuria dhe fëmija i tij, ai nuk ka besuar me të vërtetë.”*** (Muslim, Iman, 69-70.) Duke thënë kështu ka shprehur terrenin shpirtëror mbi të cilin do



të zhvillohet marrëdhënia e zemrës dhe e veprimit mes tij dhe besimtarëve.

Agjenda më e rëndësishme e gjeneratës së sahabëve, të cilët lanë si amanet dhe horizont për të gjithë brezat deri në Ditën e Gjykimit, fjalën: “O i Dërguari i Allahut, të qofshin falë prindërit e mi!”, ishte padyshim ta njihnin nga afër Hz. Pejgamberin duke dëgjuar fjalët e tij që do t’i dilnin nga buzët e bekuara, duke vëzhguar me kujdes praktikën e tij, duke u përpjekur të lexonin me largpamësi botën e tij të brendshme dhe më pas të bënin përpjekje për të jetuar si ai.

Kur gratë e sahabëve i përcillnin bashkëshortët nga shtëpitë e tyre, dëshironin që në mbrëmje krahas sjelljes së të ardhurave hallall, të ndaleshin edhe tek i Dërguari i Allahut dhe të vinin në shtëpi me një mesazh dhe praktikë të re në emër të Islamit. Me të njëjtën ndjeshmëri, edhe burrat sahabë përiqeshin t’i bartnin te bashkëshortet e tyre mesazhet e shpalljes hyjnore që dëgjonin nga Profeti në fillim, dhe më pas mesazhet dhe praktikën profetike që dëgjonin panë tij gjatë gjithë ditës. Kështu, shtëpitë e sahabëve shndërroheshin në shkolla ku mësohej gjithmonë Kurani dhe Suneti i Profetit çdo mbrëmje. Përsëri, nënat e bekuara sahabë shpesh i pyesnin fëmijët e tyre se kur ishin takuar për herë të fundit me të Dërguarin e Allahut, madje nëse shihnin një vonesë ose neglizhencë të fëmijët, i merrnin me butësi dhe i çonin te Hz. Pejgamberi për të marrë informacione të reja.

Pa dyshim, kujdesi i madh që brezi i parë i kushtoi jetës së Profetit (sireti nebevije) dhe përpjekjet e tyre për të mësuar çdo gjë të mirë që panë te Habibullahu (i Dashuri i Allahut) në jetën e tij dhe për t’ua mësuar ato pa bërë asnjë dallim mes të madhit dhe të voglit të gjithë atyre që mund të arrinin, duke filluar nga më të afërmit, dashuria e madhe që ndjenin për personalitetin fisnik të Profetit dhe dashuria e madhe që kishin për jetën e Profetit, ishin falë përkushtimit të përzemërt që ata kishin krijuar me të.

Të mëdhenjtë e Islamit, të cilët përmenden si sahabët dhe selefi salihin, gjithmonë i këshillonin veçanërisht fëmijët e tyre që së pari të mësonin për jetën e të Dërguarit të Allahut dhe më pas t’ua mësonin atë fëmijëve të tyre. Muhamedi, radijall-llahu anih, i biri i Sa’d ibn Ebi Vakasit ka thënë: «Babai im, Sa’di, radijall-llahu anih, më tregonte gjithmonë për luftërat e të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe më thoshte: “Mos e humb këtë informacion, biri im.”

Ibn el-Xhevziu thotë: “Të preokupohesh vetëm me fikh (jurisprudencën islame) dhe me shkencat e tjera, nuk mjafton për prehjen e zemrës. Patjetër është e nevojshme të njihen dhe të lexohen gjendjet e bu-

kura të të shkuarve të devotshëm dhe bibliografia e Profetit (a.s.), i cili është burimi i të gjithave.”

Nisur nga ky aspekt, detyra më e rëndësishme dhe parësore e myslimanëve sot, kur sytë dhe zemrat tona janë të ndotura me negativitet, në radhë të parë duhet të jetë t’u mësojmë brezave tanë brenda familjes «jetën shembullore» të të Dërguarit të Allahut, e cila shëron epokat.

Në fakt, burimi kryesor i shkencave të fikhut, tefsirit, hadithit, misticizmit dhe kelamit, secila prej të cilave më vonë u zhvillua si një degë më vete, është Kurani dhe praktikën e vetë Profetit (a.s.). Përderisa këto shkencë u pavarësuan me emrat e tyre, jeta e veçantë e të Dërguarit të Allahut që nga lindja deri në ditën kur takoi Zotin e tij mbeti si shkencë më vete me emrin «SIJER».

Sijer dhe Siret, të cilat shprehen si stili i jetës dhe mënyra e jetesës së Profetit (a.s.), nënkuptojnë tërë jetën e tij, moralin, atributet, provat e profesisë së tij, bukuritë e epokës së tij të lumturisë dhe gjendjet e shokëve të tij, më shkurt, shprehin mishërimin e rregullave dhe sjelljeve islame. Nuk është e mundur të jetosh si një besimtar i vërtetë pa e ditur atë jetë me aspektet e saj verbale, faktike dhe të heshtura. Mësimi i këtyre tri fushave fillimisht dhe më pas ngjasimi i gjithë jetës sonë me jetën e atij me një dorëzim dhe dashamirësi të përzemërt, do të nisë një rrugëtim drejt përsosjes në Islam.

I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ka thënë:

“Kushdo që i dëgjon, ruan, kupton dhe ua përcjell të tjerëve fjalët e mia, Allahu ia zbardhtë fytyrën.” (Tirmidhi, Ilm)

Pejgamberi (a.s.), i cili është më i afërt me umetin e tij se sa shpirti i tyre, me cilësitë Rrauf (i dhimbshëm) dhe Rrahim (i mëshirshëm) që Allahu e përshkruan atë, para së gjithash, dëshironte që çdo fjalë që dilte prej tij të dëgjohej me vëmendje, të kuptohej, të mësohej përmendësh dhe pastaj t’u përcillej atyre që nuk e kanë dëgjuar. Këtë dëshirë e shprehu me këtë shprehje kuranore: «Allahu ia zbardhtë fytyrën!» Në fakt, ndërsa gjendjet e botës tjetër përshkruhen me të gjitha aspektet e tyre në suren Kijame, thuhet:

“Shumë fytyra atë ditë do të jenë të ndritshme. (Për shkak të suksesit të përgatitjes së mirë për botën tjetër në jetën e kësaj bote), ato do të shkëlqejnë nga gëzimi. Sepse do të shikojnë bukurinë e Zotit.” (Kijame, 22-23) Shkëlqimi i fytyrës në Ditën e Gjykimit është nderimi me këtë hadith të Profetit nëpërmjet përpjekjeve tona.



Të jesh Karuni i Dijes

— Halit Serhan Erxhivelek —



ËSHTË NJË CAKTIM HYJNOR QË, KUSHDO QË PËRPIQET TË KËRKOJË ZOT TJETËR PËRVEÇ ALLAHUT, AI BËN IDHUJ AQ SA TEKAT E TIJ, DHE KUSHDO QË BESON DHE ADHURON KRIJUESIN E VETËM TË GJITHËSISË, BËHET POSEDUES DHE TRASHËGIMTAR I TË GJITHA VLERAVE DHE PASURIVE TË GJITHËSISË.

Qenia, Emrat dhe Cilësitë e Allahut janë një. Burimi i ngjarjeve dhe i gjërave në botën e ekzistencës është shfaqja e emrave të Allahut. Bazuar në këtë parim, sistemi i mendimit islam vendos një lidhje të pathyeshme ndërmjet botës së ekzistencës dhe Zotit.


Burimi i diturisë është Allahu (xh.xh.), me emrin el-Alim. Allahu ia dhuron diturinë kujt të dojë, aq sa të dojë. Kurse forma e kësaj mirësie, nga ana tjetër, lidhet me parimet që ne i quajmë sunnetullah, si mirësitë e tjera. Rrjedhimisht, dija i jepet njeriut përmes pesë shqisave ose lajmeve, sintetizohet me mendjen dhe kështu formohet dija tek njeriu. Dituria dhe shkenca janë koncepte të ndryshme në këtë kuptim. Ndërsa burimi i dijes është Allahu (xh.xh.), i Cili është el-Alim, shkenca formohet duke marrë dijen nga Allahu përmes burimeve të informacionit dhe duke e sintetizuar atë me mendjen. Ky zinxhir përshkruhet në historinë e Ademit (a.s.), në suren Bekare siç vijon: Allahu (xh.xh.), i mësoi Ademit (a.s.), një njohuri që engjëjt nuk e dinin, pra, i mësoi të gjithë emrat e botës së ekzistencës dhe të Allahut.¹ Engjëjt,² të cilët më parë e konsideronin veten më të lartë se Ademi (a.s.), për shkak të veprave të tyre të mira, pohuan dobësinë e tyre pasi u sprovuan me dijen që nuk ua dha Allahu dhe pranuan se nuk kishin dituri tjetër përveç diturisë që ua kishte dhënë Allahu (xh.xh.).³ Kjo histori na tregon se burimi i dijes është Allahu dhe se nuk ka dije tjetër përveç asaj që na jep Ai.

Pranimi se burimi i diturisë është Allahu është çështje itikadi (besimi) e cila kërkon një pranim paraprak të këtij besimi. Gjatë procesit të reformës, sistemi perëndimor i mendimit, i cili ndërpreu lidhjen e tij me Zotin, ngatërroi burimin e dijes me mjetet me të cilat transmetohet dija dhe mendoi se njohuritë e fituara në shkencat pozitive ishin të transmetueshme vetvetiu. Shembulli më patetik i

1. Shik. Bekare, 31.

2. Shik. Bekare, 30.

3. Shik. Bekare, 32.



kësaj krize të zemrës, që pengon shikimin e Atij që jep mirësinë duke e mbuluar Atë me mjetin nëpërmjet të cilit vjen mirësia, tregohet në historinë e Karunit. Karuni, duke harruar se Allahu, subhanehu ue teala, është Furnizuesi, nuk arriti ta shihte sunnetullahun (ligjin e Allahut) për transferimin e furnizimit tek ai, u shpreh: «Unë e fitova vetë pasurinë time.» - dhe si rrjedhojë, shkaqet i pandehu prej vetes dhe u shkatërrua.⁴ Edhe perëndimorët mendojnë se shkaqet që formojnë diturinë janë burimi i kësaj të fundit. Kështu që janë bërë karunë të diturisë duke thënë “Unë diturinë e kam fituar me dijen time.”

Kjo rrëshqitje e parë e këmbës shkaktoi një pengesë më katastrofike, duke e bërë njeriun të harrojë idenë se burimi i ngjarjeve është vullneti i Allahut. Përgjigjet që mendja pozitiviste ka gjetur për pyetjen «si?», i ka pandehur si përgjigje për pyetjet «pse?» në natyrë, fizikë, kimi etj. Ndërsa zbuloi në natyrë parimet fizike, kimike etj., nuk e kuptoi se këto parime shpjegonin vetëm «si-në» dhe nuk shpjegonin burimin vullnetar të dukurive, domethënë «pse-në». Si rrjedhojë e përfytyroi universin si një rend pa qëllim dhe të rastësishëm që vazhdon me funksionimin e parimeve të shkencave pozitive, me një marrëdhënie mekanike shkak-pasojë. Meqenëse e shpërfilli vullnetin hyjnor, mendoi se marrëdhënia shkak-pasojë që ajo mund të vëzhgonte ishte përgjegjëse për të gjitha ndodhitë. Ndërsa një besimtar i ndriçuar nga shpallja hyjnore sodit mëshirën hyjnore në shiun që bie, një person i shekullarizuar sheh vetëm parimin e kondensimit të ujit. Ngaqë mendja dhe zemra e tij nuk janë të lidhura me Allahun, ai e pranon shkakun si zot, jo krijuesin e shkakut.

Dobësia më e madhe e mendjes pozitiviste është që informacioni të kufizohet nga natyra dhe aftësia e burimit. Kushdo që e pranon syrin e tij si burim i dijes, injoron atë që nuk mund ta shohë, kush pranon transmetimin, e injoron atë që nuk i transmetohet atij dhe kushdo që pranon mendjen, injoron atë që nuk ia kap mendja e tij. Meqenëse besimtari e pranon Allahun si burim të dijes, kufiri i dijes së tij është aq i gjerë sa korniza e vendosur nga Allahu. Ai beson në atë që ka zbritur Allahu, edhe nëse nuk e kupton atë. Sepse mendja nuk është burimi i dijes, ajo është vetëm një mjet sinteze dhe ajo ka nevojë për edukimin e drejtimin nga shpallja hyjnore. Meqenëse mendimi pozitivist e pranon mendjen si vlerë absolute, ai e pranon vetëm atë që mund ta kuptojë dhe e injoron atë që nuk mund ta kuptojë. Ky qëndrim është një marrëzi si dikush që shikon nga sheshi Yskydar dhe pretendon se nuk

ka vend të tillë si Konia ngaqë nuk mund ta shohë atë. Siç është marrëzi të injorosh atë që nuk mund ta shohësh, po ashtu është të injorosh edhe atë që nuk mund ta kuptojë mendja.

Ndërkohë që një shkencëtar pozitivist që jetoi në shekullin e 17-të, i refuzoi konceptet si frymëzimi, spiritualiteti, zymtësia etj. ngaqë nuk mund t'i vëzhgonte, eksperimentonte dhe nuk mund t'i bënte objekt eksperimentesh me mundësitë e atyre viteve, një besimtar analfabet që jetoi në të njëjtat vite i pranoi këto koncepte me sugjerimin e shpalljes të cilës i besonte. Kështu, edhe nëse ai (shkencëtari) ngrihet në nivelin e shkencës që mund të zbulojë rrezet e padukshme dhe efektet e tyre negative-pozitive në materie me mundësitë e sotme, ai (besimtari) prapë se prapë do të jetë superior ndaj shkencëtarit që ecën vetëm me mendjen e tij.⁵

Njeriu ose bëhet rob i Allahut ose i diçkaje tjetër... Nuk ka rrugë të tretë. Gjërat që adhurohen përveç Allahut mund të jenë shumë të ndryshme. Idhujt prej druri dhe guri, trupat qiellorë, kafshët... Por në realitet, të gjitha hyjnitë përveç Allahut janë mishërim i tekave dhe pasioneve të njeriut. Ajo që ai adhuron në fakt është pasioni i tij. Kur njeriu bie nën zgjedhën e tekave të tij, ai fillon të formojë hyjnitë dhe fetë që i përshtaten. Gjëja më e keqe e këtij moçali të tekave dhe pasioneve është mendjemadhësia, kurse idhulli i krijuar nga mendjemadhësia është mendja dhe ekzistenca e vetë njeriut.

Ajo që e bëri shejtanin «Iblis» ndërkohë që ishte «më i nderuari» është mosbindja e tij ndaj urdhrut të Allahut për t'i bërë sexhde Ademit (a.s.), duke adhuruar idhullin e diturisë, inteligjencës dhe natyrës së tij të krijuar nga zjarri. Perëndimorët, duke qenë arrogantë ngaqë kanë zbuluar një pjesë të vogël të rregullave të panumërta fiziko-kimike që Allahu ka vendosur në univers, mohuan zotërimin e Allahut dhe pranuan si zot mendjen e kufizuar që i bëri këto zbulime. Perëndimi, i cili hyjnizoi jo Allahun, burimin e dijes, por copëzat e dijes së dhuruar prej Tij, u bë robi i fizikës dhe kimisë, duke thënë, siç shprehet edhe Dekarti: «Ne do të jemi zotëruesit e natyrës.»

Është një caktim hyjnor që, kushdo që përpiqet të kërkojë zot tjetër përveç Allahut, ai bën idhujt aq sa tekat e tij, dhe kushdo që beson dhe adhuron Krijuesin e vetëm të gjithësisë, bëhet posedues dhe trashëgimtar i të gjitha vlerave dhe pasurive të gjithësisë.⁶

4. Shik. Kasas 78.

5. Shik. Alu Imran, 139.

6. Shik. Enbija, 105.

SA MË SHUMË TË JAPIM, AQ MË SHUMË EKZISTOJMË



— Bestami Jazgan —

Le t'i lutemi Zotit, le të jemi shërbëtorë të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Le të ngrihet kuvendi i fjalës, le të hapet kuvendi i saj; le të mbushemi me dashuri.

- Çfarë është ekzistenca, nga e dimë që ekzistojmë, o mendja ime?

- Përgjigja e kësaj pyetjeje është shumë e thjeshtë për mua. Mund të them: «Mendoj, prandaj ekzistoj.», dhe e zgjidh këtë çështje. Është e lehtë ta thuash, por kur filloj të mendoj, nuk mund të dal nga rrethi vicioz. Gjej një ide të mirë dhe them: «Në rregull, kjo është më e mira.» Më vonë unë ose dikush tjetër gjen një të metë të saj. Ndërsa ndjek të vërteta të reja, truri im djersitet.

- Shumë mirë e shpjegove situatën, mendje.

Allahu (xh.xh.), ka dërguar libra për të hapur rrugën e mendjes. Ai që i njeh më së miri kodet e jetës, sigurisht që është Ai i Cili e ka krijuar jetën. Unë ende i vlerësoj përpjekjet e tua dhe të uroj suksese. Në lidhje me këtë çështje jam kureshtar edhe për mendimet e mikut tonë të lezetshëm, neftsit.

- Si mund ta zgjidh unë një problem që mendja nuk e zgjidh dot, mik? Megjithatë, jam shumë i lumtur që ekzistoj. Nëse pyesni se si e kuptoj këtë, përgjigja është: Ngaqë gjithmonë dua diçka. Unë dua gjithçka, jo diçka. Andaj them: «O Zot, gjithmonë më jep mua!» Kështu e kuptoj që ekzistoj. A e dini? Kam shumë, ama shumë frikë të zhdukem. Sa keq të privohesh nga të



gjitha mirësitë! Ah sikur të flasë zemra dhe unë të qetësohem pak...

- Ju u përpoqët të shpjegoni ekzistencën në mënyrën tuaj. Mendjes sime mund t'i them në një mënyrë modeste: «Dua, prandaj ekzistoj.», por kjo nuk mjafton. Në fakt, ne ekzistojmë aq sa japim. O nefs im, nëse jep me zemër të pastër, do të qëndrosh në parajsë përgjithmonë. Do të kesh shumë herë më shumë mirësi në këtë botë. Megjithatë, zgjedhja prapë se prapë është e jotja.

- Prit një minutë, o zemër! Sa më shumë të japim, aq më shumë pakësohet. Gjëja që nuk më pëlqen aspak është t'u jap të tjerëve prej asaj që është e imja.

- O nefs im, a nuk e vazhdon edhe ti jetën me atë që të japin të tjerët? A ti i krijon të gjitha mirësitë që i ha dhe i pi?

- Epo... Ashtu është, por mua nuk më pëlqen të jap. A ka dikush tjetër në këtë botë përveç meje? Ata le të japin, ata le të japin...

- Gjithsesi, le të të lëmë të qetë. Ne le të vazhdojmë me dashurinë. O mendja ime, në këtë botë më shumë duhet të kesh frikë jo nga ata që e kanë barkun bosh, por nga ata që i kanë sytë dhe zemrën bosh.

- Po tallesh me mua me këto fjalë!

- Epo, atëherë dëgjo. Një sundimtar pa një gjysh duke peshkuar për nipërit e tij buzë liqenit. Meqë i pëlqeu kjo situatë, i tha: "Gjysh, do të kaloj prapë këtej në mbrëmje dhe do të të jap ar sa pesha e peshkut që do të kapësh." Pas kthimit nga shëtitja, mbreti u kthye te plaku. Plaku i tha se nuk kishte mundur të kapte peshk dhe se një kockë e rumbullakët kishte ngecur në grep. Atë e vendosën në njërin anë të peshores dhe një qese ari në anën tjetër. Shigjeta e peshores nuk lëvizti. Edhe pas vendosjes së një qeseje tjetër me flori, prapë se prapë nuk kishte ndonjë ndryshim në peshore. Më pas, një njeri i mençur e mori arin dhe në vend të tij vuri një grusht dhe. Pastaj tha: "Mbreti im, kjo është pjesa e kockave ku gjendet syri. Vetëm një grusht dhe mund t'i ngopë sytë e njeriut."

- Prit, aman... Po ik nga këtu. Nuk dua të bëhem dhe. A nuk e di se kam shumë frikë nga vdekja?

- Mos ki frikë, o nefs! Frika nuk ka asnjë dobi. Mendo pak për farat e atyre perimeve dhe frutave që i do aq shumë. Fara bie në tokë dhe bëhet mik

me të. Zhduket në të, por nga thelbi i farës del një filiz. Edhe njeriu është i njëjtë. Kur bie në tokë, ekzistenca e tij materiale zhduket, ndërsa ekzistenca e tij shpirtërore mbin. Çfarë ka thënë Junus Emre? "Pronari i pasurisë, pronari i pronës, / Ku është pronari i parë i kësaj? / Edhe pasuria, edhe prona janë gënjeshtër, / Orvatu për pak kohë edhe ti."

- Mos u mundo të më ngushëllosh kot. Unë nuk dua të zhdukem.

- Në rregull atëherë. Më lejo të bëj një koment për këtë poezi të Junusit që do të të qetësojë. Po, i nderuari ka thënë të vërtetën, por paratë dhe koha e shpenzuar për hir të Allahut (xh.sh.), nuk mund të jenë gënjeshtër. Madje ato hyjnë bashkë me ne edhe në varr. Çfarë thua për këtë?

- Jo, shoku im, unë as nuk vdes, as nuk jap, as hyj në varr.

- O nefs! A e di çfarë më erdhi në mendje? Dukesh si djali i Nasredinit që kishte kapur hajdutin. Kur djali i tij i tha se kishte kapur një hajdut, Nastradini i kërkoi ta sillte. Djali i tha: «Nuk vjen, baba!» Nastradini i kërkoi ta lëshonte. Djali i tha: «Nuk ikën, baba!»

- Të dashur miq, jetën e dhënë nga Allahu (xh. xh.), duhet ta japim kur të vijë koha, ashtu siç e japim gjënë që e kemi marrë amanet nga dikush kur e kërkon ky i fundit. Në fillim të ushqimit themi besmelenë dhe në fund themi el-hamdulillah. Andaj duhet të themi el-hamdulillah edhe kur të ngrihem nga sofa e jetës. Një poet tha kur poezia e tij u shpërnda si të ishte e Junus Emresë: "Na zhvatën nga vetja. Na vunë flakën. Në kuvendin e dashurisë. Na konsideruan si Junus Emre." Nëse ndjekim urdhrat e Allahut, subhanehu ue teala, dhe Sunetin e Pejgamberit tonë (a.s.), ndoshta edhe ne do të na konsiderojnë prej robërve të mirë. A ka ndonjë rrugë tjetër shpëtimi, i nderuar?



DINJITETI "N JERËZOR

— Mohammad Hashim Kamali —

Pohimi kuranor më eksplisit rreth dinjitetit (kera-meh) njerëzor gjendet në një deklaratë të përgjithshme dhe të pakushtëzuar në të cilën thuhet: “Në të vërtetë, Ne i kemi dhënë dinjitet bijve të Ademit... dhe i kemi ngritur lart mbi pjesën më të madhe të krijimit tonë”. (17:70). Tabloja e përgjithshme që del nga ky verset gjendet e përmbledhur në pohimin e bërë nga komentuesi i Kuranit, el-Alusi, sipas të cilit: “secili prej pjesëtarëve të racës njerëzore, përfshi të devotshmit apo mëkatarët, janë të pajisur me dinjitet.” Juristët dhe komentatorët e shekullit

të XX kanë vërejtur se dinjiteti njerëzor nuk fitohet përmes veprave të mira; ai është një dhuratë ose hir nga Zoti dhe se dinjiteti njerëzor është një e drejtë natyrore dhe absolute i cili është i pranishëm në çdo person që nga momenti i lindjes. Dinjiteti është diçka natyrore dhe i dhënë nga Zoti, prandaj asnjë shtet nuk duhet t’i privojë njerëzit nga ai. Sa i përket çështjes nëse dinjiteti mbetet i paprekur edhe në rastin e një kriminelit, përgjigja e përgjithshme ndaj kësaj çështjeje ka qenë pohuese. I vetmi kusht i vënë është se dinjiteti i një kriminelit është pjesërisht i kompromentuar në masën që vendimi i gjykatës ose ndëshkimi i dhënë duhet zbatuar. Përtej kësaj, dinjiteti personal i të burgosurit duhet zbatuar dhe mbrojtur. Të burgosurit nuk duhet t’i nënshtrohen poshtërimit dhe as të privohen nga e drejta e tyre për gjërat jetike.



Përmendja e pajisjes së njerëzimit me një favor të veçantë hyjnor shpjegohet më tej, në vende të tjera të tekstit kuranor, ku flitet mbi manifestimin e dinjitetit njerëzor, ku, për shembull, deklarohet se pozita shpirtërore e qenieve njerëzore është më e lartë se ajo e engjëjve (7:11). Në këtë ajet, engjëjve dhe Iblisit (Satanait) i kërkohet: “Përlujuni në sexhde Ademit!” - Të gjithë iu përlulën, përveç Iblisit”. Siç rrëfëhet edhe në një ajet tjetër, Iblisi e mbrojt superioritetin e tij duke thënë: “Unë jam më i mirë se ai. Mua më ke krijuar prej zjarrit, kurse atë prej balte”. Pakënaqësia e Zotit me këtë përgjigje iu shpreh Iblisit në formë pyetjeje: “O Iblis, ç’te pengoi ty që të mos përuleshe në sexhde para atij që e kam krijuar Vetë me duart e Mia?” (38:75-76).

Tema është rimarrë sërish në një tjetër kontekst ku Zoti i deklaroi qëllimin e tij, në lidhje me krijimin e njeriut, engjëjve: “Unë do të krijoj një mëkëmbës në tokë”. Teksti vazhdon duke përmendur protestën e engjëjve të cilët thanë: “Ne të madhërojmë, të lavdërojmë dhe të lartësojmë ashtu si të takon Ty, ndërsa njeriu është i prirur të shkaktoj çrregullime e të derdhë gjak në tokë.” Më pas engjëjve u thuhet nga Zoti: “Unë di atë që ju nuk dini”. Menjëherë pas kësaj hasim pohimin se “Allahu ia mësoi Ademit emrat e të gjitha gjërave...” (2:30-32), i cili duket se sugjeron faktin se dija dhe aftësia për të mësuar janë relevante për dinjitetin dhe fisnikërinë e njeriut. Një nivel intimiteti dhe afërsie me Zotin tregohet në pohimin kuranor “Unë e krijova Ademin me duart e Mia”. Në shumicën e herëve të tjera ku përmendet krijimi i Zotit thuhet se kur Ai dëshiron diçka i thotë bëhu dhe ajo materializohet menjëherë. Afërsia e njeriut me Zotin tregohet më qartësisht në pohimin: “Unë fryva brenda tij nga Shpirti Im” (38:72).

Superioriteti shpirtëror i njerëzimit, i përmendur në ajetet e marra në shqyrtim deri më tani, plotësohet më tej duke përmendur përbërjen fizike të njeriut. Në disa ajete kuranore Zoti deklaroi: “Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer” dhe “Ai jua ka dhënë trajtat, jua ka bërë të bukura.” Në një hadith raportohet se një ditë Profeti po qëndronte përpara Qabesë, vendi më i shenjtë i Islamit, dhe në një gjuhë simbolike tha: “Ti je më e kulluara dhe më me dinjitet, por pasha Atë në dorën e të cilit është jeta e Muhamedit, shenjtëria dhe nderi i një besimtarit, jeta dhe pasuria e tij, janë shumë më të mëdha në sytë e Zotit”

Vizioni kuranor për dinjitetin e sotit njerëzor vlen, gjithashtu, edhe për bashkësinë myslimane, të cilën Zoti e ka ngritur në një pozitë nderi (el-izzeh) menjëherë pas vetes dhe të Dërguarit të Tij (63:8).

Kurani e emërton bashkësinë myslimane (ymet) si një “bashkësi të moderuar (umet uasaten - 2:143), e angazhuar në promovimin e së mirës dhe refuzimin e së ligës (3:110) dhe e kushtuar ndaj mbrojtjes së të vërtetës dhe drejtësisë (3:103). Me fjalët e Kuranit të Shenjtë: “Besimtarët dhe besimtare janë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat” (9:71). Kësaj i është dhënë një manifestim më konkret në hadithin e mëposhtëm: “Nëse ndonjë prej jush sheh diçka të ligë ai duhet ta ndreqë atë me dorën e tij, nëse nuk është i aftë ta bëjë një gjë të tillë, atëherë duhet ndreqë me gjuhën e tij dhe nëse nuk është i aftë të bëjë as këtë, atëherë (le ta refuzojë atë) me zemër. Por ky është besimi më i dobët.” Kjo i drejtohet në mënyrë të hapur të gjithë qenieve njerëzore. Në burimet tekstuale nuk gjejmë asnjë evidencë në të cilën të pohohet se jomyslimanët nuk duhet të marrin pjesë në urdhërimin për mirë dhe ndalimin nga e keqja dhe nga korrupsioni e kalbëzimi që rrezikon individët dhe shoqëritë. Në dy thënie të tjera, Profeti ka thënë: “Ana më e bukur e besimit është të kesh sjellje të hirshme” si edhe “Unë jam dërguar në mënyrë që të përsos vlerat morale (midis jush)”

Të drejtat dhe detyrat janë manifestime të dinjitetit njerëzor në të gjitha traditat e mëdha ligjore dhe këtu nuk bën përjashtim as Sheriati. Midis sistemeve ligjore mund të hasen disa dallime në orientim, por për sa i përket Ligjit Islam theksi nuk bie shumë mbi të drejtat dhe obligimet, por mbi drejtësinë. Një qasje e balancuar ndaj të drejtave dhe detyrave është thelbësore për konceptin e drejtësisë në të gjithë traditat kryesore ligjore. Sidoqoftë, sistemet ligjore janë modeluar, në një farë mase, nga bazat filozofike të vizionit të shoqërisë dhe nga një përzierje e balancuar e të drejtave dhe detyrimeve. Tradita liberale perëndimore dhe mbrojtja e fuqishme që ajo i bën individualizmit manifestohet, për pasojë, në vënien e një theksi më të madh mbi të drejtat, ndërsa koncepti islam i drejtësisë ndikohet nga theksi që ai vë mbi spiritualitetin dhe etikën si dhe mënyrën se si kuptohen direktivat e tekstit të shpallur nga racionaliteti dhe interpretimi. Në rastin e Islamit, theksimi priret më shumë të bie mbi detyrimet dhe respektimin për të drejtat e tjetrit se sa mbi ato personale. Rrjedhimisht, Ligji Islam ka anuar më shumë nga detyrimet se sa të drejtat. Këtë temë e kam trajtuar në një tjetër shkrim dhe kam hedhur idenë se dinjiteti njerëzor siguron një bazë më objektive për një doktrinë moderne të të drejtave të njeriut në Islam. Mendoj se kjo duhet

parë si më e preferueshme se sa qasja e bazuar mbi të drejtat, e diskursit të të drejtave të njeriut që u artikulua në “Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut” të vitit 1948. Kjo e fundit vendos një theks më të madh mbi të drejtat krahasuar me obligimet, njësoj siç neglizhon, gjithashtu, edhe të drejtat kolektive të anëtarëve të komuniteteve që janë diskutuar gjerësisht dhe deri në një farë mase edhe ratifikuar nga dy traktate të mëvonshme mbi të drejtat ekonomike dhe mbi të drejtat kulturore dhe sociale, të cilat së bashku me UDHR-në përbëjnë Kartën Ndërkombëtare të të Drejtave.

Megjithatë, hulumtimi im tregon se një qasje ndaj të drejtave të njeriut që bazohet më shumë mbi të drejtat nuk është në harmoni të plotë me temën dhe shqetësimin qendror të Kuranit rreth drejtësisë. Nëse drejtësia, siç është e natyrshme, nënkupton një përzierje të të drejtave dhe detyrave, atëherë një qasje dhe një theksim i njëanshëm mbi njërin prej tyre është i pasaktë. Për më tepër, kritikët kanë shprehur shqetësimin se dinjiteti është një koncept moral dhe jo ligjor, prandaj dhunimi i dinjitetit njerëzor nuk është njësoj si dhunimi i një të drejte. Sips Donnoly: “Të dhunosh një të drejtë shkon shumë më përtej se sa thjesht të dështosh në përmbushjen e një standardi të lartë moral.” Një përgjigje e pjesshme ndaj kësaj kritike është se pesë qëllimet e sheriatit (mekasid) të njohura si darurijati (të cilave i është shtuar edhe një e gjashtë, d.m.th. ruajtja e nderit (el-ird) personal) e kuptojnë dinjitetin njerëzor sipas një koncepti të bazuar mbi të drejtat. Megjithatë, në vijim do ta shqyrtoj më gjerësisht këtë temë në diskutimin tim të doktrinës juridike.

MARRËDHËNIA MIDIS ZOTIT DHE NJERIUT

Në shumë vende dhe kontekste të ndryshme Kuranit flet kaq shumë rreth dashurisë së Zotit për njerëzimin sa që ajo është bërë një tipar karakteristik i marrëdhënies midis Tij dhe njeriut. Megjithatë, në shumë vepra të shkruara nga orientalistët ky aspekt i marrëdhënies midis Zotit dhe njeriut nuk është trajtuar ashtu siç duhet. Në shkrimet e tyre shohim tema të tilla si fuqia absolute e Zotit, të qenurit e Tij një gjykatës i pamëshirshëm, njeriu si shërbëtor i nënshtruar i Tij, etj. Nga tema të tilla shpesh arrihet në përfundimin se “Islami është një sistem obligimesh” në të cilin nuk pranohen të drejtat e individit, pa folur për të drejtat themelore të tij. Në këtë mënyrë, temat teologjike analizohen për të diktuar përfundimet juridike. Krejt ky diskutim neglizhon temat më specifike të *hukm-it*, *adl-*

it, *hak-ut* dhe *vaxhib-it* (ligjit/vlerës, drejtësisë, të drejtës, dhe obligimit) dhe rëndësisë së tyre për të drejtat e individit. Në analizën time i kam trajtuar me kujdes këto elemente dhe kam arritur në një përfundim të ndryshëm.

Një tendencë e ngjashme vërehet edhe midis komentuesve myslimanë të Kuranit, veçanërisht në komentaret e Kuranit (tefsir) të llojit *tefsir bi el-ma'thur* (interpretim i Kuranit i bazuar mbi precedentët), të tillë si ato të shkruara nga Ibn Xharir el-Taberiu (vd. 923), Xhelaludin el-Sujuti (vd. 1505) dhe në veprat e shumë juristëve të Sheriatit të cilët paraqesin një Zot të largët dhe impersonal dhe që theksojnë më shumë madhësinë, fuqinë absolute dhe drejtësinë e Tij se sa afërsinë dhe dashurinë e Tij për njerëzimin. Kjo tendencë në veprat e *tefsir-it* (komentimit të Kuranit) dhe fik'hut (vepra juridike) nuk ka mbetur e pavërejtur dhe është kritikuar nga shumë sufinj dhe mistikë të mëdhenj të Islamit. Sufitë i kanë kritikuar juristët dhe komentuesit e Kuranit për paraqitjen e Islamit si një fe të bazuar vetëm mbi rregullat, për uljen e rolit të dashurisë (*mehabbeh*) së Zotit për njeriun dhe devocionin e njeriut ndaj Tij, në një kohë që dashuria e Zotit për njerëzimin është kaq shumë e pranishme në Kuran dhe Hadith. Sufitë janë të mirënjohur për shprehjet e tyre të pasura dhe të papërmbajtura që tregojnë një devocion të thellë (*ishk*, *ashk*) në të cilin Zoti dhe njerëzimi janë të lidhur me njëri-tjetrin. Një lexim i kujdesshëm i burimeve tekstuale të Islamit do të tregojë se si një princip udhëheqës i Islamit, dashuria e Zotit për njerëzimin, i jep jetë të gjitha aspekteve të krijimit të Tij dhe se dhurimi i dinjitetit “bijve të Ademit” rrjedh nga kjo dashuri.



Dashuria e Zotit manifestohet në shprehjen – e përsëritur shpesh nga Ai në Kuran – e dashurisë për njerëzimin, në shprehjen e besimit në fisnikërinë e njeriut, në dhuntinë e arsyes dhe në kapacitetin e pamasë të tij për njohje dhe kuptim. Shprehja e besimit të Zotit tek njeriu manifestohet, gjithashtu, edhe në caktimin e njerëzimit si kalif (mëkëmbës) i Tij në tokë (2:30-32) dhe në pohimin e Tij të përsëritur se qielli dhe toka janë nënshtruar në dobi të njeriut. Manifestime të tjera të favorit hyjnor ndeshen edhe në providencën hyjnore për t'i mundësuar njerëzimit kënaqësitë e kësaj jete dhe bukurive të saj, bashkangjitur me përkujtimin se njerëzitet nuk duhet të lënë pas dore pjesën e tyre në to. Zoti i drejtohet Profetit duke i thënë: “Kur robërit e Mi të pyesin për Mua, (thuaju se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të atij që lutet, kur ai më lutet Mua” si edhe “Ne e kemi krijuar njeriun dhe, Ne e dimë ç’i pëshpërit atij shpirti i vet. Ne jemi më afër se damari i qafës së vet.” Në një hadith të gjatë *kudsi* (ndryshe nga hadithet e thëna me fjalët e profetit, në hadithet *kudsi* Zoti flet në vetë të parë) të transmetuar nga Buhariu, Zoti i lartësuar ka thënë:

“Ai që ofendon një nga miqtë e Mi (evlijatë e mi) është njësoj si të ketë shpallur luftë kundër Meje... dhe shërbëtori Im më afrohet përmes veprave të mira derisa unë ta dua, dhe kur ta dua, Unë do të bëhem si veshi me të cilin dëgjon, si syri me të cilin sheh, si dora me të cilën zgjatet (për të kapur gjërat). Unë eci me të; kur ai më kërkon Unë jap, kur më kërkon mbrojtje Unë e mbroj”

Pohime të tilla dhe të tjera të ngjashme me to mund të shihen si shprehje të pakushtëzuara të dashurisë së Zotit dhe të hirit të Tij për të gjithë

njerëzimin. Sikurse do ta shpjegojmë më poshtë, këto duhen dalluar nga shprehje të tjera që të sjellin ndërmend disa modele sjelljeje.

Në shumë vende në Kuran dashuria e Zoti shprehet përmes frazës tipike “*inne Allah juhibu*” (Zoti dashuron). Kjo shprehje përdoret për ata që tregohen bamirës ndaj të tjerëve (*inne Allah juhibu el-muhsinin*, Allahu me të vërtetë i do bamirësit, Kuran 2:195), ata që janë të drejtë me të tjerët (*in Allahe juhibu el-muksitin*, 5:42), ata që tregohen të durueshëm gjatë fatkeqësive (...*el-sabirin*, 3:146), ato që janë të ndërgjegjshëm për Të (*el-mutekin*, 9:4), ata që janë të pastër shpirtërisht dhe fizikisht (*el-mutetahirin*, 2:222), ata që pendohen dhe kthehen tek Zoti (*el-teuabin*, 2:222), ata që i mbështeten Atij (*el-muteuekilin*, 3:159) etj. Diku tjetër në Kuran, në një gjuhë me një çiltërsi të pazakontë, Zoti i drejtohet Profetit Musa (Moisi) me këto fjalë: “Unë kam hedhur tek ti dashurinë Time, që të rritesh nën Syrin (kujdesin) tim” (20:39). Kjo temë është vazhduar më tej në vende të tjera, ku dashuria e Zotit mohohet përmes frazës “*inna Allahe la juhibu* (Zoti nuk i do...)”. Kjo shprehje zbatohet ndaj agresorëve, të padrejtëve, atyre që përhapin kalbëzim, arrogantëve dhe mburracakëve, mohuesve të besimit, tradhtarëve, dorëlëshuarve, shkapërdarëve etj Sidoqoftë sentenca kuranore është e larmishme në shprehjet e saj kur, për shembull, në një tjetër ajet, deklaron: “Thuaj: “O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i falë të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti” (39:53). Një miratim i mëtejshëm i këtij mesazhi gjendet në 7:156 ku Zoti thotë: “Mëshira Imë përfshin çdo gjë.”

Manifestime të tjera të marrëdhënies midis Zotit dhe njeriut në Kuran gjenden në konfirmimin dhe dhurimin e lirisë dhe autonomisë morale për qeniet njerëzore (30:30); në deklaratën e Zotit se “S’ka detyrim në fe” (2:256) si edhe “Kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë”. (18:29). Gjithashtu, në një adresim drejtuar profetit, Kurani deklaron: “Kushdo që merr rrugën e drejtë, e bën për dobi të vet. Ndërsa atyre që devijojnë, t’i thuaju: “Unë jam vetëm paralajmërues” (27:92).

MARRËDHËNIET MIDIS NJERËZVE

Vizioni kuranor për njerëzimin është ai i një vëllazërie të vetme, e cila vërtetohet nga pohimi i unitetit dhe barazisë midis të gjithë pjesëtarëve të njerëzimit. Prandaj, në një referencë në lidhje me krijimin e njerëzimit është thënë: “Zoti ju krijoi

prej një shpirti të vetëm (*khalekakum min nefsin uahidetin*), ndërsa prej atij krijoi çiftin, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra...”. Më pas, në të njëjtin ajet, njerëzimi është urdhëruar: “ruajini lidhjet farefisnore (*el-erham*)”. (4:1).

Është domethënës fakti që teksti, përmes përdorimit të termit *el-erham* (lidhje farefisnore), e vë theksin mbi lidhjet vëllazërore midis qenieve njerëzore. Ky term është përdorur zakonisht në Kuran në kontekst të lidhjeve familjare dhe trashëgimisë. Një tjetër pikë në këtë pasazh, që ia vlen të përmendet, është fraza: “Ai ju krijoi ju nga një shpirt i vetëm”, e cila ndeshet në mënyrë identike edhe në një ajet tjetër kuranor (39:6). Kjo frazë nënkupton se Havaja (Eva) nuk është krijuar nga brinja e Ademit (Adamit), siç pohohet ndonjëherë, por është krijuar në mënyrë të ngjashme nga esenca e atij shpirti të vetëm. Ky shpirt, mesa duket, ka hisen e vet në Shpirtin e Zotit, kështu që ai ka një origjinë madhështore të rrafshit më të lartë. Ajo që është e përbashkët midis Ademit (Adamit) dhe Havasë (Evës) është ky shpirt, gjë e cila nënkuptohet nga përmendja e tij në gjininë femërore numri njëjës (d.m.th. *minha* – në frazën *ue khaleka minha zeuxheha* – dhe krijoi nga ajo çiftin), i cili mund të mos i referohet Ademit, por shpirtit të vetëm.

Profeti Muhamed e ka vërtetuar këtë mesazh të unitetit dhe barazisë në hadithin e mëposhtëm: “O njerëz! Krijuesi juaj është Një; ju vini prej të njëjtit paraardhës; të gjithë ju vini prej Ademit dhe Ademi u krijua nga balta” Në lidhje me çështjen e shpërblimit, Kurani e vendos burrin dhe gruan në nivel të njëjtë dhe në të nuk ka shenja të një mëkati fillestar. Përmbledhtazi, meqenëse Islami pajtohet me idenë e një vëllazërie njerëzore të gjerë me bazë të barabartë atëherë “nuk mund të ekzistojë një cënim i dinjitetit të individëve që nuk nënkupton edhe cënimin (e vetë) dinjitetit në tërësi”.

Kurani e sheh martesën si baza e dashurisë dhe mëshirës (*muedeh ue rahmeh*) ku bashkëshortët gjejnë paqe dhe shoqëri dhe janë një “petk mbrojtës” për dinjitetin dhe nderin e njëri-tjetrit. Prindërit janë ngritur në një nivel shumë të afërt me Zotin dhe pasardhësit janë urdhëruar t’i trajtojnë ata, me fjalë dhe vepra, me respektin dhe dinjitetin më të madh, në përputhje me shpirtin e dashamirësisë (*ihsan*) dhe bindjes ndaj tyre (17:23). Teksti kuranor e vë theksin veçanërisht mbi të qenurit mirënjohës ndaj nënës (31:14). Gjithashtu, prindërit janë urdhëruar që të ruajnë lidhjet natyrore të dashurisë dhe dhembshurinë me fëmijët e tyre, të cilët janë “stoli e jetës së kësaj bote” si edhe test për suk-

sesin apo dëshmtimin e dikujt. Trashëgimia më e mirë që dikush mund të lërë pas janë pasardhësit e virtutshëm (18:46).

Sa i përket takimit dhe trajtimit me dinjitet të njerëzve midis njëri-tjetrit, Kurani urdhëron në shumë vende dhembshurinë dhe vëllazërinë me çdokënd, brenda dhe jashtë familjes, veçanërisht kundrejt fqinjve. Besimtarët shpallen vëllazër të njëri-tjetrit (49:15) dhe urdhërohen me të njëjtën gjuhë të pakufizuar që t’i thonë fjalë të mira njerëzve (2:83) dhe sërish “Kur të flisni, flisni me drejtësi...dhe thoni vetëm të vërtetën”. Në vende të shumta, teksti kuranor i paralajmëron njerëzit që të mos ushqejnë mëri, inat, dyshim, përgojim dhe spiunim ndaj njëri-tjetrit.

Gjatë marrëdhënieve të tyre me jomyslimanët dhe me ndjekësit e feve të tjera, myslimanët janë të urdhëruar që të jenë të drejtë dhe të mirë ndaj tyre për sa kohë që ata nuk ndërmarrin veprime armiqësore shtypëse ndaj myslimanëve (60:8). Për sa i përket çështjes së angazhimit në polemika dhe diskutime me të tjerët, myslimanët janë këshilluar “diskutoni me ata në mënyrën më të mirë” dhe “diskutoni me ithtarët e Librit vetëm me mënyrën më të mirë.” Në një kuptim mbrojtës, Kurani parashtron, gjithashtu, direktivën bazë se “s’ka armiqësi përveçse kundër keqbërësve” (2:193). Një akt agresioni duhet ndëshkuar në mënyrë të barasvlershme, por jo më shumë se aq (2:194). Për më tepër, teksti kuranor urdhëron çdokënd “mos e kaloni kufirin, se Allahu nuk i do ata që e kalojnë kufirin” (2:190), në vend të kësaj durimi dhe falja do të shpërblehen prej Zotit (16:126). Profeti Muhamed e ka konfirmuar këtë në një hadith në të cilin pohohet: “Njerëzit janë bijtë e Zotit dhe më të dashurit për Të janë ata që i trajtojnë fëmijët e tyre me dashuri”. Ai ka thënë, gjithashtu, se: “Çdokush që beson në Zotin dhe në Ditën e Fundit, le të flasë kur ka diçka për të thënë ose, përndryshe, le të heshtë” Në një tjetër hadith Profeti ka thënë: “Zoti do të ndëshkojë (në jetën e përtejme) ata që i ndëshkojnë njerëzit në këtë botë”

Një tjetër manifestim i dinjitetit njerëzor në Islam është autonomia morale që Zoti i ka dhuruar njerëzve, ashtu siç përmendet në një hadith të mirënjohur: “Nuk ka bindje në mëkat, bindja është vetëm në sjellje të drejta” Po ashtu, pohohet se Profeti ka deklaruar: “Forma më e mirë e xhihadit është ta thuash fjalën e vërtetë para sundimtarit tiran.”

Rreziku i fshehur në ekrane: Drita blu

Ramazan Maden

Këto shekujt e fundit, botën tonë e kemi ndriçuar me drita artificiale dhe si rrjedhojë edhe vetë jemi ekspozuar ndaj kësaj drite artificiale që kemi prodhuar me duart tona. Sidomos me zhvillimet në teknologji, drita artificiale ndikon në jetën tonë jo vetëm nëpërmjet mjeteve të ndriçimit, por edhe nëpërmjet disa pajisjeve të tjera elektronike. Aventura jonë, e cila filloi me njohjen e ekraneve të televizorëve, tani ka marrë një dimension krejtësisht të ri me telefonat inteligjentë me ekran të vogël që secili prej nesh i ka në duar. Televizori, kompjuteri, telefoni inteligjent, llamba LED etj. Në ditët e sotme jemi nën një rrethim të vazhdueshëm të dritës artificiale. Rreziku që fshihet është drita e dëmshme blu-vjollcë me energji të lartë e emetuar nga këto ekrane dhe llojet e reja të llambave (LED, dritat ksenon).

Në fakt, drita blu është e dobishme për ne, sepse trupi ynë ka nevojë për dritë blu-bruz. Drita në gamën e ngjyrave blu-bruz, që është edhe ngjyra e qiellit, ka një sërë përfitimesh si funksioni i shëndetshëm vizual, rritja e kohës së vëmendjes dhe fokusit, funksionet njohëse në tru, memoria e lidhur me ritmin e gjumit/zgjimit dhe qëndrimi në formë dhe zgjuar gjatë gjithë ditës. Në fakt ne e marrim mjaftueshëm këtë dritë nga dielli gjatë orëve të ditës.¹ Megjithatë, këto që thuhën nuk janë të vlefshme për dritën blu-vjollcë që hyn në jetën tonë me dritë artificiale. Sot, ne jemi vazhdimisht të ekspozuar ndaj dritës blu-vjollcë, veçanërisht përmes kompjuterëve, tabletave dhe telefonave inteligjentë. Ekspozimi ndaj kësaj drite pas një kohe të caktuar në mbrëmje i shkakton më shumë dëm njeriut.

Natën, kur i fikim dritat për të fjetur, tashmë ambienti është krejtësisht i errët dhe në këtë rast, disa sinjale shkojnë në trurin tonë. Hormoni i melatoninës fillon të sekretohet dhe ne biem në gjumë. Megjithatë, nëse vazhdojmë të shikojmë ekranin përpara se të flemë, drita blu-vjollcë e emetuar nga ekрани dërgon sinjale në trurin tonë dhe ushtron presion ndaj sekretimit të hormonit të melatoninës. Si rezultat, hasim në disa negativitete si cilësia e dobët e gjumit, vështirësia për të fjetur dhe ndjenja e lodhjes gjatë ditës.²

Presioni ndaj hormonit melatonin nuk prish vetëm rendin tonë të gjumit. Presioni ndaj këtij hormoni dëmton edhe sistemin imunitar. Kur mendojmë për



këtë periudhë epidemie, është më e qartë se sa i rëndësishëm është sistemi ynë imunitar, apo jo? Kur ky hormon nuk sekretohet mjaftueshëm, rrit rrezikun e kancerit. Falë vetive të tij antioksiduese, hormoni melatonin parandalon dëmtimin e disa toksinave që shkaktojnë dëmtime të indeve.³ Ekspozimi afatgjatë ndaj dritës blu-vjollcë shkakton plakje më të shpejtë. Një eksperiment me mizat e frutave që është kryer nga një studim mbi dëmet e dritës blu-vjollcë është i rëndësishëm. Mizat u ndanë në tri grupe. Njëri grup u ekspozua ndaj dritës blu LED për 12 orë, ndërsa dy grupet e tjera u mbajtën larg dritës blu. U vu re se mizat e frutave të ekspozuara ndaj dritës blu LED për një kohë të gjatë jetuan më shkurt se ato në grupet e tjera. Përveç kësaj, tek këto miza u zbuluan disa probleme neurologjike dhe çrregullime të lëvizjes.⁴

Gjatë ditës, i marrim në dorë telefonat inteligjentë me mërzinë më të vogël, si një kauboj vigjilent. Qëndrimi i mbërthyer në ekran jo vetëm që e bën jetën tonë sipërfaqësore, por ndikon shumë edhe në shëndetin tonë fizik dhe mendor. Pas një gjumi jo të plotë të natës, nuk jemi në gjendje të përqendrohemi në punën tonë, veten tonë apo mjedisin tonë gjatë ditës. Çrregullimi i vëmendjes është ndoshta një nga problemet më të zakonshme që përjetojmë. Për këtë, mund ta ndalojmë përdorimin e telefonit (nëse nuk është shumë i rëndësishëm) disa orë para se të flemë. Mund të shmangim qëndrimin pa qëllim në internet. Veçanërisht mbajtja nën kontroll e fëmijëve tanë në këtë drejtim është e rëndësishme për të ardhmen e tyre dhe tonën.

Në këtë periudhë epidemie, me rritjen e distancës sociale mes nesh, afrohem më shumë me ekranet dhe sa më shumë që i afrohem ekraneve, aq më shumë largohemi nga njëri-tjetri. Në jetën tonë, duhet t'i lëmë më shumë vend blusë së qiellit, sesa dritës artificiale blu-vjollcë. Në fakt, është thënë: «Të shikosh qiellin i bën të dashuruar të mësohen me njëri-tjetrin dhe të afrohen më shumë».⁵ Ndoshta kështu mund të shkurtohet disi distanca mes nesh.

1. Ekixhi, O. K. , Mavi Isigin Karanlık Yüzü / Ana e errët e dritës blu, Revista shkencore dhe teknike TUBITAK, https://bilimteknik.tubitak.gov.tr/system/files/biltek_arsiv/_589_2016_aralik_30.pdf, 14.09.2020.

2. Blue Light: is there a risk of harm, Canadian Association of Optometrists, https://opto.ca/health-library/blue-light-is-there-a-risk-of-harm#_ednref1, 14.09.2020.

3. Atasoj, O. B. , Ojtun, E. , Melatonin hormonunun fizyolojik etkileri / Efektet fiziologjike të hormonit melatonin, FNG & Bilim Tıp Dergisi / Revista FNG & shkencore mjekësore 2017; 3(1):52-62, doi: 10.5606/fng.btd.2017.011.

4. Nash, T. R. , vd. Daily blue-light exposure shortens lifespan and causes brain neurodegeneration in Drosophila, npj Aging and Mechanisms of Disease volume 5, Article number: 8 (2019).

5. Imam Gazaliu, rahmetull-llahi alejh.



RRETH BIOGRAFISË SË TË DËRGUARIT TË ALLAHUT (A.S.)

Bibliografia e të Dërguarit të Allahut (a.s.), është interpretimi aktual i Kuranit

Pse është e domosdoshme që një mysliman të mësojë për jetën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), ta njohë atë dhe të nxjerrë mësimë prej saj?

OSMAN NURI TOPBASH: Sepse lumturia e myslimanit në këtë botë dhe në ahiret varet nga njohja e të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe të jetuarit në gjurmët e tij.

Biografia e Profetit (a.s.), është si një pasqyrë e pastër dhe e dëlirë. Çdo njeri mund të shikojë botën e tij të brendshme dhe të jashtme, gjendjen dhe veprat, moralin dhe sjelljet në atë pasqyrë dhe ta peshojë gjendjen e vet. Është detyrë e çdo besimtarit që ta përmirësojë gjendjen e tij sipas asaj që sheh në këtë pasqyrë.


Morali i të Dërguarit të Allahut (a.s.), është një mirësi e jashtëzakonshme e dhënë si rezultat i edukimit hyjnor. Profeti (a.s.), ishte një i Dërguar që nuk dinte shkrim e këndim. Më-

suesi i tij i vetëm ishte Allahu (xh.sh.). Ai nuk mori mësimë nga asnjë qenie njerëzore, por u bë mësues i mbarë njerëzimit. Psikologjia e sotme, pedagogjia, social-antropologjia etj., sado që ka shkenca që u drejtohen qenieve njerëzore dhe analizojnë shpirtin njerëzor, Profeti (a.s.), përbënte majën e të gjithave. Në shoqërinë e tij nuk kishte as çrregullim psikologjik, as krizë ekonomike, as depresion social. Të gjithë muhadithët (dijetarët e hadithit), mufesirët (komentuesit e Kuranit), dijetarët, të urtët dhe mendimtarët i detyrohen të Dërguarit të Allahut (a.s.), për diturinë dhe urtësinë e tyre.

Në këtë aspekt, mund të themi se të gjitha veprat e botuara në historinë e Islamit janë komente të një libri dhe të një njeriu. Ai libër është Kurani, një mrekulli që do të vazhdojë deri në fund të kësaj bote. Kurse ai njeriu është i Dërguari i Allahut (a.s.), i cili është një interpretim aktual i Kuranit.

Allahu i Plotfuqishëm deklaroi në ajetin fisnik se Ai e zbriti Kuranin në zemrën e të Dërguarit të Tij.¹ Prandaj, njohja shpirtërisht e të Dërguarit të Allahut (a.s.), është hapi

1. Shik. Shuara, 193-195.





më i rëndësishëm në adhurimin e Allahut (xh. xh.). Pa e kuptuar atë, pa i ndjekur hapat e Tij dhe pa marrë pjesë në ndjeshmëritë e Tij të përzemërta, as besimi ynë nuk do të jetë një iman i plotë, as nuk mund ta kuptojmë plotësisht Kuranin, as adhurimi ynë nuk do të jetë një adhurim i plotë. Është i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, ai që na mësoi se si t'i përjetojmë besimin, adhurimin, veprat, sjelljen, moralin, shkurt, si ta përjetojmë Islamin në të gjitha aspektet e jetës sonë.

Për këtë arsye, burimi më i madh i dashurisë që e çon robin në oqeanin e dashurisë hyjnore është i Dërguari i Allahut (a.s.).

Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar thotë në ajetet fisnike:

“Kushdo që i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut...” (Nisa, 80)


“(O i Dërguari im!) Thuaj: Nëse e doni Allahun, më ndiqni mua, në mënyrë që Allahu t’ju dojë dhe t’jua falë mëkatet tuaja...” (Al Imran, 31).

Prandaj, në mënyrë që Islami të jetohet saktë, është e domosdoshme që çdo mysliman të mësojë për jetën shembullore të Profetit dhe të përpiqet të bëjë një jetë në gjurmët e tij.

Në fakt, Allahu i Madhëruar vetëm për Profetin (a.s.), thotë: **“Betohem në jetën tënde...”** (Hixhr, 72) Kështu tërheq vëmendjen për vlerën dhe rëndësinë e biografisë së tij

shembullore. Ai e ka dhuruar jetën e denjë të Hz. Pejgamberit si një kriter praktik për mbarë njerëzimin.

Në të vërtetë, i vetmi profet dhe i vetmi njeri në histori që e gjithë jeta e të cilit është shkruar deri në detajet më të vogla është Profeti Muhamed Mustafai (a.s.). Të gjitha veprimet, fjalët dhe ndjenjat e tij u ndoqën moment pas momenti dhe u regjistruan në tablotë e nderit të historisë. Jeta 23-vjeçare profetike e të Dërguarit të Allahut (a.s.), është një interpretim i gjallë i Kuranit Fisnik.



**BIOGRAFIA
E TË DËRGUARIT
TË ALLAHUT (A.S.), ËSHTË
SI NJË KOPSHT XHENETI I
STOLISUR ME LULE TË RRALLA
E TË MREKULLUESHME DHE ME
TRËNDAFILA ERËMIRË. KUSHDO
QË KËRKON, MUND TË GJEJË
SJELLJEN MË TË BUKUR QË
MUND TË MARRË SI SHEMBULL
PËR VETEN.**

**NË KËTË ASPEKT, JEMI TË
DETYRUAR T'I BËJMË VETES
DISA PYETJE:**

**–SA PËRFITOJMË NGA FLLADI I
PËRSHPIRTSHMËRISË QË FRYN
NGA AI KOPSHT I XHENETIT?**

**–SA ËSHTË E NGJASHME JETA
JONË FAMILJARE ME ATË TË
PROFETIT (A.S.)?**

**–SA ËSHTË JETA JONË TREGTARE
NË MËNYRËN SE SI AI E
MIRATON?**

**– SA ËSHTË JETA JONË
SHOQËRORE BRENDË KUFIJVE TË
VENDOSUR PREJ TIJ?**

I nderuar! Si mund ta shpjegojmë faktin që Profeti u dërgua te gjithë njerëzimi si personalitet shembullor, ndërkohë që temperament, natyra, kushtet psikologjike, sociologjike dhe ekonomike të secilit janë të ndryshme nga njëri-tjetri?

O. N. TOPBASH: Po, një i pasur mund të jetë shembull vetëm për të pasurit dhe një njeri i varfër mund të jetë shembull vetëm për të varfërit. Dikush që nuk ka parë ndonjë vështirësi në jetë, nuk ka vuajtur dhe nuk ka duruar varfërinë, si mund të krijojë një precedent për ata, jeta e të cilëve ka kaluar nëpër sprovat të tilla? Ose e kundërta e kësaj, si mundet një njeri, jeta e të cilit ka kaluar në përndjekje dhe mundime, të jetë shembull për ata që

jetojnë me bollëk dhe rehati?

«NJERËZIT MË TË AFËRT ME MUA JANË TË DEVOTSHMIT NDAJ ALLAHUT, PA MARRË PARASYSH SE KUSH DHE KU JANË.» (AHMED, V, 235; HEJTHEMI, IX, 22.)

PËR KËTË ARSYE, ATA QË E KUPTOJNË MË SË MIRI SIRATU'N-NEBI (BIOGRAFINË E PROFETIT) JANË ATA, JETA E TË CILËVE NGJAN MË SË SHUMTI ME ATË TË TË DËRGUARIT TË ALLAHUT (A.S.). ATA QË E NJOHIN MË SË MIRI ATË JANË BESIMTARËT E DEVOTSHËM, TË CILËT BËJNË NJË JETË ME DEVOTSHMËRI, E ZBATOJNË SUNETIN E TIJ ME PËRPIKËRI DHE QË JANË PASQYRË E ATIJ DIELLI TË MËSHIRËS ME DASHURI DHE MALLËNGJIM.

Ndërkohë, një nga karakteristikat më të rëndësishme të shëmbëlltyrës shembullore të të Dërguarit të Allahut (a.s.), është se ajo krijon një precedent për çdo qenie njerëzore – siç e keni theksuar edhe ju. Meqenëse Allahu i Madhëruar e ka bërë atë një personalitet ideal shembullor për të gjithë njerëzit që do të vijnë deri në ditën e kiametit, e ka kaluar atë në çdo fazë të jetës, nga më e ulëta deri tek ajo më e larta.

Profeti (a.s.), lindi jetim, e pa nivelin e fundit të privimit gjatë viteve të bojkotit dhe përjetoi të gjitha llojet e zullumeve. Më vonë atij iu hapën dyert e begatisë dhe kaloi pothuajse në të gjitha etapat e jetës, deri në pozitat më të fuqishme si “profecia” dhe “kryetari i shtetit”.

Kjo karakteristikë e Profetit, alejhi’s-salam, është një dhuratë dhe mirësi e veçantë e Allahut të Madhëruar që njerëzit nga të gjitha sferat e jetës, nga shtatë në shtatëdhjetë, nga një jetim i dobët deri te një sundimtar i fuqishëm, të mund të gjejnë atë që kërkojnë duke aplikuar në jetën e tij dhe ta marrin atë si shembull.

Nisur nga ky aspekt, pavarësisht situatës në të cilën ndodhemi si myslimanë, duhet ta peshojmë situatën tonë me gjendjen e Profetit (a.s.). Sepse Islami dëshiron që ne ta rregullojmë tërë përmbajtjen e jetës sonë me kriteret e jetës së tij shembullore. Feja jonë sublime pothuajse na thërret në këtë mënyrë:

• Nëse je një njeri i fuqishëm me pasuri dhe pushtet, medito për përlulesinë dhe bujarinë e atij Profeti të madh, i cili dominoi gjithë Arabinë dhe i trajtoi me dashuri të gjithë prijësit e botës arabe!

• Nëse je prej shtetasve të dobët, merr shembull nga jeta e të Dërguarit të Allahut, i cili jetoi në Mekë nën mundimet dhe torturat e politeistëve mizorë!

• Nëse je një predikues që i është nënshtruar shtypjes dhe padrejtësisë, mendo për gjendjen e Pejgamberit të durimit dhe mëshirës, i cili u gjuajt me gurë nga politeistët zemërgur në Taif, por që megjithatë nuk u ankua për gjendjen e tij dhe i kërkoi Allahut të Plotfuqishëm falje e mëshirë!

• Nëse je një çlirimtar fitimtar, merr një mësim nga jeta e Pejgamberit të guximit dhe nënshtrimit, i cili e mundi armikun e tij në Bedr dhe Hunejn! Përfytyro Profetin, në një gjendje mirënjohjeje, i cili, ditën e çlirimit të Mekës, edhe pse ishte një komandant fitimtar, hyri në qytetin e shenjtë me përlulesi të madhe sikur të ishte në sexhde mbi devenë e tij!

• Zoti na ruajt, nëse je mundur, atëherë kujto Profetin, i cili u plagos në betejën e Uhudit dhe nuk e humbi qetësinë mes sahabëve dëshmorëve duke u mbështetur tek Zoti!

• Nëse je një nxënës (student), imagjino Profetin të ulur me edukatë përballë Xhibril el-Eminit, i cili i solli shpalljen hyjnore!

• Nëse je një mësues (pedagog), mendo për Profetin që ua mësoi sahabëve të Suffas në xhami urdhrat hyjnore duke u përcjellë atyre mirësinë e zembrës së tij të butë e të brishtë!

• Nëse je një predikues që jep këshilla, para së gjithash, dëgjoje me gjithë zemër zërin e ëmbël të të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili u shpërndau urtësi shokëve të tij në Mesxhidu'n-Nebevi!

- Nëse dëshiron ta mbash të drejtën dhe ta promovosh drejtësinë në shoqëri dhe nuk ke një ndihmës që të të mbështesë në këtë çështje, shikoni jetën e Pejgamberit, i cili u deklaroi të drejtën zullumqarëve ndërsa ishte i privuar nga të gjitha llojet e ndihmës në Mekë dhe i ftoi ata në udhëzim!

- Nëse je një tregtar që merr rrugë me karvanë të tregtisë, medito për gjendjen e njeriut më të madh të karvanit që shkante nga Siria në Busra!

- Nëse je një gjykatës, mendo për sjelljen e tij të drejtë dhe të matur në vënien e Haxher el-Esvedit në vendin e tij në Qabe, kur të mëdhenjtë e Mekës do të luftonin me njëri-tjetrin!

- Nëse je një njeri i vetëm, mendo për jetimin e Allahut dhe Eminesë, jetimin e pafajshëm, jetimin e ndritur të tyre!

- Nëse je një i ri i rritur, kushtoji vëmendje jetës së denjë të të riut kandidat për profet, i cili kulloste kopenë e xhaxhait të tij, Ebu Talibit, në Mekë!

- Nëse dëshiron të krijosh një vatër të qetë familjare, kushtoji vëmendje jetës familjare dhe këshillave të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Zgjedhja jote le të jetë në favor të takvasë (devotshmërisë) në çdo çështje, në mënyrë që të arrish lumturinë e të dy botëve!

- Nëse je një bashkëshort, kushtoji kujdes jetës së pastër, ndjenjave të thella dhe dhembshurisë së atij njeriu të bekuar që ishte bashkëshorti i Hz. Hatixhesë dhe Hz. Aishes!

- Nëse je një baba, mëso për sjelljen e këtij njeriu, i cili ishte babai i Fatimetu'z-Zehrasë dhe gjyshi i Hasanit e Husejnit, ndaj tyre!

Shkurtimisht, pavarësisht se në çfarë gjendje je, në çdo rast, do ta gjesh të Dërguarin e Allahut (a.s.), si udhëzuesin e përsosur dhe udhërrëfyesin më të mirë për veten tënde. Ai

është një udhërrëfyes i tillë, saqë me sunetet e tij, njeriu mund të korrigojë çdo gabim të tij, të rregullojë punët e tij që mund t'i jenë prishur dhe të përmirësojë gjendjen e vet. Falë udhërrëfimit të tij, arrin lumturinë dhe prehjen e përrjetshme!..

Kjo do të thotë se periudhat e ndryshme në të cilat jetoj Pejgamberi ynë i nderuar (a.s.), gjatë gjithë jetës së tij përmbajnë shumë shembuj të sjelljes ideale për të gjitha segmentet e shoqërisë, madje edhe ata që gjenden në pika të kundërta. Nisur nga ky aspekt, askush nuk mund të ngrihet dhe të thotë:

“Ajo që më ka ndodhur mua, nuk ka një kriter aktual në jetën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), në jetën e sahabëve të edukuar prej tij apo në jetën e profetëve dhe personaliteve shembullore, historitë e të cilëve përmend në Kur'anin e përcjellë prej tij (a.s.)!”

Biografia e të Dërguarit të Allahut (a.s.), është si një kopsht xheneti i stolisur me lule të rralla e të mrekullueshme dhe me trëndafila erëmirë. Kushdo që kërkon, mund të gjejë sjelljen më të bukur që mund të marrë si shembull për veten.

Në këtë aspekt, jemi të detyruar t'i bëjmë vetes disa pyetje:

–Sa përfitojmë nga flladi i përshpirtshmërisë që fryn nga ai kopsht i xhenetit?

–Sa është e ngjashme jeta jonë familjare me atë të Profetit (a.s.)?

–Sa është jeta jonë tregtare në mënyrën se si ai e miraton?

– Sa është jeta jonë shoqërore brenda kufijve të vendosur prej Tij?

– Përderisa zemra e tij rrihte për umetin, sa të ndjeshëm jemi ne ndaj të varfërve, të pafuqishmëve, jetimëve, të vetmuarve dhe atyre që kërkojnë udhëzim?

– Në përgjigje ndaj moralit të tij të lartë, si



umeti i tij, sa e përfaqësojmë fytyrën e buzëqeshur, strukturën e zemrës, strukturën shpirtërore, mirësinë, hirin dhe hijeshinë e Islamit?..

Zotëri, nëse e vlerësojmë në dritën e këtyre të vërtetave, çfarë duhet të kuptojmë kur themi kurrikulë apo përmbajtje të Sijerit (biografisë së Profetit)?

O. N. TOPBASH: Fillimisht, le të themi se Sijeri Nebi (biografia e Pejgamberit) nuk është thjesht një biografi e thatë apo njohuri kronologjike. Me fjalë të tjera, një edukim sijeri, i cili përbëhet nga informacione, si për shembull, në cilin vit ka lindur Profeti, ku ka lindur, kur ka emigruar, në çfarë lufte ka marrë pjesë, në çfarë moshe dhe ku ka vdekur, sigurisht që është larg nga përfitimi i dëshiruar për sa i përket orientimit të jetës së njerëzve.

Nisur nga ky aspekt, edukimi i vërtetë i Sijerit është ta lexojmë me syrin që merr mësim, ta kuptojmë dhe ta përjetojmë sjelljen shembullore që ka shfaqur i Dërguari i Allahut (a.s.), nga djepi deri në varr, moralin e tij të lartë, mësimin dhe predikimin e tij të Kuranit dhe përpjekjen e tij për fenë... Është përpjekja për ta kuptuar ndjeshmërinë, mendimin dhe orientimin e tij.

Nëse kjo thellësi nuk arrihet në edukimin e Sijerit, pra, nëse nuk përfitohet nga jeta shpirtërore e të Dërguarit të Allahut (a.s.), nëse nuk lexohet me ndjeshmërinë e takvasë, me syrin që merr mësim, me urtësi dhe me dashuri, shndërrohet në një nga «shkencat e padobishme».

Fizika, kimia, biologjia, matematika, gjuha, historia, gjeografia dhe shkenca të ngjashme me këto mund të lexohen vetëm me mendje. Por Sijeri Nebi nuk mund të mblidhet vetëm brenda kornizës së njohurive mendore. Jeta e

bekuar e Profetit duhet të lexohet me dashurinë e besimit dhe me sytë e zemrës, në mënyrë që dashuria ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Allahut të shtohet në zemrat tona. Atëherë kjo dashuri do të na çojë në admirim, dhe ky admirim do të na çojë në bindje dhe nënshtrim.

Formën më të përsosur të edukimit të Sijerit e shohim tek sahabët e nderuar. Ndërsa Profeti (a.s.), i edukonte shokët e tij, ai nuk u dha atyre lapsa dhe fletore në dorë. Ai shfaqti një personalitet islam shembullor duke përfaqësuar në fakt moralin e Kuranit.

Sahabët panë një mrekulli të mjeshtërisë hyjnore të manifestuar te njerëzimi në personin e të Dërguarit të Allahut, ata e admiruan atë dhe u përpoqën t'i ngjainin atij. Me gjithë vuajtjet, privimet dhe vështirësitë e kësaj bote, ata u bënë shoqëria më paqësore, «shoqëria e epokës së lumturisë». Sepse ata, me kënaqësinë shpirtërore për të qenë afër Allahut dhe të Dërguarit të Tij, i kapërcyen të gjitha problemet e tyre të kësaj bote. Bota u tkurr (i ra vlera) në sytë e tyre. Me nocionin se “nesër vendi i këtij trupi do të jetë varri”, i lanë pas shqetësimet vetjake të tyre. Ata e kuptuan se shpirti ishte origjinali dhe trupi ishte qenia hije. Duke sakrifikuar qenien e tyre hije, e konsideruan si nder

që shpirtrat e tyre të shkriheshin tek i Dërguari i Allahut dhe që të fitonin një vend në zemrën e tij. Për këtë arsye, ata morën parasysh edhe vdekjen duke thënë:

“Jeta ime, pasuria ime dhe gjithçka të qoftë falë Ty, mjafton të urdhërosh, o i Dërguar i Allahut!”

Ata lanë shtëpitë dhe vendlindjen e tyre dhe bënë hixhret. Morën pjesë në shumë luftëra në rrugën e Allahut dhe u bënë dëshmorë e veteranë.

Me guximin e besimit, lexuan letrat udhë-



MARRËDHËNIA E NJË MYSLIMANI ME TË DËRGUARIN E ALLAHUT NUK ËSHTË VETËM NJË CEREMONI SPECIFIKE PËR KOHË TË CAKTUARA. PËR KËTË ARSYE, MËNYRA MË E MIRË PËR TA RINGJALLUR NATËN E MEVLUDIT ËSHTË;

• FAKTI QË NE JEMI SHPIRTËRISHT ME PROFETIN DHE I BINDEMI ATIJ ME BESNIKËRI GJATË GJITHË JETËS SONË.

• FAKTI PËR TA MBARTUR NË ZEMRËN TONË DERI NË FRYMËN E FUNDIT NDJENJËN: “NËSE I DËRGUARI I ALLAHUT DO TË ISHTE ME NE TANI, A DO TË BUZËQESHTE ME GJENDJEN TONË, APO DO TË TRISHTOHEJ ZEMRA E TIJ E BEKUAR?”



zuese të dërguara nga i Dërguari i Allahut për mbretërit para xhelatëve që ishin gati të merrnin kokat e tyre.

Ata jetuan me entuziazmin dhe emocionin e blerjes së xhenetit me jetën dhe pasurinë e tyre.

Nuk u ndalën, nuk pushuan dhe nuk thanë: «Kaq prej nesh. Tashmë le të përpiqen pak edhe ata që vijnë pas nesh.»

Kudo që kishte një bashkësi njerëzish, ata përpiqeshin të çonin mirësinë e Islamit atje. Shkuan deri në Semerkand, në Kinë, në Kajrevan dhe në Stamboll. Ata nuk e dinin se çfarë ishte lodhja. Asnjëherë nuk ishin në kërkim të rehatisë vetjake. Ata jetuan në një zell gjithnjë në rritje të adhurimit deri në frymën e tyre të fundit.

Me pak fjalë, një edukim i vërtetë i biografisë së Hz. Pejgamberit përfshin të gjitha llojet e aktiviteteve që rrisin dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Allahut, që shtojnë entuziazmin për ndjekjen e Sunetit të Lartë dhe që rrisin përpjekjet fetare në zemra, si tek sahabët.

Epo, zotëri; nga duhet të fillojë dikush që dëshiron ta mësojë Sijerin dhe ta zbatojë Sunetin si mënyrë jetese? Cilat vepra duhet të lexojë dhe çfarë metode duhet të ndjekë?

O. N. TOPBASH: Nuk mjafton ta lexosh jetën e Profetit (a.s.), nga një ose dy burime dhe të thuash: «Unë di.» Leximi dhe mësimi nga librat është i domosdoshëm dhe i dobishëm deri në një masë të caktuar. Megjithatë, ky edukim nuk është i mjaftueshëm për të dhënë rezultatin e


dëshiruar.

Sepse njohja e Profetit (a.s.), është e mundur duke lexuar nga zemra, jo nga rreshtat. Edukimi më i mirë që mund të merret nga biografia e të Dërguarit të Allahut realizohet duke marrë frymëzim nga zemra e dijetarëve dhe të urtëve të devotshëm, të cilët kanë përvetësuar moralin profetik. Në fakt, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

«Njerëzit më të afërt me mua janë të devotshmit ndaj Allahut, pa marrë parasysh se kush dhe ku janë.» (Ahmed, V, 235; Hejthemi, IX, 22.)

Për këtë arsye, ata që e kuptojnë më së miri Siratu'n-Nebi (biografinë e Profetit) janë ata, jeta e të cilëve ngjan më së shumti me atë të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ata që e njohin më së miri atë janë miqtë e Zotit (besimtarët e devotshëm), të cilët bëjnë një jetë me devotshmëri, e zbatojnë Sunetin e tij me përpikëri dhe që janë pasqyrë e atij dielli të mëshirës me dashuri dhe mallëngjim. Sepse ata, me besnikërinë dhe përkushtimin absolut që një hije ka ndaj poseduesit të saj, ndjekin gjurmët e të Dërguarit të Allahut. Ata janë përfaqësuesit më të lartë të moralit profetik të përhapur në kohë, që duhen marrë si shembull nga ata që nuk mundën ta shihnin të Dërguarin e Allahut (a.s.).

Nisur nga ky aspekt, përqendrimi i mendjeve dhe zemrave tona në këtë çështje është një nga mënyrat më të mira për ta njohur të Dërguarin e Allahut, ashtu siç e kuptuan dhe e reflektuan njerëzit e devotshëm Pejgamberin, alejhi's-selam, në jetën e tyre. Një biografi profetike e mësuar me këtë metodë, i jep jetës



PËR SHEMBULL, HZ. HALID IBN ZEJD EBU EJUB EL-ENSARIU, I CILI ISHTE NJËRI NGA TË AFËRMIT E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT (A.S.), UDHËTOI DY HERË NË STAMBOLL NË MOSHËN 80 E DISA VJEÇARE DHE VDIQ ATY SI DËSHMOR. DOMETHËNË, AI NUK THA ASNJËHERË: “MJAFT I KEMI SHËRBYER FESË SË ALLAHUT! TASHMË LE TË DISTANCOHEMI, LE T’I SHËRBEJNË TË TJERËT.” DERI NË FRYMËN E FUNDIT, AI U PËRPOQ PËR BESIMIN E TIJ DUKE E PËRCJELLË MESAZHIN, PREDIKIMIN DHE FTESËN E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT TE ZEMRAT E TJERA.

frymëzim dhe përsjirtshmëri duke depërtuar në zemra.

Edhe ne mund ta njohim të Dërguarin e Allahut (a.s.), në mënyrën më të saktë duke parë jetën e dijetarëve dhe personaliteteve të urta që janë pasardhës të të Dërguarit të Allahut dhe duke lexuar veprat e tyre që janë produkt i zemrës.

Allahu i Plotfuqishëm e përmend “devotshmërinë” në 258 vende në Kuran. Për sa kohë që përjetohet takvaja (devotshmëria), ajo bëhet dylbi për syrin e zemrës. Shumë peizazhe që syri i kokës (syri fizik) nuk i sheh, shihen në ato horizonte shpirtërore që hapen në zemër. Ashtu si zhytësit e aftë që zhyten në det duke parë peizazhe të ndryshme në çdo fazë përkundër atyre që shikojnë nga bregu i detit dhe shohin vetëm sipërfaqen e tij.

Pejgamberin tonë të nderuar e ka parë edhe Ebu Xhehli, edhe Hazreti Ebu Bekri. Ebu Xhehli shikoi katranin në zemrën e tij në atë pasqyrë dhe u bë armik i egër. Kurse Ebu Bekri (r.a.), nga ana tjetër, shikoi një monument të njerëzimit, e admiroi atë dhe u dashurua me gjithë zemër e shpirt me të.

Për këtë arsye, ashtu si shkencat e tjera, edhe biografia e të Dërguarit të Allahut është e nevojshme të mësohet nga personalitete të devotshme dhe jo nga njerëzit që etiketohen si dijetarë, por që u mungon takvaja dhe që i largojnë njerëzit nga hadithi e suneti. Vëllezërit dhe motrat tona të reja, veçanërisht ata që dëshirojnë të marrin arsim fetar, domosdoshmërisht duhet të jenë shumë të kujdesshëm në

këto çështje. Sepse i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, i ka bërë këtë paralajmërim Abdullah ibn Omerit, i cili ishte një nga sahabët e tij të dashur:

“O Ibn Omer! Kapu fort pas fesë, kapu fort pas fesë! Sepse ajo është edhe mishi, edhe gjaku yt. Bëj kujdes se nga kush e mëson fenë! Merri shkencat dhe dispozitat fetare nga dijetarët e drejtë, jo nga ata që janë të prirë djathtas e majtas!”²

Këtë të mos e harrojmë kurrë se jeta e të Dërguarit të Allahut, alejhi’s-salam, është një interpretim i gjallë i Kuranit Fisnik. Suneti i tij i Lartë është shpjegimi dhe komentimi më i saktë i Kuranit Fisnik. Sot, ata që e përjashtojnë Sunetin nën emrin «Islami i Kuranit» dhe që përpiqen t’i zhvlerësojnë hadithet janë manipuluesit e fesë të cilët dëshirojnë “ta interpretojnë vetë Kuranin Fisnik, jo i Dërguari i Allahut, ta përcaktojnë vetë përmbajtjen e fesë, jo Hz. Pejgamberi»... Ne duhet të jemi jashtëzakonisht të kujdesshëm dhe vigjilentë ndaj këtyre, sidomos në ditët e sotme.

Si është e mundur të transformojmë kurrikulën e biografisë së Pejgamberit në një edukim përgjatë gjithë jetës?

O. N. TOPBASH: Para së gjithash, kjo është një çështje përpjekjeje. Duhet përpjekje, duhet sakrificë, duhet praktikë. I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, ua mësoi dhe ua përcolli shokëve të tij çdo ajet që i zbrit në 23 vjet duke i bërë ta praktikonin.

². Hatib el-Bagdadi, el-Kifaje fi Ilmi’r-Rivaje, el-Medinetu’l-Munevvere, el-Mektebetu’l-Ilmijje, fq. 121.

Për shembull, Hz. Halid ibn Zejd Ebu Ejub el-Ensariu, i cili ishte njëri nga të afërmit e të Dërguarit të Allahut (a.s.), udhëtoi dy herë në Stamboll në moshën 80 e disa vjeçare dhe vdiq aty si dëshmor. Domethënë, ai nuk tha asnjëherë: “Mjaft i kemi shërbyer fesë së Allahut! Tashmë le të distancohemi, le t’i shërbejnë të tjerët.” Deri në frymën e fundit, ai u përpoq për besimin e tij duke e përcjellë mesazhin, predikimin dhe ftesën e të Dërguarit të Allahut te zemrat e tjera.

Kështu kthehet Sijeri në një edukim të përjetshëm. Pra, duke bërë një jetë adhurimi me vetëdijen dhe entuziazmin e të qenët një nxënës besnik i të Dërguarit të Allahut (a.s.), deri në frymën e fundit.

Të mos harrojmë se siç ishin sahabët e nderuar nxënësit që u gjunjëzuan para edukimit të Profetit (a.s.), ashtu edhe ne jemi umeti dhe nxënësit e të Dërguarit të Allahut në Kohën e Fundit, të cilët janë adresuesit e të njëjtave ajete dhe hadithe fisnike 14 shekuj më vonë.

Pa marrë parasysh se sa kohë ka kaluar, afërsia me të Dërguarin e Allahut, ashtu si epërsia tek Allahu, varet vetëm nga sekreti i «devotshmërisë».

Marrëdhënia e një myslimani me të Dërguarin e Allahut nuk është vetëm një ceremoni specifike për kohë të caktuara. Për këtë arsye, mënyra më e mirë për ta ringjallur natën e Mevludit është;

- Fakti që ne jemi shpirtërisht me Profetin dhe i bindemi atij me besnikëri gjatë gjithë jetës sonë.

- Fakti për ta mbartur në zemrën tonë deri në frymën e fundit ndjenjën: “Nëse i Dërguari i Allahut do të ishte me ne tani, a do të buzëqeshte me gjendjen tonë, apo do të trishtohej zemra e tij e bekuar?”

- Fakti që të kemi një zemër të ndjeshme e cila mund të paraqesë çdo vendim që marrim dhe çdo hap të rëndësishëm që hedhim në jetë në miratimin dhe aprovimin e Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

Ja, kështu mund ta shndërroni biografinë e të Dërguarit të Allahut (a.s.), në një edukim të përjetshëm. Pra, duke e nderuar gjithmonë Profetin (a.s.) dhe duke e mbajtur atë mbi çdo gjë, madje edhe mbi jetën.

Duke e kuptuar shpirtërisht dhe duke e zbatuar ajetin: «**Profeti ka përparësi ndaj besimtarëve qoftë edhe ndaj vetes së tyre...**» (Ahzab, 6) Duke qenë mirënjohës dhe falënderues ndaj Profetit (a.s.), në çdo kohë dhe duke e dashur Sunetin e tij.

Të mos harrojmë se i Dërguari i Allahut (a.s.), është pasuria jonë më e madhe shpirtërore. Sa do t’ia vltente sikur të gjitha të mirat e botës të ishin tonat, por të mos e njihnim të Dërguarin e Allahut (a.s.)? Sepse edhe jeta jonë në këtë botë, edhe vetë bota janë të përkohshme! Por paqja dhe lumturia që vjen nga njohja e të Dërguarit të Allahut (a.s) dhe ndjekja e tij me gjithë zemër është e pafundme.

Allahu i Madhëruar u dhëntë zemrave tona pjesë nga morali i lartë i të Dashurit të Tij! U dhëntë zemrave tona fllade mëshire nga ndjenjat e thella të sahabëve të bekuar që thoshin: “Nëna, babai dhe jeta ime të qofshin falë, o i Dërguar i Allahut!” Të gjithëve na dhëntë dhe na e mundësoftë me mirësinë dhe begatinë e Tij që të bëjmë një jetë të stolisur me përshepshtshmërinë e Pejgamberit në këtë botë, të mund të pimë nga Burimi i Keutherit në botën tjetër, të mblidhemi nën flamurin Livau’l-Hamd (Flamuri i Falënderimit) dhe të arrijmë ndërmjetësimin e tij!

Amin!..





MESAZHI I KURANIT

— Abdullah Draz —

Kurani, për vetë rëndësinë e madhe që ka, duke qenë jo vetëm libër hyjnor, por edhe gur themeli mbi të cilin është ndërtuar qytetërimi, kultura dhe shoqëria islame, është bërë objekt studimi për shumë shkencëtarë, myslimanë dhe jomyslimanë. Shumë orientalistë janë përpjekur të hedhin dyshime mbi autorësinë e Tij hyjnore, duke ia mveshur atë Muhamedit (a.s.). Mbi mrekullitë shkencore të Kuranit, që vërtetojnë burimin e Tij hyjnor, janë shkruar shumë libra. Por ne këtu do të përqipemi të trajtojmë karakterin hyjnor dhe pamundësinë e Muhamedit (a.s.), për të qenë autor i Kuranit në një këndvështrim ndryshe.

Për myslimanët, Kurani është fjalë e Allahut, si nga përmbajtja edhe nga forma. Ai nuk mund të jetë kurrë një vepër njerëzore. Kurani është një kryevepër letrare dhe estetike. Për nga këshillat, parimet morale, juridike dhe shoqërore që përmban, është një vepër madhështore. Ai po ashtu është një thesar dhe burim i pashtershëm. Për nga informacionet metafizike që jep, është një mrekulli më vete. Një mendimtari ose shkrimtari i mjafton të ketë autorësinë e vetëm një pjese të vogël të këtij libri, për t’u bërë i pavdekshëm në historinë e njerëzimit. Megjithatë, Pejgamberi (a.s.), nuk pretendon autorësinë e këtij libri, të cilin do ta dëshironte çdo shkrimtar. Ai jo vetëm që nuk e pretendon, por me zë të lartë predikon autorësinë e Tij hyjnore. Përballë refuzimit të autorësisë së këtij thesari, kur të tjerët do të sakrifikonin gjithçka për ta pasur, nuk mbetet

gjë tjetër përveçse të pranohet siç është. Është për t’u habitur nga disa që kërkojnë argumente për të pranuar autorësinë hyjnore të këtij libri.

Një mendje djallëzore mund të thotë: Muhamedi (a.s.), ia ka atribuar autorësinë, Allahut për të fituar prestigj dhe autoritet. Por përse i përket lidhjes dhe besimit të fortë të tij tek Allahu, e gjithë jeta e Tij është dëshmi për këtë. Po ashtu, të gjithë janë të një zëri, qofshin miq apo armiq të tij, përse i përket besnikërisë dhe sinqeritetit të tij. Një njeri që thotë vetëm të vërtetën për njerëzit, nuk mund të mendohet se do të gënjejë për Allahun. Historia e Muhamedit (a.s.), na jep një profil të qartë të sinqeritetit dhe besnikërisë së tij. Në një rast kur një grup vajzash të vogla po thurnin vargje lëvduese për dëshmorët e luftës së Bedrit, një vajzë ndër të tjera thuri një varg të tillë: “Në mesin tonë ndodhet një Pejgamber që di të ardhmen.” Pejgamberi (a.s.), sapo e dëgjo, ndërhyri duke e korrigjuar dhe e ndaloi të thoshte një gjë të tillë. Kurse në një rast tjetër, kur vdiq Osman ibn Maz, një grua tha: “Unë jam dëshmitare që Allahu të ka shpërblyer dhe vendosur në një pozitë të lartë.” Pejgamberi (a.s.), i tha: “Ku e di ti se Allahu e ka shpërblyer atë, unë jam i dërguari i Allahut dhe nuk e di përfundimin tim...” Kjo sjellje e tij është paralel me ajetin Kuranor: **Thuaju: “Unë nuk jam i pari i dërguar dhe nuk e di çfarë do të ndodhë me mua ose me ju. Unë ndjek vetëm atë që më është shpallur dhe kam për detyrë vetëm të jap paralajmërimet e qarta.”** (Ahkaf, 9) Të mendojmë

për një moment se Pejgamberi (a.s.), nuk gënjente, sepse kishte frikë se mbas një kohe mund t'i dilte gënjeshtria në shesh. Atëherë, çfarë e pengonte të gënjejtë për çështje metafizike, ku mundësia për t'u zbuluar gënjeshtria nuk ekziston, përveç frikës nga Gjykatësi Suprem.

Vetë Muhamedi (a.s.), ka konfirmuar se fjalët e Tij për nga vlera juridike janë të barasvlefshme me dispozitat kuranore. Prandaj, për të përcaktuar ndalesën apo lejimin e diçkaje nuk është kusht konfirmimi kuranor. Mjafton gjykimi i hadithit për të përcaktuar dispozitën juridike të saj dhe vlefshmëria e kësaj dispozite është e njëjtë me një dispozitë të përcaktuar qartë nga Kurani. Megjithatë, Ai bënte një ndarje të qartë midis hadithit dhe Kuranit. Madje, për një kohë relativisht të gjatë, nga frika e përzierjes me njëri-tjetrin, e pati ndaluar shkrimin e haditheve. Nga ana tjetër, një njeri që ka sadopak shije letrare e kupton shumë lehtë dallimin midis stilit kuranor dhe hadithit sepse kanë stile qartësisht të dallueshme midis tyre. Një kritik letrar, duke lexuar hadithet dhe jetën e Pejgamberit, mund të nxjerrë një profil të qartë në lidhje me mendimet, idetë, ndjenjat dhe botën shpirtërore të tij, gjë që nuk ndodh me Kuranin.

Autori i Kuranit nuk mund të gjendet as midis politeistëve, të krishterëve apo hebregjeve. Sepse Kurani, megjithëse përfshin histori dhe ngjarje nga Bibla dhe Teurati, ai flet për detaje që nuk gjenden në to dhe vherë-herë bën korrigjimet e duhura. Një nxënës, që mëson dy gjëra nga një mësues, nuk mund të marrë guximin të sfidojë mësuesin. Është e pamundur për një person analfabet të japë informacione të tilla të detajuara historike. Detajet historike hasen edhe në numra, si në ajetin:

“Ata qëndruan në shpellën e tyre treqind vjet (diellorë), duke shtuar nëntë (për vitet hënore).” (Kehf, 25.)

Nuk thotë 309 vjet, por treqind plus nëntë për të shprehur ndryshimin midis kalendarit diellor dhe hënor. Kjo është një matematikë shumë e hollë për një analfabet. Nëse të dhënat historike do të ishin produkte të intelektit të tij, patjetër që me kalimin e kohës do të përballlej me gabime. Me-

ndjes së shëndoshë i ka hije të pranojë revelatën hyjnore të Kuranit.

Kurani flet për fitoren dhe triumfin e myslimanëve qysh në periudhën e Mekës. Si mund të marrë guximin një njeri të pretendojë një gjë të tillë në ato kushte që ishin myslimanët, ku ishte në dyshim ekzistenca, jo më të bëhej fjalë për fitore dhe sundim mbi tokë. Si mundet një njeri të jetë kaq i sigurt për fitoren përveçse me ndihmën e një informacioni qiellor? Kush do ta siguronte atë pas vdekjes se feja e tij nuk do të zhdukej?

“Në të vërtetë, jobsimtarët e shpenzojnë parasurinë e tyre për t'i penguar njerëzit nga rruga e Allahut. Ata do ta shpenzojnë atë, por në fund ajo do jetë vetëm dëshpërim për ta, sepse do të jenë të mundur.” (Enfal, 36.)

“Allahu është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me udhërrëfimin dhe fenë e së Vërtetës, për ta ngritur atë më lart se të gjitha fetë, edhe nëse nuk e pëlqejnë idhujtarët.” (Saff, 9.)

Përveç disfatës së mushrikëve, Allahu flet edhe për përplasjet e myslimanëve me hebregjtë. ***“Kudo që gjenden, ata janë të kapluar nga poshtërimi, vetëm nëse kanë ndonjë mbrojtje prej Allahut apo prej njerëzve. Ata merituan zemërimin e Allahut dhe do t'i kaplojë mjerimi.”*** (Al ‘Imran, 111.)

Historia është dëshmitare e poshtërimit të hebregjeve dhe pamundësisë për të jetuar dhe siguruar ekzistencën e një



shteti normal vetëm kur kanë qenë nën mbrojtjen e myslimanëve dhe kur janë mbështetur nga ndonjë fuqi tjetër botërore. Vetëm në këtë mënyrë kanë arritur ta sigurojnë ekzistencën e vet. Si mundet një njeri të japë informata kaq të përpikta dhe të sakta për të ardhmen dhe të kaluarën. Vetëm Krijuesi i gjithësisë mund të japë një verdikt kaq të prerë për një popull të tërë.

Ku e gjente sigurinë se nuk do të vdiste pa e përmbushur misionin? Kjo është një siguri që nuk mund ta pretendojnë as njerëzit më të fuqishëm të botës, sepse vdekja mund t'i vijë në çdo moment njeriut. Një siguri të tillë mund ta japë vetëm Ai që jep dhe merr jetën. **“O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë Mesazhin e Tij; Allahu të ruan ty prej njerëzve. Natyrisht që Allahu nuk i udhëzon njerëzit që nuk besojnë.”** (Maide, 67.)

Kur besimtarët emigruan në Medine, menduan se gjetën qetësinë, mirëpo atje u përballën me luftë, armiqësi dhe rrezik për shfarosje. Në një gjendje të tillë frike dhe pasigurie, ku myslimanët flinin me armë te koka dhe bënin roje me turne për t'u ruajtur nga sulmet, Kurani i lajmëronte për sundim planetar. **“Allahu u ka premtuar atyre që besuan prej jush dhe bëjnë vepra të mira se do t'i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu siç kanë bërë ata para tyre dhe do t'ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe frikën do t'ua shndërrojë në siguri.”** (Nur, 55.)

Përmes këtij ajeti, Allahu u premtonte besimtarëve brenda një kohe të shkurtër sundim botëror. Ky sundim nuk u premtohet vetëm besimtarëve të pranishëm në atë kohë, por të gjithë besimtarëve që do të bëjnë vepra të mira.

Një tjetër anë që tregon burimin hyjnor të Kuranit është mungesa e diturisë dhe informacionit të Pejgamberit (a.s.), në lidhje me disa detaje, përfundime dhe kuptimin e ajeteve. Nëse Kurani do të ishte veprë e Tij, është e pashpjegueshme thurja e vargjeve pa u ditur kuptimin. Për më tepër, kur kjo gjendje i trondiste atij autoritetin dhe shpesh e vendoste në një pozitë shumë qesharake. Një person nuk mund t'i urdhërojë as vetes e as të tjerëve urdhëresa që nuk ua di kuptimin dhe urtësinë. Kjo tregon që Ai ishte thjesht një transmetues i mesazhit.

Në vitin e gjashtë të hixhretit Pejgamberi (a.s.), së bashku me 1500 sahabë nisën nga Medina për në Mekë, për të vizituar vendin e shenjtë, Qaben, sepse kishin vite që nuk e vizitonin dot për shkak të idhuj-

tarëve kurejshë. Nga ana tjetër, myslimanët ishin fuqizuar shumë gjatë kësaj kohe, kurse kurejshët ishin dobësuar nga ana ekonomike dhe ushtarake. Nëse do të donte Pejgamberi (a.s.), mund ta merrte me forcë Mekën që atëherë, por nuk e bëri një gjë të tillë, sepse qëllimi ishte vetëm vizita. Kur arriti në vendin e quajtur Hudejbije, deveja e tij ndaloi së ecuri. Me gjithë përpjekjet, nuk e bënë dot të ecte. Përballë kësaj, Pejgamberi (a.s.), tha: **“E ndaloi Ai, i Cili ndaloi edhe elefantin”.** Kjo nënkuptonte që Allahu, ashtu si nuk lejoi Ebrehenë të pushtonte Qaben me luftë, nuk do të lejonte as myslimanët të merrnin Mekën me luftë. Pejgamberi (a.s.), pa e kuptuar urtësinë iu bind shenjës hyjnore dhe fushoi në Hudejbije, duke e ndaluar kështu përparimin drejt Mekës. Kërkesës së myslimanëve për të vizituar Qaben kurejshët iu përgjigjën negativisht, megjithëse myslimanët ishin të veshur me ihram dhe kishin marrë me vete kafshët për kurban. Pra ishin përgatitur me gjithë zemër për të vizituar Qaben. Megjithëse nuk kishte forcë që mund t'i ndalonte të hynin në Mekë, kurejshët vendosën kushte shumë të rënda për myslimanët. Pejgamberi (a.s.), e pranoi marrëveshjen me gjithë kushtet e rënda që përmbante. Ngaqë nuk mundën të vizitonin Qaben, Pejgamberi (a.s.), i urdhëroi të dilnin nga Ihrami dhe të bënin kurbanet aty ku ishin. Me gjithë bindjen absolute ndaj Pejgamberit, sahabët hezituan në zbatimin e urdhrit të Tij. Omeri (r.a.), si përfaqësues i grupit të pakënaqur me kushtet e marrëveshjes, i thotë Pejgamberit (a.s.): “Përse po e nënçmojmë kështu fenë tonë?” Pejgamberi (a.s.), megjithë rrezikun për t'u përballur me kundërshtimin e të gjithë sahabëve, i përgjigjet: **“Unë jam i Dërguari i Allahut dhe nuk mund t'i dal kundër Atij, Ai është ndihmësi im.”** Me këtë donte të thoshte se edhe ai ishte një njeri si ata dhe marrja e këtij vendimi nuk ishte në kompetencën e Tij. Si përfundim, Pejgamberi (a.s.), së bashku me sahabët u kthyen mbrapsht pa e kuptuar urtësinë e kësaj marrëveshjeje, në pamje të parë krejtësisht në disfavor të myslimanëve. Urtësia e kësaj marrëveshjeje mbeti enigmë, deri sa Allahu e zbuloi në suren Fet'h. Kur u realizuan sihariqet e Kuranit, e kuptuan që marrëveshja, në dukje kundër tyre, kishte qenë një fitore e madhe për ta. Çfarë vlere kanë masat që merr njeriu përballë masave që merr kaderi?! Dijetari i famshëm Zuhri bën një evidentim shumë interesant në lidhje me marrëveshjen e Hudejbijes: **“Asnjë fitore përpara Hudejbijes nuk ka qenë më e madhe se ajo, sepse më parë, sapo myslimanët përballeshin me idhujtarët, fillonte grindja dhe luftimi. Por me nënshkrimin**

e marrëveshjes, gjendja u qetësua, gjakrat u ulën, kjo solli reflektimin e palës kundërshtare dhe gjatë kësaj kohe u kthyen në myslimanë, armiqtë e përbetuar të Islamit, si: Halid ibn Velidi, Amr ibn Asi e shumë figura të tjera të shquara të kurejshëve. Numri i njerëzve që pranuan Islamit gjatë kësaj periudhe, e kaloi numrin e myslimanëve të konvertuar gjatë 19 të viteve të kaluara.”

Një nga kushtet e marrëveshjes ishte që myslimanët të vizitonin Qaben vitin tjetër dhe përveç shpatës që mbahet vazhdimisht me vete të mos merrnin asnjë armë tjetër. Si mund t’u besonin myslimanët kurejshëve, kur ata ishin të gatshëm të bënin gjithçka për të vrarë Pejgamberin (a.s.)? Si mund të ishin të sigurt se ata nuk dëshironin shfarosjen e të gjithëve? Mirëpo Allahu u siguroi atyre kryerjen e rritit dhe kthimin e sigurt. **“Allahu e vërtetoi saktësinë e ëndrrës së të Dërguarit të Tij, Me siguri, ju do të hyni në Xhaminë e Shenjtë, dashtë Allahu, të sigurt, kokërruar dhe flokëshkurtuar, pa kurrfarë frike. Ai e dinte atë që nuk e dinit ju dhe, veç kësaj, ju dhuroi një fitore të afërt.”** (Fet’h, 27.)

Shpallja shpesh vinte në kundërshtim me mendimin e Tij për një çështje të caktuar, madje në disa raste kishte ngjyra të forta kritike.

“Nuk i takon të Dërguarit dhe besimtarëve që të kërkojnë falje për idhujtarët, qofshin këta edhe të afërmit e tyre, pasi u është bërë e qartë se ata janë banorë të Xhehenemit.” (Teube, 113)

Sa për atë që është i pasur, ti atij po i kushton vëmendje, megjithëse nuk ke përgjegjësi, nëse ai nuk dëshiron të pastrohet. Sa për atë që të vjen duke nxituar dhe ndjen frikë (nga Allahu), ti atij nuk po ia vë veshin. Mos vepra ashtu! Në të vërtetë, ky (Kuran) është këshillë, pra, kush të dojë, le të marrë këshillë! (Abese, 5-12.)

“Asnjë profet s’ka të drejtë të ketë rob për vete, derisa të arrijë fitore të plotë në Tokë. Ju dëshironi të mirat kalimtare të kësaj bote, kurse Allahu dëshiron botën tjetër. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë. Sikur të mos ishin urdhërimet e mëparshme të Allahut (për lejimin e plaçkës së luftës), do t’ju godiste një dënim i madh për atë që keni marrë.” (Enfal, 67-68.)

Nëse Muhamedi (a.s.), do të ishte autor i Kuranit, vënia në dukje e gabimeve të veta do ishte jashtë arsyes, i parrokshëm për mendjen e njeriut.

Megjithëse profetët janë njerëzit më inteligjentë dhe të urtë në botë, ata përsëri kanë rënë në gabime. Për ilustrim po japim rastin e Jakubit (a.s.), kur i

akuzoi fëmijët për sjelljen e dëshmisë së rreme në lidhje me gjakun, duke u thënë: **“Nuk është kështu, por ju keni sajuar diçka.”** (Jusuf,18.) dhe në lidhje me vjedhjen në sarajet e Faraonit, kur i thanë se në trastën e Benjaminut u gjet një send i vjedhur. Ai edhe në rastin e dytë tha të njëjtën gjë: **“Nuk është kështu, por ju keni sajuar diçka.”** (Jusuf, 83.) Jakubi (a.s.), në rastin e parë qëllloi, kurse në të dytin gaboi, sepse ata thanë të vërtetën.

Vetë Pejgamberi (a.s.), ka mbrojtur fajtorin duke e gjykuar si të pafajshëm, deri sa i ka ardhur zbulesa hyjnore. **“Vërtet, Ne (o Muhamed) ta kemi zbritur Kuranin me të drejtën, në mënyrë që ti të gjykosh ndërmjet njerëzve sipas asaj që të ka shpallur Allahu. Dhe mos u bëj mbrojtës i tradhtarëve!”** (Nisa,105.)

Shkaku i zbritjes së këtij ajeti ishte gjykimi i gabuar që dha Pejgamberi (a.s.), në lidhje me një vjedhje. Myslimani Tuame ibn Ubejrik i kishte vjedhur parzmoren fqinjët të tij Katade ibn Numanit. Kur Numani filloi kërkimet për gjetjen e parzmores, Ibn Ubejriku nga frika e zbulimit e fshehu parzmoren në oborrin e një hebreu. Kur Numani e gjeti parzmoren në shtëpinë e hebreut, çështjen ia çoi Pejgamberit (a.s.), për gjykim. Kur Pejgamberi (a.s.), e mori në gjykim çështjen, hebreu pohoi se parzmoren e kishte lënë ibn Ubejriku tek ai. Ibn Ubejriku së bashku me një grup burrash nga fisi i tij e mohuan fjalën e hebreut dhe të gjithë dëshmuan se vjedhjen e kishte kryer hebreu. Kur Pejgamberi (a.s.), duke u nisur nga provat dhe dëshmitë po mendonte të jepte gjykim kundër hebreut, zbriti ajeti i mësipërm, i cili e shpallte të pafajshëm hebreun, në këtë mënyrë Allahu zbardhi të vërtetën duke dhënë një gjykim të kundërt me të Pejgamberit (a.s.).

Si mundet një njeri të nxjerrë me anë të mendjes dhe logjikës përfundime të vërteta në lidhje me të ardhmen dhe të shkuarën, kur nuk mund të gjejë të vërtetën midis dy njerëzve në konflikt. Arsyeja dhe inteligjenca humbasin vlerën për sa i përket identifikimit të ngjarjeve që kanë lidhje me të ardhmen dhe botën metafizike. Një njeri që gjykon në këtë sistem, njëherë qëllon dhe shumë herë të tjera gabon. Nëse do të ishte kështu, ajeti Kuranor: **“A nuk përsiatin ata mbi Kuranin! Sikur ai të mos ishte prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie.”** (Nisa, 82.) do të ishte një sfidë e pakalueshme.



Metodologjia e arsyetimit të Kuranit

— Ibrahim Arpaxhë —

Shprehja “në mënyrë që të mendoni”, e cila përmendet shpeshherë në Kuran, është një tërheqje vërejtjeje dhe një paralajmërim në lidhje me çështjen se si duhet të pozicionohet njeriu ndaj Allahut dhe krijesave të Tij në ngjarjet me të cilat përballet. Kur Allahu i Lartësuar e bën këtë paralajmërim, sugjeron një meditim të thellë mbi krijesat e Tij. Ky meditim i thellë realizohet duke menduar dhe duke marrë parasysh zemrën.

Ndërkohë që Kurani Fisnik e sugjeron njeriun që të mendojë, nuk e këshillon që të mendojë në mënyrë të zakonshme, por në mënyrë induksioniste. Kjo fillon nga grimca më e vogël në gjithësi dhe vazhdon deri te sistemi më i madh i dritës në univers. Për këtë arsye, Kurani thekson se mund të meditohej mbi çdo krijesë, duke filluar nga fara në tokë e deri te embrioni i njeriut dhe te një kafshë që i jepet frymëzimi hyjnor. (Bakara, 26) Gjithashtu, duke folur rreth bukurisë së krijimit të njeriut: **“Kështu e kemi rregulluar; sa Rregullues të shkëlqyer jemi Ne!”** (Murselat, 23), e fton njeriun të meditojë edhe mbi veten e tij. Përveç të tjerash, Allahu i Lartësuar ka nxjerrë në pah një terminologji të drejtë mendimi për ne, duke u shprehur: **“Në tokë ka vende që kufizohen njëri me tjetrin dhe ka kopshte me hardhi, edhe ara, pemë me shumë filiza, ujiten nga i njëjti ujë, por frutin e disave e pëlqejmë më shumë për të ngrënë se të disa tjerave. Në këtë ka, me të vërtetë, argumente për njerëzit që kanë mend.”** (Rrad, 4)

Kjo terminologji është arritje te e vërteta duke menduar mbi krijesat.

Domethënë, ndërkohë që Kurani i fton njerëzit të meditojnë, dëshiron që ata të meditojnë edhe mbi terminologjinë e tij. Në këtë mënyrë, e shpëton njeriun nga konceptet e gabuara të shekullit në të cilin gjendemi sot. Ndërkohë që e bën këtë, komunikon me botën e perceptimit të njerëzve duke u dhënë shembuj nga ngjarjet e qarta dhe që mund të vërtetohen. Për shembull, Kurani influencon te njerëzit me shembuj që nuk janë larg jetës së përditshme duke thënë: **“Vallë, a nuk e sheh se si Allahu e përqsas fjalën e mirë me pemën e mirë, e cila rrënjën e ka të fortë në tokë, kurse degët nga**

qielli? Me lejen e Zotit të saj (pema) jep fruta në çdo kohë. Allahu u tregon shembuj njerëzve, në mënyrë që t’ua vënë veshin.” (Ibrahim, 24-25)

Të gjithë duhet ta dimë se njohja e së vërtetës arrihet duke parë nga këndvështrimi që na sugjeron Krijuesi i të vërtetës. Ndërkohë që Kurani shpjegon përmbajtjen e tij, thekson se rruga më e drejtë prej të gjithave është rruga që tregon ai vetë: **“Ditën kur do të sjellim kundër çdo populli dëshmitarë nga gjiri i tyre, Ne do të të sjellim ty (Muhamed) dëshmitar kundër këtyre. Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje, si udhërrëfyes, si mëshirë dhe si lajm të mirë për myslimanët.”** (Nahl, 89)

Përveç të tjerash, nuk duhet ta harrojmë edhe këtë të vërtetë: Filozofia mund t’i përgënjeshtrojë zbulimet e djeshme me të vërtetat e sotme. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për shkencën universale. Ajo mund t’i refuzojë zbulimet e djeshme me të dhënat që ka arritur sot. Pra, kjo është e mundur, por të njëjtën gjë nuk mund ta themi për fetë në përgjithësi dhe për Islam në veçanti. Feja është e pandryshueshme. Ithtari i një feje e ripërtërin besimin e tij me shprehjet e asaj feje që vazhdimisht rrinë të freskëta. Kjo arrihet duke iu afruar mendimeve dhe ideve të kundërta të kohës me një epistemologji fetare.

Kurani Fisnik e ka lidhur fuqinë e besimit me nënshtrimin e zemrës. Për këtë arsye, në shumë vende flet për shikimin dhe mendimin me zemër. Ai e ka lidhur meditimin, të folurin dhe urtësinë me mendimin e zemrës duke thënë: **“Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë, që zemrat e tyre të mendojnë dhe veshët të dëgjojnë? Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë (në këto gjëra), por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor.”** (Haxh, 46)

Kjo ka dalë aq shumë në pah, sa që në historinë islame ka pasur prej atyre që perëndimin e kanë quajtur racional dhe lindjen shpirtërore. Nisur nga kjo, kanë dalë në përfundimin se për shkak të kësaj, pejgamberët kanë dalë nga lindja ndërsa filozofët kanë dalë nga perëndimi.

Në ditët e sotme, për fat të keq, ka shumë me-

ndime sofistike kryesisht në lidhje me problemet e njerëzve. Kurani qëndron larg të gjitha këtyre mendimeve dhe jep shembuj më të përshtatshëm për botën e perceptimit të njeriut. Kur i jep këta shembuj, thotë: **“Allahu nuk ngurron të japë shembull mushkonjën ose diçka më të madhe se ajo. Ata që besojnë, e dinë se kjo është e vërteta nga Zoti i tyre, kurse ata që nuk besojnë, thonë: “Çfarë kërkon të tregojë Allahu me këtë shembull?” Njëpërmjet tij, Ai shumëkënd e lë në humbje e shumëkujt ia ndriçon rrugën e drejtë. Ai i lë në humbje vetëm gjynahqarët e mëdhenj.”** (Bakara, 26)

Në këtë mënyrë, Kurani na tregon se e vërteta nuk është më e madhe se përgjegjësitë që na ka vënë në këtë botë që jetojmë dhe na sugjeron t'i shikojmë me teorinë e urtësisë gjërat që nuk i koncepton mendja jonë.

Ndërkohë na njofton se njeriu nuk ka nevojë të shkojë shumë larg për çfarëdo lloj çështjeje qoftë dhe se, edhe një deve me veçoritë e saj ontologjike mund ta shpjerë njeriun te krijuesi i tij: **“Vallë, a nuk i shohin devetë, se si janë krijuar?! Po qiellin, se si është ngritur?! Po malet, se si janë vënë të patundur?! Po tokën, se si është shtrirë!?”** (Gashije, 17-20)

Domethënë, Kurani na njofton se gjëja që kërkon njeriu nuk gjendet në jetesën laike të mendimit të sotëm kapitalist, por në ndriçimin e vetë Kuranit. Si mesazh të parë, njofton se të pranueshme nuk janë interesat njerëzore, por mendimet e Kuranit.

Njeriu i sotëm punon pa reshtur natë e ditë për gjërat që koha, të cilën përpiqet ta arrijë, ia shfaq si të nevojshme. Më në fund, dëshpërohet edhe më shumë ngaqë nuk i arrin ato, sepse kultura jonë e prodhimit dhe konsumimit nuk është në perspektivën që i jep përparësi Kurani. Në këtë mënyrë, e fusim veten në sprovat e panevojshme të skenës së kësaj bote. Për fat të keq, kemi arritur në një gjendje që nuk e llogarisim dot se çfarë është mirësia e vërtetë dhe cilat janë gjërat më të vlefshme.

Ndërkohë, Kurani thotë se planifikimi i kësaj jete dhe i jetës së botës tjetër arrihet duke menduar drejt. Për këtë arsye, jep shembuj nga natyra e deri te dheu, nga njerëzit e deri te kafshët në lidhje me fushën e jetës që e bëjnë sipas rregullave të tyre. Kur e bën këtë, nuk e sheh të përshtatshme ndërhyrjen në ligjin e zhvillimit natyral të individit (Rahman, 8) dhe nuk e lejon dhunimin e fushës së jetesës së kafshëve: **“Ai e ka bërë tokën për krijesat.”** (Rahman, 10) **“Të gjitha kafshët në tokë e të gjithë shpendët që fluturojnë me krahët e veta, janë në bashkësi të ngjashme me ju...”** (En'an, 38) Nëse e shohim nga një këndvështrim tjetër, Kurani Fisnik ia kujton njeriut se kjo botë nuk i

përket vetëm atij. Pastaj, duke dhënë shembuj nga natyra, qielli dhe toka, urdhëron që t'u dihet vlera mirësive të dhuruara nga Zoti dhe të konsumohen me vetëdije të plotë.

Përsëri në të njëjtën mënyrë, e këshillon njeriun, i cili ka një trup që do kalbet dhe një jetë që do mbarojë, t'i konsumojë trupin, mendjen dhe jetën për ahiretin, i cili është i përhershëm dhe i premtuar. Për këtë arsye, i sugjeron njeriut vazhdimisht që të mendojë dhe meditojë.

Le ta lidhim temën tonë me një hadith fisnik të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.): “Dy vetë shkojnë dhe e vizitojnë Hz. Aishen (r.a.). Njëri prej tyre i tha: “A mund të na tregosh diçka ndikuese që keni parë te Hz. Muhamedi (s.a.s.)?” Hz. Aishja (r.a.), iu përgjigj:

“I Dërguari i Allahut (s.a.s.), një natë u ngrit, mori abdest dhe fali namaz. Ai qau shumë në namaz. Lotët që i rridhnin nga sytë, ia lagën mjekrën dhe vendin përgjatë sexhdes. Hz. Bilali (r.a.), erdhi për namazin e mëngjesit dhe e pyeti: “O i Dërguari i Allahut! Çfarë ju ka bërë të qani, ndërkohë që ju janë falur të gjitha mëkatet e kaluara dhe të ardhshme?” I Dërguari i Allahut (s.a.s.), iu përgjigj: **“Allahu i Lartësuar më ka zbritur një ajet mbrëmë. Ai ajet më ka bërë të qaj.”** Pastaj këndoi ajetin: **“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët.”** (Al Imran, 190) Pasi e këndoi ajetin, i Dërguari i Allahut (s.a.s.), tha: **“Mjerë për ata njerëz që e lexojnë këtë ajet dhe nuk meditojnë rreth tij.”**

Siç shprehet edhe në hadithin fisnik, pasi robi të meditojë rreth gjithësisë së pafundme, arrin ta kuptojë se është i vogël sa një grimcë. Në këtë mënyrë, e percepton dobësinë dhe varfërinë e tij. Pastaj i thyen muret e mendjemadhësisë dhe shtron fletët e modestisë. Ai e zbut zemrën dhe e përgatit atë për zbritjen e mëshirës së Allahut Teala.

Siç mblidhet uji i shiut në gropë, ashtu mblidhet edhe mëshira e Allahut të Madhëruar në zemrën e robit që mendon, që e bën atë që mendon, që e di vendin e tij në univers dhe pozicionohet sipas këtyre që mendon e kupton.

Nëse bëjmë një sintezë ndërmjet Islamit dhe feve të tjera dhe e nisim rrugën nga gazmorja e Nastradinit i cili i tha: “Shko e kërkoje gjilpërën në dritë!”, dikujt që i kishte humbur ajo, mund të themi: “Mësimet e manipuluar të feve të tjera në këtë botë janë një errësirë. Ekzistenca e re nuk gjendet në atë errësirë, por ajo duhet të kërkohet në dritën e Kuranit. Edhe Kurani ua ka shfaqur, u shfaq dhe do t'ua shfaqë këtë dritë atyre që i besojnë dhe meditojnë rreth tij.

PYETJE RRETH KORONAVIRUSIT

— Doç. dr. Fërat Erdoan —

Ndërkohë që po flisnim se çfarë të shkruanim në këtë rubrikë, planifikuam të flisnim për çështje mjekësore që do të kontribuonin në meditimim e lexuesve tanë përtej një rubrike informative shëndetësore. Për këtë arsye, lajmet dhe informacionet nuk ishin prioriteti ynë dhe jemi përpjekur që ta mbajmë sa më të kufizuar pjesën teknike. Por në vitin e fundit, shëndeti; më saktë, kur axhenda botërore ishte e fokusuar te një sëmundje, në mënyrë të pashmangshme duhej ta trajtonim këtë çështje.

Ndjesitë dhe diskutet e panevojshme, madje edhe shumica e gabuar për këtë temë, dhe fakti që ajo nuk korrigjohet nga autoritetet e nevojshme, filluan të shkaktojnë telashe po aq sa vetë sëmundja.

Infektimi me koronavirusin ndoshta do të mbahet mend si “sëmundja që ne e quajmë të bardhë sot dhe të zezë nesër”. Prej kohësh thuhej se maskat ishin të padobishme apo edhe të dëmshme (kjo shprehje qëndron ende në faqen zyrtare më autoritare). Prej muajsh është bërë detyrim ligjor përdorimi i maskës kur dalim në rrugë. Është e mundur t’i shumëfishojmë shembujt, por nuk është e drejtë të fajësosh askënd. Sepse emri origjinal i sëmundjes është virusi «i ri» korona. Shprehja «novel», e cila preferohet më shumë


në origjinalin anglisht, do të thotë jo vetëm e re, por edhe një shpikje/zbulim i ri. Për këtë arsye, të dhënat e marra rishtazi mund të jenë diametralisht të kundërta me ato të tri ditëve më parë. Në këtë artikull, në vend që të flasim gjatë për sëmundjen, dëshirojmë të ndajmë informacione të shkurtra që mund të jenë të dobishme për ju.

A mund të kalohet sërish infeksioni me koronavirus?

Kjo është axhenda jonë më e rëndësishme dhe për fat të keq përgjigja është po (megjithëse mundësia është e ulët). Ditët e fundit ka pasur një rritje të njoftimeve për këtë. Kur një mikrob hyn në trupin tonë, sistemi ynë imunitar prodhon antitrupa si përgjigje. Ata me Ig M tregojnë se e keni sëmundjen për momentin dhe ata me Ig G tregojnë se e keni pasur më parë. Nëse keni fruth Ig G: (pozitiv), patjetër që jeni të mbrojtur nga fruthi. Por informacioni për Corona Ig G nuk është aq i saktë. Sepse mikrobi mund të pësojë mutacion shumë lehtë. Si të thuash; mund të ndryshojë një shifër të numrit AL ID 9-shifror dhe të kthehet sikur të ishte një mikrob i ri dhe t’ju infektojë përsëri. Edhe nëse nuk ka mutacion, nuk është një garanci se do të mbrojë plotësisht, dhe ne nuk e kemi idenë se sa e gjatë është jeta e Ig G. Për këtë arsye, fjalia «Ig G është pozitive, “unë e kam kaluar sëmundjen/kam mbrojtje, nuk ka nevojë për masë mbrojtjeje», tani për tani është e gabuar.

Dimri po vjen. A duhet të marrim vakcina kundër gripit dhe pneumonisë?

Rregulli i përgjithshëm për këto dy vakcina është: Ata që janë në grupin e rrezikut duhet të vaksinohen. Ashtu si ata mbi 65 vjeç, apo ata me sëmundje



kronike... Nuk ka asnjë provë që njerëzit jashtë grupit të rrezikut i bëjnë këto vaksina për t'u mbrojtur nga koronavirusi. Përveç kësaj, të gjithë fëmijët janë vaksinuar në mënyrë rutinë kundër pneumonisë gjatë 10 viteve të fundit. Megjithatë, dihet se vdekjet nga koronavirusi janë të lidhura ngushtë me pneumoninë e shtuar në tabelë para ose pas këtij infeksioni dhe nuk duhet harruar se po flasim për një problem global, jo për një sëmundje personale. Vaksinimi mund të sjellë përfitime në terma të përgjithshëm duke shkaktuar më pak pneumoni te njerëzit, duke reduktuar ngarkesën e punës në spitale dhe duke reduktuar përhapjen e mikrobeve.

Në cilat sipërfaqe qëndron ky virus dhe sa kohë qëndron gjallë?

Kjo çështje është shumë e rëndësishme. Me çantën që keni sjellë nga tregu ose çantën e shkollës së fëmijës suaj, mund ta sillni mikrobin në kuzhinë me duart tuaja. Fatkeqësisht, nuk ka informacion të prerë për këtë. Plastika lejon që mikrobi të qëndrojë i gjallë për një kohë të gjatë (6-8 orë). Megjithëse shifrat nuk janë absolute, mikrobi mund të mbijetojë për 4-5 orë në karton dhe 6 orë në sipërfaqe metalike. Për këtë arsye, është e nevojshme të mendoni dy herë përpara se të shtypni butonin e ashensorit. Meqë jemi duke folur për ashensorët, mendohet se virusi mund të qëndrojë në ajër deri në 3 orë. Nëse nuk është shumë e domosdoshme, është më mirë të mos hipim fare në ashensor. Le të preferojmë materialet një përdorimshe, t'i lajmë nëse është e mundur dhe të paktën ta ajrosim materialin që vjen nga jashtë. Duke qenë se dorezat janë gjithashtu një sipërfaqe ku mund të jetojnë mikrobet, duhet t'i ndërrojmë shumë shpesh ose të mos i përdorim fare dhe t'i lajmë duart shpesh.

A mund të kenë fëmijët koronavirus?

Shifra të ndryshme statistikore vijnë vazhdimisht nga vendet dhe nuk ka konsensus. Studimet që hetojnë pyetjen: «A mund ta marrin fëmijët Covid-19-ën», në shifrat më të thjeshta evropiane, janë bazuar te ata nën moshën 24 vjeç. Një shifër është dhënë si përqindja e vdekjeve, por nuk e dimë se sa janë në të vërtetë fëmijë. Në përgjithësi, pranohet



se probabiliteti i infeksionit serioz dhe vdekjes tek fëmijët është shumë i ulët nëse nuk ka sëmundje serioze themelore (si dështimi i zemrës, mushkërive, kanceri). Megjithatë, sipas të dhënave të fundit të Ministrisë së Shëndetësisë, gjithsej 12 fëmijë të moshës 15 vjeç e poshtë kanë humbur jetën si pasojë e virusit Corona. Gjashtë prej tyre ishin më të vegjël se 2 vjeç, një 2-4 vjeç dhe pesë prej tyre ishin nga 5-14 vjeç. Sigurisht që edhe një jetë është shumë e çmuar, por fatkeqësisht këto shifra janë afër kësaj kur nuk ka Covid. Përveç kësaj, një nga mangësitë e shpjegimit është se nuk përmendet nëse rastet kanë ndonjë sëmundje themelore.

Studimet e kryera në Holandë dhe Spanjë për çështjen e ngjitjes, pohojnë se fëmijët kanë një rrezik dukshëm më të ulët (rreth një të gjashtën e të rriturve) krahasuar me të rriturit. Nga ky këndvështrim, shpresohet që mësimi në shkolla të mos jetë një problem serioz.

A është i mundur mjekimi i tij?

Në përgjithësi, infeksionet virale janë të vështira për t'u trajtuar. Është një frazë ironike që përdoret për këto situata që «nëse ilaçi merret, shërim në një javë, nëse nuk merret, për shtatë ditë».

Ilaçet e përdorura aktualisht për sëmundjen e malaries dhe disa ilaçe të zhvilluara kundër viruseve të tjera kanë rezultuar të dobishme. Ilaçet nuk kanë efekte anësore të dukshme. Kontrolli i EKG-së nevojitet vetëm ngaqë mund të prishë ritmin e zemrës tek fëmijët.

Fatkeqësisht gjërat nuk shkojnë aq mirë sa mesazhet që japin politikanët për çështjen e vaksinës. Nuk ka të dhëna shkencore, por mendimi ynë personal është: Një vaksinë shumë efektive, shumë e besueshme nuk duhet të pritët në afat të shkurtër.

Një çështje tjetër konfuze është përdorimi i barnave me përbërësin aktiv Ibuprofenin. Nuk ka të dhëna shkencore që thonë se ky medikament nuk duhet të përdoret për pacientët e shtruar në njësitë e kujdesit intensiv, përfshirë pacientët me diagnozë të koronavirusit. Pra, mund të përdoret.





SHËNDETI DHE MENDJA JANË NË RREZIK

— Fatma H. Saëm —

“Kujdes, mos i kushtoni rëndësi rënies në peshë! Nuk ekziston masa (trupore) zero. Masa zero është masa trupore e njerëzve të uritur të Etiopisë.”

Këto fjalë, të cilat thuhet për të vënë në dukje gjendjen serioze dhe për të paralajmëruar vajzat adoleshente, i përkasin një modeleje të famshme. Ajo është një person që për të arritur masën zero, nuk hëngri e nuk piu dhe u përball me tretjen e muskujve...

Mania e masës së vogël trupore, e cila shihet më shumë te personat me nivel të lartë socio-ekonomik, në sajë të mediave është përhapur edhe në zonat rurale. Doktorin e njohur turk, Ender Saraç thotë se kjo sëmundje, e cila buron nga pretendimi i tepërt për t’u dukur nga shoqëria mondane, është përhapur në zonat rurale me mendimin: “nëse ke një trup të dobët e ideal, ke më shumë reputacion”.

Tashmë në çdo pjesë të shoqërisë ekziston dë-

shira për t’u dukur i dobët dhe për hir të kësaj praktikohen dieta vdekjeprurëse. Sidomos vajzat e reja, të cilat i kushtojnë shumë rëndësi pamjes së jashtme në moshën e adoleshencës, shtimi më i vogël në peshë, bëhet shkak që ata për hir të dobësisë, të shkatërrojnë trupin dhe të vënë në rrezik shëndetin e tyre. Ato qëndrojnë të uritura, ose e vjellin menjëherë ushqimin që hanë, ose përdorin ilaç pastrues (për zorrët), ose përdorin diuretik, ose marrin hormone të ndryshme dhe bëjnë ushtrime të tepruara.

Në këtë mënyrë, muskujt fillojnë të treten dhe ato fillojnë të mos kenë cikël menstrual. Ato madje mund të përballen edhe me rrezikun për të arritur në një kohë të shkurtër menopauzën. Mëlçia e zezë dhe veshkat falimentojnë, zemra e humb fuqinë e saj dhe fillojnë të dalin në pah sëmundjet e saj.

Të gjitha këto probleme shëndetësore shfaqen si rrjedhojë e dietave vdekjeprurëse të cilat

praktikohen për hir të të qenit belhollë. Vajzat i praktikojnë këto metoda pa njoftuar familjen dhe pa u konsultuar me doktorin. Sado që të dobësohen, përballë pasqyrës akoma e ndjejnë veten të shëndoshë.

Vajzën e re me emrin Hatixhe Danabash, e cila disa vite më parë kishte rënë në 19 kg dhe kishte mbetur kockë e lëkurë, e ndoqëm si një film të frikshëm. Nuk ulej e nuk ngrihej nga dhembja e kockave dhe akoma i dukej vetja e shëndoshë.

Kur punonte në repartin e konfeksionit, shoqet e saj ishin më të dobëta se ajo dhe shoqet e kishin etiketuar si e shëndoshë. Duke parë këtë gjendje dhe duke u ndikuar nga modelet, vendosi të binte në peshë. Në fillim nuk ulej të hante vaktin e drekës, ndërsa më vonë ndërpreu edhe vaktin e darkës. Në fillim e kapi çrregullimi i oreksit; hante deri sa plaste, pastaj e vllite të tërin. Vazhdoi kështu për tre vite me radhë. Familja nuk po kuptonte asgjë. Më vonë e kapi edhe sëmundja e “anoreksisë” dhe tashmë i dukej vetja vazhdimisht e shëndoshë dhe nuk mund të hante asgjë. Unë u ndikova shumë nga një fjalë e saj:

“Pesha për mua ishte më e rëndësishme se bukuria.”

Prof. Dr. Bengi Semerxhi e shpreh kështu pikën kritike që arrin çmenduria dietike:

“Aq i theksuar është te të rinjtë mendimi se bukuria është në masën e vogël trupore dhe se vetëm të dobëtat janë të bukura, saqë një sërë të rinjsh fillojnë të mbajnë dieta për hir të të qenit të bukur. Të rinjtë e moshës pesëmbëdhjetë-njëzet e pesë vjeç, si rezultat i këtyre dietave, e burgosin veten në uri. Një pjesë e këtyre të rinjve nuk mundën në asnjë mënyrë të ndalojnë së praktikuari këto dieta. Tashmë, edhe pse kanë rënë në peshë, e vazhdojnë çmendurinën e dietave. Ata tashmë nuk zbatojnë dietë, por një çrregullim ushqimi që mund t’i çojë drejt vdekjes.

Në daç quajeni anoreksi, në daç bulimi, që të dyja fillojnë me historinë e dietës. Këta të rinj, të cilët i frikësohen shtimit në peshë, por që në shkollë janë mjaft të suksesshëm dhe ambiciozë, nuk e vlerësojnë siç duhet pamjen e tyre fizike dhe fillojnë të shfaqin veprime si: ndërpresin ushqimin, bëjnë ushtrime të tepruara dhe vjellin me dëshirë. Nëse kjo gjendje nuk kuptohet në kohë, mund të përballen me vdekje si pasojë e çrregullimit të të ushqyerit ose vetëvrasjes. Disa të rinj nuk mund të mbajnë dietë të vazhdue-

shme dhe nganjëherë konsumojnë aq shumë ushqim, saqë pothuajse bllokohen. Çdo krizë e të ngrënit, e ndjek pendimi dhe përpjekja për të nxjerrë gjërat që janë ngrënë. Në këtë mënyrë mundohen të qëndrojnë të dobët. Të vjellët dhe çrregullimet e oreksit bëhen shkak për shkatërrimin e fytit dhe sistemit tretës si edhe dëmtimit të rëndë të shëndetit.”

Në raportin e studimit të Helga Dittmarit nga Universiteti Sussex, thuhet: “Këto mënyra të të rënë në peshë, jo vetëm që e pakësojnë respektin që vajzat kanë për trupin e tyre, por, duke mos qenë të kënaqura me masat e tyre trupore, bëhen shkak që ato të kërkojnë trup më të dobët.”

Sipas një studimi të botuar në revistën «**Developmental Psychology**», ndikimet e fotografive të dy lodrave foshnje, njëra Barbi, tjetra me masa trupi më të mëdha, influencuan te 200 vajza që ishin nxënëse të fillores. Të gjitha vajzat kërkonin që të bëheshin si kukulla Barbi. Zëdhënësi i Mattel, prodhuesit të Barbit thotë për revistën Times: “Vajzat e vogla të ditëve të sotme, Barbi i bën të mendojnë se do të kenë çdo gjë që dëshirojnë nëse do të kenë një trup si të saj.” Imazhi që formon Barbi në subkoshiencën e vajzave të vogla, nuk është aspak i pafajshëm.

Allahu në Kuranin fisnik thotë:

“Hani nga ushqimet e shijshme e të lejuara me të cilat ju kemi furnizuar dhe mos e kapërceni kufirin, përndryshe do t’ju zërë zemërimi Im. Ai të cilin e zë zemërimi Im, është i humbur!” (Taha, 81)

Qoftë e ngrëna e tepërt, qoftë dieta për të rënë në peshë, që të dyja janë të tepruara dhe bëhen shkak për problemet shëndetësore që të çojnë drejt vdekjes si dhe nxjerrin në pah ajetin e mësipërm; në këtë mënyrë njeriu shkon në prag të shkatërrimit.

Gjigantët botëror të modës luajnë me imazhin trupor të grave. Sa mësimdhënëse janë këto fjalë të specialistit të modës, Vogtit:

“Masën trupore që duhet të veshin gratë e caktojmë ne me tabelat tona të veçanta të masës.”

Ka të drejtë. Imazhin e masës trupore të grave e caktojnë stilistët evropianë dhe amerikanë. Në vitet 1950 modele ishin gratë me masë 42. Sipas stilistëve të asaj kohe grua e bukur quhej gruaja e majmë. Ndërsa stilistët e sotëm punësojnë modele me masë 32-34. Këto modele që quhen “Masa zero”, bëhen shembull për miliona të rinj.

Më tmerroi një artikull të cilin e lexova pak kohë më parë. Susie Obraxh, një psikoterapiste e njohur e tregon kështu presionin që media bën mbi trupin tonë:

“Përveç hyrjes në tregun arab, revista Marie Claire synon të hyjë edhe në regjimin e vajzave të moshës pesëmbëdhjetë-gjashtëmbëdhjetë vjeçare, në mënyrë që ato të praktikojnë konceptin e ri të bukurisë.”

Kjo qasje është shumë e çuditshme, duke qenë se në kulturën e lindjes të qenit në peshë shihet si tregues i pasurisë!.. Sapo hedh hapin në botën e modës, te njeriu zhduken zakonet e kultura dhe ai shndërrohet në një tip të vetëm.

Tregu i dietës, qenka një treg me një madhësi përafërsisht 30 miliard dollar. Konsulenti i obezitetit, Dr. Haluk Saçakllë thotë se në ditët e sotme ekzistojnë mbi 20 mijë “dieta të rreme”. Disa nga këto janë Atkins, Montignac, Pritikin, Zvicëran, Supë lakrash, South Beach dhe dietat ndarëse, ndërsa disa dieta të tjera që kanë lidhje me acidin dhe për të cilat ka interesim të madh kohët e fundit, janë Dieta e kohës së gurit, dieta Dukan, dieta Karataj etj... Ndërkohë që dhjetë vitet e fundit kanë dalë në treg qindra libra dietash, revista, programe televizive dhe gazeta, sot dy në tre gra mbajnë dietë.

Por në vend që të mbajmë dieta, me konceptin “Ushqyerje e shëndetshme”, që na rekomandojnë doktorët, kemi mundësi të mbrojmë shëndetin dhe të shpëtojmë nga kilogramët e tepërt. Ndërsa praktikimi i vazhdueshëm i dietave bëhet shkak për oreks të tepërt ose për sëmundje të ndryshme.

Një zonjë, e cila është në mbipeshë që në fëmijëri, thotë:

“Në shkollë shokët, në shtëpi prindërit dhe pasi u martova bashkëshorti vazhdimisht janë tallur me peshën time. Vendosa dhe rashë përnjëherë 25 kg. Mendova se çdo gjë do të ishte më bukur, se nëse dobësohesha, lidhja me shoqërinë dhe bashkëshortin do të bëheshin perfekte, por asgjë nuk ndryshoi. Mendova se esenca e ndryshimit ishte vetëm ndryshimi i trupit tim, por unë prapë isha i njëjti person. Shpirti im prapë ishte i shqetësuar... Do të thotë se ndryshimi i lëndës së parë, nuk i ndryshonte përmasat e kuptimit. Ndërsa trupi mbante dietë, shpirti plagosej.”

Fakti se nuk kanë trupin e hollë që kanë cakuar shoqëria dhe autoritetet e modës, i shtyn

personat në mënyrë serioze drejt përplasjes me veten. Në këtë mënyrë ata besojnë se nuk janë të bukur nëse nuk bien në peshë dhe se janë krijesa që nuk ia vlen të duhen e të pëlqehen.

Një herë na ftoi në shtëpinë e saj nusja e një familjeje të nderuar në Levent. Ajo kishte ftuar edhe shoqet e saj dhe në këtë mënyrë u bë një ambient i bukur bisede. Zonjat kërkuan nga ne të luteshim për martesat e tyre dhe vazhdimësinë e lumturisë. Çdo gjë ishte luksoze, kishin shumë njerëz në shërbimin e tyre që kujdeseshin për beben, gatuanin, pastronin shtëpinë, shërbenin ushqimin, kujdeseshin për kopshtin, përdornin makinën dhe përsëri këto gra nuk ishin të lumtura. Gjatë qerasjes vumë re se nuk hëngrën asgjë. Nuk ishin agjërueshëm, por me dietë.

Kur i pyetëm: “Pse mbani dietë, faktikisht ju jeni të dobëta?”, e kishim vënë gishtin në një plagë aq të madhe, sa që na thanë:

“Dje burri pa në gazetë foton e një modeleje dhe duke ma treguar, më tha: ‘Ja, si kjo dua të bëhesh, ke pesë kilogramë mbi peshë.’ Tashmë sytë e burrit tim janë bërë si peshore. Sapo të shtoj pak në peshë, më lajmëron menjëherë duke më thënë ‘Po bien kambanat e rrezikut. Mblidhe veten, sepse e humb formën dhe bëhesh e shëmtuar. Ka shumë rëndësi pamja dhe qëndrimi yt kur je përkrah meje.’”

Dhe thoshin: “Në këtë mjedis nuk ka as edukatë dhe as moral. Mjedisi i këtyre burrave është i privuar nga morali dhe i mbushur plot me gra që shohin rreth e rrotull me të katër sytë hapur për të



gjetur një burrë të pasur. Ato nuk e kanë problem nëse është i martuar apo beqar dhe nuk njohin kufij. Këto gra, janë gra të dobëta, që bëjnë kujdes ndaj peshës së tyre, gazmore, të mbajtura dhe të bukura. Ne nuk mund të mendojmë se burrat tanë nuk mund të heqin dorë prej nesh, sepse në botën e të qenit e bukur, e dobët, e pashme dhe e mbajtur, ka një konkurrencë shumë të madhe. Veçanërisht, nëse burri nuk i frikësohet Allahut, atë nuk mund ta ndalojnë as fëmijët dhe as gruaja e tij.

Gratë që nuk mund të hanë asgjë që dëshirojnë apo që mbajnë dietë me ditë të tëra, nëse kanë ngrënë me mendimin që, “Burri le të më pëlqejë vetëm mua dhe të mos shohë tjetër.”- sikur ta shfaqnin këtë përpikëri në adhurim, shumë shpejt do të bëheshin evlija (robër të dashur të Allahut). A është i qetë shpirti i një gruaje që nuk ha e nuk pi duke menduar se do të arrijë masën 36 të trupit të cilin e do burri i saj? Sepse shpirti dëshiron të adhurojë vetëm Allahun. Ai nuk dëshiron të bëhet rob i rregullave në lidhje me trupin e gruas që mjedisi social ka imponuar.

Mendimi për t’u dobësuar për ndonjë, qoftë burri, shoqja apo prindërit, e dobëson dhe e shkatërron shpirtin. Sepse sforcohen kufijtë që shprehen në ajetin fisnik dhe njeriu e tepron në emër të robërve duke e lënë Zotin.

Ndërkohë që një grua është e vlefshme dhe e ndershme me të qenët e saj një bashkëshorte dhe një nënë, është shumë poshtëruese që ta shohësh atë vetëm si një qenie që i tregohet botës së jashtme dhe me bukurinë e së cilës mund të lavdërohesh. Sa poshtërim i madh është që ta shohësh gruan si diçka të përbërë vetëm nga trupi e pamja e jashtme dhe jo

nga mentaliteti e shpirti!.. Sa i privuar dhe sa i shkretë është një njeri që e pranon veten vetëm si pamje e jashtme dhe trup!.. Shëndeti dhe shpirti ynë janë në rrezik me dietat që bëhen për shkak të presionit të këtyre mendimeve të ulëta. Shqetësimi për pamjen e jashtme, pothuajse e ka kaluar shqetësimin për fenë dhe besimin. Nëse kjo nuk është kalim kufijsh, çfarë mund të jetë tjetër?

“Vajza e re, u bë kurban i X ilaçi dobësimi.”

“Vajza e re që u bë operacion për të shpëtuar nga dhjamërat në zonën e barkut e të ijëve, humbi jetën.”

Tashmë jemi mësuar me lajme të tilla. Sa qartë që shprehet ajeti fisnik. Të kalosh kufijtë në të ngrënë e në të pirë, me të vërtetë i rrokullis njerëzit drejt humnerës.

Në njërën anë fast food-ët, reklamat e shumë ushqimeve, inkurajimi për në çmendurinë e konsumimit... Në anën tjetër të rinjtë ballë përballë me rrezikun e obezitetit, shumë larg lëvizjes dhe në krye të kompjuterit e internetit... Koncepti i botës së modës dhe medias i nxit ata drejt “dëshirës për të pasur trup të hollë” dhe “çmendurisë së dietës”... Njerëz në konfuzion.

Kjo çmenduri diete do të marrë fund ditën kur njerëzit, në çastin që takohen me njëri-tjetrin, nuk do ta vënë re peshën e tyre dhe nuk do të thonë “qenke shëndoshur shumë”, ose “qenke dobësuar shumë”... Nënat tona, bashkëshortet, mikeshat tona u thonë vajzave të reja:

“Dobësohu!.. Nuk do të të nxërë velloja!”

Ndërsa grave të martuara u thonë njerëzit përreth:

“Bjer në peshë! Nëse shëndoshesh, të humb bukuria dhe burri yt do t’i mbajë sytë jashtë te gratë më tërheqëse.”

Kur të mos jepen më këshilla të tilla, atëherë do të marrë fund çmenduria e dietës.

Kur adoleshentëve të mos u jepen si model manekinët me masë zero dhe kur të mos ketë tepricë dhe mangësi gjatë ngrënies e pirjes, çmenduria e dietës do të marrë fund, sepse atëherë njerëzit nuk do të merren me masën trupore të njëri-tjetrit, por me mendjen dhe shpirtin e tyre.

Sepse atëherë njerëzit do të ushqehen shëndetshëm, do të jetojnë një jetë në lëvizje dhe nuk do të ekzistojë problemi i mbipeshës.





Degë Xheneti që zgjaten deri në këtë botë

— Seher Ajdën —

Allahu është më i Mëshirshmi dhe i ka dhuruar çdokujt të mira pa u kursyer aspak; Ai dëshiron që ne ta falënderojmë dhe ta përkujtojmë gjatë gjithë kohës. Krijuesi ynë na ka këshilluar që ta kërkojmë Xhenetin me përgjërime dhe të bëjnë përpjekje për ta merituar dashurinë e Allahut me bindje, plotësimin e detyrave të myslimanit dhe më dhënien e lëmoshës.

Veprimi që bën i pasuri duke dhuruar lëmoshë për një njeri në nevojë, nga njëra anë e ndihmon atë vetë që të fitojë sevape dhe nga ana tjetër bën që të fitojë riskun e vet një njeri i vuajtur. Zekati është një nga adhurimet më të rëndësishme të fesë sonë, ai është urdhëruar në të njëjtën kohë me namazin. Namazi njihet si shtylla kryesore e Islamit, kurse zekati një adhurim që bëhet duke përdorur një pasuri materiale me qëllimin e pas-trimit të pasurisë. Allahu (xh.sh.), na ka shpjeguar se rruga për të hyrë në Xhenet kalon nga namazi dhe infaku (zekati dhe lëmosha).

“Kush do t’i japë Allahut një hua të bukur, që Ai t’ia kthejë shpërblimin shumëfish? Allahu e shtrëngon (riskun) dhe e liron; tek Ai do të ktheheni.” (Bekare, 245)

“Me të vërtetë që për myslimanët dhe myslimi-

manet, besimtarët dhe besimtare, të bindurit ndaj Allahut dhe të bindurat ndaj Allahut, të drejtët (të sinqertët) dhe të drejtat (të sinqertat), duruesit dhe durueset, të përlulurit dhe të përlulurat, mirëbërësit dhe mirëbërëset, agjëruesit dhe agjërueset, ruajtësit e nderit dhe ruajtëset e nderit, përkujtuesit e Allahut vazhdimisht dhe përkujtueset, pra, për të gjithë këta Allahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh.” (Ah-zab, 35)

“Ata që japin lëmoshë e që i japin Allahut një hua të mirë, qofshin burra ose gra, do t’u shumëfishohet përfitimi dhe do të kenë një shpërblim fisnik.” (El- Hadid, 18)

“Nëse i jepni Allahut një hua të bukur, Ai jua kthen shumëfish atë dhe ju fal. Allahu është Mirënjohës dhe nuk nxiton në dënime.” (Tegabun, 17)

Pejgamberi ynë i nderuar na ka treguar se adhurimi që të fut në Xhenet është: **“Adhurimi i Allahut, pa i bërë ortak, falja e saktë e namazit, kujdesi për të afërmit dhe dhënia e zekatit.”** (Buhari, Zekat, 1 ; Myslim, Iman, 12)

Në kohën pas një namazi, Muaz bin Xhebeli e kishte pyetur Pejgamberin tonë të nderuar salalla-

hu alejhi ve selem se cilat janë veprat që na afrojnë me Xhenetin dhe na largojnë nga Xhehenemi. Ai i është përgjigjur:

“Faleminderit që më bërë një pyetje kaq të rëndësishme. Nuk ka dyshim se Allahu e ka bërë shumë të lehtë këtë gjë për disa nga njerëzit. Duhet që të adhurosh Allahun pa i bërë ortak askënd, të falësh namazin ashtu siç duhet, të japësh zekatin, të agjërosh Ramazanin dhe të bësh Haxhin.” (Ahmed bin Hanbel, Mysned, V, 231.)

Në një hadith tjetër, Resulullahu ka thënë:

“Lëmoha do të fikë zjarrin e varrit të njerëzve që kanë dhënë lëmoshë. Në Ditën e Kiametit, besimtari do të strehohet në hijen e lëmoshës.” (Hejsemi, Mecmauz- Zevaid, III, 110.)

Zekati dhe një e dhjeta jepen kur njeriu zotëron një pasuri që arrin vlerën e nisabit. Nga ana tjetër, falja e parave (infak) është të japësh një pjesë të asaj që të gjendet në dorë; atë që Allahu ta ka dhuruar ty, ta ndash me njerëzit e tjerë. Në këtë lloj dhurimi nuk ka kufij të përcaktuar, nuk ka rregulla për të dhënë pak ose shumë. Më e rëndësishmja është të ndash diçka me njerëzit në nevojë dhe ta bësh këtë me sinqeritet dhe dëshirë. Të ndash pasurinë tënde më njerëzit në nevojë, ashtu siç bënë ensarët e Medinës me muhaxhirët e Mekës, që i ndanë së bashku bukën, shtëpinë dhe kafshët... Pejgamberi ynë i nderuar salallahu alejhi ve selem, në lidhje me këtë temë ka thënë:

“Kush nga ju jep lëmoshë qoftw një hurmë nga pasuria që e ka fituar në hallall, Allahu ia llogarit si pesëdhjetë hurma. Pastaj kjo sasi e vogël rritet ashtu siç ndonjëri nga ju e rrit mëzin e vet dhe në Ditën e Llogarisë do t’ju dalë përpara në madhësinë e malit Uhud.” (Buhari, III, 290.)

Pejgamberi ynë i nderuar, salallahu alejhi dhe selem, në lidhje me lëmoshën na thotë këtë lajm të mirë:

“Në çdo lindje të diellit; dy melekë që qëndrojnë pranë diellit thërrasin me një zë që mund të dëgjohet nga të gjitha krijesat përveç njerëzve dhe xhindeve:

‘O njerëz, bashkohuni me Zotin tuaj. Rrisku i pakët por i mjaftueshëm është më i mirë se rrisku i shumë që të shpërqendron.’

Në çdo perëndim të diellit; dy melekë që qëndrojnë pranë diellit thërrasin me një zë që mund të dëgjohet nga të gjitha krijesat përveç njerëzve dhe xhindeve:

‘O Allahu im, shtojë pasurinë e njeriut që ndihmon të tjerët dhe pakësoje mallin e atit që është koprac.’ (Kitabuz Zuhd, Ahmed bin Hanbel, Mysned, V, 197.)

Në Islam ‘dora që jep’ është mbajtur gjithmonë më lart se ‘dora që merr’. Duke filluar që nga Pejgamberi ynë i nderuar dhe për të vazhduar me të gjithë sahabët e tjerë, të gjithë janë treguar të kujdesshëm në këtë temë. Disa prej sahabëve i kanë shpërndarë të gjitha mallrat e tyre dhe u kanë thënë familjeve që kanë mbajtur vetëm dashurinë e Allahut dhe të Resulullahut. Një prej tyre janë Ebu Dahdah dhe gruaja e tij, të cilët e shitën kopshtin e tyre në këmbim të Xhenetit.

Një ditë, një jetim shkoi pranë Resulullahut dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Në kopshtin e filanit është hedhur në tokë një pemë hurme. Jepni urdhër që të ma japin mua atë pemë dhe ta vendosi në mur të shtëpisë sime. Resulullahu, salallahu alejhi ve selem, e thirri burrin dhe i tha:



“Në qoftë se ti do t’ia japësh pemën e hurmës këtij jetimi, unë dal garant se ty do të tw jepet një kopsht me hurma në Xhenet.”

Burri nuk e kishte pranuar këtë kërkesë dhe Ebu Dahdah i kishte thënë:

“Ma jep mua pemën dhe unë do të jap kopshtin tim.”

Burri e kishte pranuar këtë kërkesë me kënaqësi. Pas kësaj marrëveshjeje, Ebu Dahdah kishte shkuar pranë Resulullahut, salallahu alejhi ve selem, dhe i kishte thënë:

“O i Dërguari i Allahut! Unë e kam blerë pemën e atij burri me kopshtin tim. Unë po ta fal ty atë pemë dhe ti thirre jetimin që t’ia japësh pemën e hurmës.”

Rasulullahu, salallahu alejhi ve selem, u gëzua shumë nga ky veprim i Ebu Dahdahut dhe tha:

“Ebu Dahdah u bë pronar i shumë hurmave në Xhenet.”

Ebu Dahdah u largua nga Resulullahu dhe shkoi në kopsht, i tha gruas:

“Dil jashtë nga kopshti. Unë e shita kopshtin në këmbim të një peme të hurmës në Xhenet.” Gruaja iu përgjigj me fjalët:

“Sa këmbim të dobishëm paske bërë, qoftë i bekuar!” (Mexhmauz Zevaid, 10 / 3242)

Çdo gjë që zotërojmë në këtë botë nuk është asgjë tjetër veçse diçka që Allahu na e ka dhënë amanet, na e ka lënë porosi. Të tregohesh dorështrënguar për të dhënë diçka që nuk është e jotja është gabim i madh dhe është një veprim për të cilin janë bërë paralajmërime të shumta. Resulullahu e ka kritikuar edhe Bilalin (r.a.), i cili u ka shërbyer mysafirëve të tij. Një ditë, Pejgamberi

ynë i nderuar e kishte parë Bilalin që po ruante hurma në një cep të mesxhidit, fytyrës së tij të nderuar i kishte ndërruar ngjyra dhe i kishte thënë Bilalit (r.a.):

“Çfarë po bën, o Bilal?”

“Këto janë hurma që po i ruaj për mysafirët tanë që vijnë papritur, o Resulallah!”, i ishte përgjigjur Bilali (r.a.).

Pejgamberi ynë, salallahu alejhi ve selem, i kishte thënë:

“A nuk ke frikë nga avulli i zjarrit të Xhehenemit që është përgatitur për ty? Dhuroje menjëherë atë që ke ruajtur, o Bilal! Mos ki frikë, sepse Zoti i Arshit nuk të lë në vështirësi!” (Mexhmeuz Zevaid, III, 129.)

Si përfundim, Pejgamberi ynë i nderuar na ka porositur me fjalët:

“Bujaria është si një pemë Xheneti, degët e të cilës zgjaten deri në këtë botë; kush mbahet nga degët e saj do të shkojë në Xhenet. Koprancia është si një pemë e Xhehenemit, degët e së cilës mbërrijnë në këtë botë; kush do të mbahet nga degët e saj, do të zvarritet në Xhehenem.” (Shiko: Bejhaki, Shuabul- Iman, VII, 435.)

Allahu na e mundësoftë mbajtjen në degët e pemës së Xhenetit, në mënyrë që të fitojmë dashurinë e Tij dhe të meritojmë Xhenetin. Amin!



NJË MIK I VËRTETË REND PËR TË TË NDIHMUAR EDHE NË BOTËN TJETËR

— M. Sami Ramazanollu —

Fjalët e mëposhtme të Omerit, (r.a.), duhet të skaliten në zemrën e çdo myslimani si moto:

“Kur njëri prej jush të shohë dashuri dhe sinqeritet nga një shok i dashur, le ta mbajë fort. Sepse kjo është një mirësi që nuk arrihet gjithmonë.”

Sa qartë e përshkruan Kurani Famëlartë humbjen dhe zhgënjimin e të qenët i privuar nga një mik i mirë në ajetin e mëposhtëm:

“(Kriminelët në Ditën e Gjykimit do të thonë:) ***Ishin të lig ata që na mashtruan. Tashmë ne nuk kemi asnjë ndërmjetësues (tek Allahu) e as ndonjë mik të ngushtë!***” (Shuara, 99-101)

Ata që miqësohen me kriminelët në këtë botë dhe nuk bëjnë miq të sinqertë, nuk shpresojnë as për ndërmjetës. Në lidhje me interpretimin e këtij ajeti, thuhet kështu në tefsirin Ruhu'l-Bejan:

Një besimtar do të merret në llogari në Ditën e Gjykimit. Veprat e mira të tij do të vijnë të barabarta me veprat e këqija të tij. Ai do të ketë nevojë për një vepër të mirë. Allahu i Madhëruar do t'i thotë:

- Nëse do të gjesh një vepër të mirë, do të të fus në xhenet. Shiko, kërko nga njerëzit; ndoshta dikush do të ta bëjë dhuratë një vepër të mirë. Ai do të shkojë dhe kërkojë një vepër të mirë nga babai dhe nëna e tij. Ata do t'i thonë:

- Sot edhe neve na duhet një vepër e mirë. Ai do të kthehet në vend e tij i pikëlluar dhe do të shprehet:

- O Zot! Nuk ma dhanë qoftë një vepër të mirë. Allahu i Madhëruar do t'i thotë:

- O robi im! A nuk ke pasur qoftë edhe një mik besnik për hirin Tim?

Atëherë robit do t'i kujtohet një mik besnik, do të shkojë te ai dhe do t'i kërkojë një vepër të mirë. Ai miku besnik do t'ia japë dhe ai do ta njoftojë Zotin me entuziazëm. Allahu i Plotfuqishëm do t'i thotë:



- Ta pranova. Me të vërtetë të kam falur edhe ty, edhe mikun tënd besnik!

Ja pra, ky është virtyti i fitimit të një miku besnik. Kështu bëhet e dukshme epërsia e vëllait fetar ndaj vëllait të gjakut. Në fakt, ajeti vijues e shpjegon këtë virtyt:

“O besimtarë! Kini frikë Allahun dhe qëndroni me të sinqertët.” (Teube, 119)

Në këtë ajet fisnik, Allahu i Madhëruar urdhëron rreptësisht që të jemi së bashku me të sinqertët, në përputhje me devotshmërinë, bazuar në rëndësinë e miqësisë me të sinqertët. Edhe ky hadith fisnik i mëposhtëm e shpjegon këtë të vërtetë:

Allahu i Lartësuar i shpalli Davudit, alejhi's-selam:

«- O Davud! Pse të shoh kaq të vetmuar? Davudi, alejhi's-selam, i dha këtë përgjigje:

- O Zot! I mërzita njerëzit ngaqë të kënaqa Ty. Nisur nga kjo, Allahu i Madhëruar i tha:

- O Davud! Eja në vete dhe gjej një vëlla besnik e të sinqertë! Mos u bëj mik me ata që përpiqen të të afrohen me një dashuri që nuk synon pëlqimi Tim! Sepse, një njeri që është i privuar nga dashuria Ime, nuk mund të jetë mik për ty. Ai ta ngurtëson zemrën dhe të largon nga Unë.»

Një fjalë e çmuar e Omerit është siç vijon:

“Nëse një njeri agjëron gjatë ditës dhe preokupohet me adhurim gjatë natës, nëse bën vepra të mira dhe shkon në xhihad, prapë se prapë nuk do të përfitojë nga ibadeti i tij nëse nuk e do për hir të Allahut atë që e do dhe nëse nuk e urren për hir të Allahut atë që e urren.”

Mahmud Sami Ramazanogllu, Musahabe-4, fq. 63- Botimet Erkam

A ekziston te fëmija ynë vështirësia në të mësuar?

— Psik. Tuba Sëkmen —

“Gjendja që përjetojnë fëmijët, të cilët kanë vështirësi në të mësuar, është shumë e ngatërruar.”

Vështirësia në të mësuar është një problem, që ndikon më shumë negativisht në jetën arsimore të personave, e vështirëson të mësuarit në fusha të caktuara, por që nuk ka lidhje me shkallën e përgjithshme të inteligjencës së njeriut. Për personat që kanë vështirësi në të mësuar mund të jetë mjaft i vështirë dhe i ngatërruar leximi me dëshirë i disa faqeve të një libri, regjistrimi i një numri telefoni apo mbajtja e një shënimi në cepin e një libri. Edhe njerëzit që kanë shkallë të lartë inteligjence, mund ta përjetojnë këtë problem. Regjistrimi i diçkaje shumë të thjeshtë në kujtesën e tyre mund të kërkojë përpjekje dhe një kohë të gjatë.

“Vështirësia në të mësuar” ose siç njihet edhe me një emër tjetër “Çrregullimet specifike të të mësuarit”, janë një burim serioz stresi për nxënësit në periudhën e arsimimit. Për këta fëmijë, jeta arsimore dhe shkalla e suksesit akademik formon një terren të rrëshqitshëm mendor. Sado që nxënësi të mundohet, nuk mund t’i bëjë ballë këtij problemi pa mbështetjen e specialistit.

Vështirësia në të mësuar është një gjendje e veçantë që zakonisht vërehet në një ose disa fusha së bashku. Të mësuarit e një fëmije me vështirësi dhe më ngadalë se moshatarët e tij në shkollën fillore, është një nga faktorët e parë dallues për diagnostikimin. Fëmija me çrregullime në të mësuar mund të hasë probleme në shkrim, lexim, në njërën, në të dyja ose në të tre fushat e aritmetikës. Në këto fusha vërehet një nivel përfitimi arsimor më

i ulët se moshatarët e tij.

Nxënësit që kanë vështirësi në të mësuar, shpeshherë të lexuarit e kanë të vonuar dhe nuk mund t’i ndjekin rreshtat që lexojnë. Në kushte normale, kur një individ lexon disa rreshta, ashtu siç po bëni edhe ju tani, mund t’i ndjekë fjalët nga e majta në të djathtë pa u munduar shumë, por një njeri te i cili ekziston vështirësia në të mësuar, nuk e ka qaq të lehtë t’i ndjekë fjalët njëra pas tjetres. Prandaj, ndërkohë që vazhdon të lexojë, mund të kalojë lart ose poshtë rreshtit që lexon. Mund të “hajë” ndonjë rrokje gjatë leximit, të kalojë ndonjë shkronjë ose t’i ngatërrojë me njëra-tjetrën. Fjalën



“lepur” mund ta lexojë “lepu”, fjalën “derë”, delë ose fjalën “mik”, “mit” etj. Prandaj për ata që kanë vështirësi në të mësuar, seancat e leximit mund t’u bëhen një torturë, ndërsa të kuptuarit e atyre që lexojnë t’u kthehet në një anktë.

Disa fëmijë të tjerë, edhe pse të lexuarit e kanë në rregull, nuk mundën ta kopjojnë drejtë në fletore detyrën e shkruar në dërrasën e zezë. Detyrën e faqes 69, mund ta shënojnë si detyrë të faqes 96. Te fëmija që ka çrregullim në të shkruar (dizgrafi), evident është fakti se shkrimi i tij i palexueshëm është i njëjtë me gabimet që ka në shkrim. Ata që kanë vështirësi në të shkruar zakonisht, ndërsa shkruajnë, e kanë të vështirë ta vazhdojnë rreshtin e nisur, kalojnë poshtë ose lart rreshtit, harrojnë të lënë hapësirë mes fjalëve. Shkronjave si ç, i, ë, etj., mund të harrojnë t’u vënë pikat dhe bishtat. E kanë të vështirë të kujtojnë vazhdimin e shkronjave ose numrave. Për ta shkronja p, d, b, nuk janë shumë të ndryshme nga njëra-tjetra. Ashtu siç përballemi në mënyrë të ndarë me problemet që shihen në fushën e leximit dhe shkrimit, këto dy probleme mund të shihen shpesh së bashku.

Vështirësia në të mësuar që dallohet në lidhje me aftësitë matematikore (diskalkuli) e vështirëson në të njëjtën mënyrë jetën shkollore të fëmijës. Në kushte normale, fëmija që ka marrë ose nuk ka marrë mësimë parashkollore, që ka arritur moshën për shkollën fillore dhe është rritur në qytet, për afërsisht nëntë numra i ka mësuar nga njerëzit përreth. Në sajë të tabelave që përdoren në jetën e përditshme, butonat e telekomandës, numrat e kateve në ashensor, numrat e dyerve, butonat e telefonit, fëmija që në moshë të hershme fillon t’i shohë numrat dhe me njohuritë që merr nga njerëzit përreth, mund ta bëjë lidhjen e këtyre numrave me emrat përkatës. Një fëmijë me diskalkuli mund të harxhojë një kohë më të gjatë për të mësuar kuptimin që shprehin numrat dhe shenjat matematikore. Pasi fillojnë shkollën, edhe pse e kuptojnë

p r o b l e -
mën në

orën e matematikës, kur fillojnë të kryejnë veprimet, humbin në të.

Ndërkohë që nga individët normalë veprimet “ $9 + 3$ ” dhe “ $6 - 3$ ” mund të llogariten lehtë si “12” dhe “3”, një fëmijë me diskalkuli të dy veprimet në pamjen e parë i koncepton të njëjta. Sidomos, ngaqë vështirësohen shumë në përllogaritjen e orës, përjetojnë shumë probleme në lidhje me takimet.

Në çdo fushë që mund të ekzistojë vështirësia në të mësuar, prindërit të cilët kërkojnë t’i mbështesin fëmijët e tyre në detyrat e shtëpisë apo përsëritjen e mësimëve, lodhen dhe shqetësohen shumë. Në këto raste prindërit zakonisht thonë se fëmijët e tyre kanë problemin e përqendrimit, se nuk i kushtojnë vëmendje të plotë asaj që lexojnë apo shkruajnë. Por vështirësia kryesore që kalon fëmija, përveç mungesës së vëmendjes është çrregullimi i të mësuarit. Çrregullimi i të mësuarit është një gjendje e veçantë dhe e ndryshme nga mungesa e vëmendjes.

Çrregullimi në të mësuar është një çështje që e pengon shfaqjen e aftësive të fëmijët dhe e prish përshtatjen e tyre me ambientin përreth. Kjo gjendje, ashtu siç ndikon negativisht te vetëbesimi i fëmijës, bëhet shkak edhe për dobësimin e marrëdhënieve shoqërore. Fëmijët të cilët ndihen të përjashtuar nga shoqëria, me kalimin e kohës mund të përdorin lëndë të dëmshme dhe t’i drejtohen shoqërisë së gabuar.

Çrregullimi i të mësuarit ashtu si të gjitha shqetësimet e tjera mund të shihet në nivele të ndryshme. Çrregullimet që kanë nivel të ulët ose mesatar, mund të rregullohen duke u trajtuar. Ndërsa te çrregullimet e rënda trajtimi është shumë i rëndësishëm, por për fat të keq personi që ka çrregullim të rëndë të të mësuarit, nuk e ka shumë të lehtë të shpëtojë plotësisht nga ky çrregullim.

Dy kriteret më të rëndësishme të cilët realizojnë suksesin në trajtim, janë diagnostikimi i hershëm dhe trajtimi i vazhdueshëm. Sa kohë që vazhdon trajtimi, nxënësit me çrregullim mund ta vazhdojnë jetën shkollore pa u vështirësuar dhe nuk e humbin vetëbesimin.

Fillimi më herët i sezonit mësimor nga fëmijët, do të mundësonte që të konstatoheshin më herët fëmijët me çrregullime në të mësuar dhe do të kishte një përfitim të rëndësishëm në trajtimin e këtij çrregullimi.

STUDIUESIT ZBULOJNË MIKROPLASTIKË NË 100% TË NJERËZVE TË MARRË NË STUDIM

Në studimin e parë të këtij lloji, studiuesit austriakë kanë ndjekur lëvizjen e mikroplastikës në sistemin e qenieve njerëzore. Rezultatet tregojnë se plastika që është një element i gjithëpranishëm në jetën tonë, është tani gjithashtu një element konstant në trupin e njeriut.

Hulumtimi u prezantua në në Vjenë të Austrisë, në takimin më të madh gastroenterologjik në Evropë, UEG Week.

NË GJURMËT E PLASTIKËS

Dy studiues austriakë, Dr. Philipp Schwabl me Universitetin Mjekësor të Vjenës dhe Dr. Bettina Liebmann me Agjencinë e Mjedisit në Austri studiuuan pjesëmarrës nga vende të ndryshme, përfshirë Finlandën, Italinë, Japoninë, Holandën, Poloninë, Rusinë, Britaninë dhe Austrinë.

Mikroplastikat janë grimca plastike me një madhësi më pak se 5 mm. Ato janë shpesh rruaza të vogla plastike që gjenden në shumë prodhime kozmetike. Disa vende, përfshi Shtetet e Bashkuara, Britaninë dhe Korenë e Jugut, kanë ndaluar produktet me këta përbërës. Por mikroplastika krijohet gjithashtu kur copa të mëdha të plastikës shpërbëhen me kalimin e kohës. Plastika në përgjithësi është kudo. Kombet e Bashkuara vlerësojnë se rreth 8 milion metra tonë plastike përfundon çdo vit në oqeanet e botës. Forumi Ekonomik Botëror vlerësoi se amerikanët hodhën mbi 33 milionë metra tonë plastike në vitin 2014.

Por ky studim i vogël, sugjeron se plastika, qoftë e keqe apo jo për shëndetin tonë, është tashmë e pranishme tek të gjithë ne.

Pjesëmarrësve në studim iu kërkua të mbanin një ditë ushqimor për shtatë ditë para se të merrnin pjesë në studim. Më pas ata dorëzuan mostra të jashtëqitjes tek studiuesit të cilët i analizuan për

përmbajtjen e mikroplastikës.

Çdo mostër testoi positive duke provuar presencën e mikroplastikës. Hulumtuesit identifikuan deri në nëntë lloje të ndryshme plastike.

Si hyn plastika në sistemin tonë? Në rastet e këtij studimi, plastika që u gjet tek njerëzit është e lidhur me ngrënien e ushqimeve të mbështjella me plastike apo pirja e lëngjeve nga shishet plastike. Por shumica e pjesëmarrësve gjithashtu kishin ngrënë peshk në dietën e tyre, kështu që Dr.Schwabl thotë se tani, "nuk mund të arrihet në një përfundim të saktë mbi origjinën e plastikës" në sistemin tonë. Nevojiten më shumë studime në të ardhshmen për ta përcaktuar saktësisht sesi hyn plastika në sistemin tonë.

SI NDIKON PLASTIKA NË SISTEMIN TONË?

A na bën keq prania e gjithë kësaj plastike në trup? Dr. Schwabl thotë se, tani për tani, nuk ka studime përfundimtare që sugjerojnë se plastika përbën rrezik për njerëzit. Por, ai thotë se "studimet e kafshëve kanë treguar se mikroplastika mund të shkaktojë dëmtim të zorrëve, pakësimin e aftësisë së absorbimit të hekurit dhe stresit hepatic".

Shqetësimi është se "çfarë do të thotë kjo për ne, dhe sidomos për pacientët me sëmundje gastrointestinale", thotë Dr. Schwabl. "Ndërsa përqendrimet më të larta të plastikës në studimet me kafshët janë gjetur në zorrë, grimcat më të vogla mikroplastike janë të afta të hyjnë në qarkullimin e gjakut, sistemin limfatik dhe madje mund të arrijnë deri në mëlçi". Studiuesit janë befasuar, që plastika duket të jetë e pranishme tek të gjithë ne dhe pret që sasia e mbledhur në trupin tonë të vazhdojë të rritet, nëse bota nuk ndryshon në mënyrë drastike përdorimin e plastikës.



UNIVERSI ËSHTË NJË HOLOGRAM

Gjatë ekzistencës së tij në këtë planet, fizikanti teorik, kozmologu dhe autori Stephen Hawking, dha shpjegime për disa nga fushat më të mëdha dhe më të mrekullueshme të shkencës, dhe jo vetëm.

Por duket se kontributi i tij vazhdon të na pasurojë edhe pas vdekjes së tij, në sajë të botimit të fundit të një dokumenti të ri në „Journal of High Energy Physics“.

Në veprën e tij të fundit Hawking ka sfiduar teoritë e mëparshme të inflacionit kozmik dhe multiversit, diçka për të cilën ai ka qenë gjithmonë i dyshues.

Mendimi i përgjithshëm i kozmologëve është se, një sekond pas Big Bang-ut, universi u zgjerua jashtëzakonisht shpejt para se të vendoset në gjendjen e tanishme, që përfshin yjet dhe galaktikat. Kjo teori njihet si inflacion, ose inflacion kozmik.

Disa shkencëtarë kanë propozuar që inflacioni në të vërtetë do të vazhdojë përgjithmonë, duke krijuar një “multiverse” në të cilën ka një larmi të universesh të ndryshme, secili me ligjet e veta fizike. Por Hawking nuk ishte fans i madh i „multiuniversit“. Këtë e deklaroi në një intervistë të mbajtur vitin e kaluar.

“Teoria e zakonshme e inflacionit të përjetshëm parashikon që globalisht universi ynë është si një dimension gjeometrik i pafund, me një mozaik universesh të ndryshme”, tha Hawking vjeshtën e kaluar.

“Ligjet e fizikës dhe të kimisë mund të ndryshojnë

nga një univers në tjetrin, të cilat së bashku do të formonin një multiverse, por unë kurrë nuk kam qenë një tifoz i multiversit. Teoria nuk mund të testohet.”

Në teorinë e tij të re, të cilën ai e punoi me kolegun belg Profesor Thomas Hertog, Hawking ka arritur të kapërcejë problemin e kombinimit të objekteve të Relativitetit të Përgjithshëm dhe inflacionit të vazhdueshëm. Del që ky është në thelb një variant i teorisë së holografisë.

Hawking dhe Hertog mendojnë se gjithësia është në të vërtetë e madhe dhe komplekse, ashtu si një hologram – dhe se realiteti 3D është një iluzion, pasi bota dhe dimensionet e kohës janë të projektuara nga informacioni i renditur në një sipërfaqe të sheshtë 2D.

Hertog tha: “Ekziston një ide shumë e saktë matematikore e holografisë që ka dalë nga teoria e vargut në vitet e fundit, e cila nuk është plotësisht e kuptueshme, por është e mrekullueshme”.

Duke u bazuar mbi inflacionin, teoria e sapo publikuar sugjeron se koha dhe ‘fillimi’ i universit u ngritën holografikisht nga një shtet i panjohur jashtë Big Bang-ut.

Ai tha: “Çështja kyçe është se ne nuk jemi duke projektuar një dimension hapësinor. Ne po e projektojmë dimensionin e kohës nga ‘para’ Big Bang-ut.”



VITAMINAT PËR ZEMRËN

6 MËNYRAT MË TË MIRA PËR T'I MARRË NËPËRMJET USHQIMIT

Suplementet e vitaminave po bëhen gjithnjë e më popullore në mesin e njerëzve që kërkojnë doza të shpejta të këtyre ushqyesve të nevojshëm.

Shumë njerëz marrin suplemente vitaminash edhe për të ulur rrezikun e sëmundjeve të zemrës.

Megjithatë, studimet shkencore konfirmojnë se marrja e këtyre suplementëve nuk luan asnjë rol në uljen e rrezikut të sëmundjeve të zemrës.

Studimet pohojnë se ulja e këtij rreziku mund të arrihet falë zgjedhjeve të zgjuara e të shëndetshme në ushqyerje.

Të dhënat rekomandojnë disa hapa të thjeshtë në përmirësimin e regjimit ushqimor për të përmirësuar shëndetin e zemrës.

SI TË PËRMIRËSONI SHËNDETIN E ZEMRËS ME VITAMINAT NGA USHQIMI

Shëndeti i zemrës përmirësohet falë:

Konsumit të rregullt të peshqve të pasur me acide yndyrore omega-3 dhe vitaminë D siç janë peshku ton apo salmon;

Ngrënia çdo ditë e arrorëve si arrat apo bajamet;

Ushqyerja me perime me ngjyrë të kuqe, portokalli dhe të verdhë siç janë karrotat dhe specat. Ato janë të pasura me vitamina të shëndetshme për zemrën dhe fibër;

Konsumi i fasuleve me ngjyrë të errët të cilat janë të pasura me vitaminë B, fibër dhe minerale të tjera të vyera;

Ngrënia e brokollit të freskët dhe pak të gatuar për të marrë më shumë vitaminat C dhe E.

Pirja e një gote me verë të kuqe herë pas here dhe ngrënia e çokolletës së zezë me të paktën 70 përqind kakao.

Një regjim i tillë i shëndetshëm dhe i shijshëm do i falë zemrës suaj shëndet dhe lumturi.



Studimet e fundit gjithashtu rekomandojnë ndjekjen e planit 5-10-8 që synon të minimizojë rreziqet e sëmundjes së zemrës dhe të garantojë një shëndet të mirë dhe afatgjatë të saj.

Gjeni më poshtë të shpjeguar në artikullin e formulën e jetëgjatësisë.

5 RACIONE FRUTA DHE PERIME

Ngrënia e pesë racioneve me fruta dhe perime në ditë është e domosdoshme për shëndetin e zemrës.

Në mëngjes mund të konsumoni një racion frutash dhe perimesh dhe më pas të konsumoni disa të tjerë gjatë vakteve.

Përzgjedhja e tyre është tërësisht në dorën tuaj.

10 MINUTA AKTIVITET FIZIK

Të kryeni çdo ditë të paktën 10 minuta aktivitet intensiv fizik në ditë.

Studimet kanë treguar se një aktivitet fizik për 60 deri në 90 minuta në javë e ul rrezikun e sëmundjeve të zemrës me 50 përqind.

8 ORË GJUMË

Cilësia e gjumit është shumë e rëndësishme për zemrën.

Ndonëse nevojat për gjumë të njerëzve janë të ndryshme, synoni të flini 8 orë gjumë të mirë dhe pa shqetësime.



NDRYSHIMET QË NDODHIN NË ORGANIZËM PAS LËNIES SË DUHANIT

Lënia e duhanit mund të jetë një sfidë e vërtetë, por njerëzit që kanë këtë varësi duhet të kenë një plan të zhvilluar mirë dhe duhet të bëjnë shumë përpjekje nëse duan të kenë sukses. Ajo që është interesante është se duhen vetëm disa orë për të parë ndryshimet.

Pra, sa më shpejt të ndaloni duhanin, aq më shpejt do të zvogëloni rrezikun e sëmundjeve serioze, si kanceri, sëmundjet e zemrës ose mushkërive dhe sëmundje të tjera të shkaktuara nga duhani. Sipas Medical News Today, vetëm 20 minuta pasi e keni lënë duhanin, presioni i gjakut kthehet në normalitet dhe qarkullimi fillon të përmirësohet.

Cigaret përmbajnë shumë toksina, duke përfshirë monoksidin e karbonit, i cili mund të jetë fatal në doza të mëdha dhe parandalon oksigjenin të arrijë në mushkëri dhe gjak. Kështu, 12 orë pas ndërprerjes së duhanit, trupi do të eliminojë monoksidin e tepërt të karbonit dhe niveli i oksigjenit në trup do të rritet. Ju gjithashtu do të flini më mirë, pasi duhanpirësit kanë katër herë më shumë gjasa të zhvillojnë çrregullime të gjumit sesa jo duhanpirësit.

Një ditë pasi të keni lënë duhanin, rreziku për të zhvilluar një atak në zemër do të fillojë të ulet. Gjithashtu, niveli i kolesterolit në gjak do të përshtatet dhe ushtrimet nuk do të duken më të vështira, sepse niveli i oksigjenit në trupin tuaj do të jetë më i lartë, gjë që do të lehtësojë aftësinë tuaj për të ushtruar.

Pirja e duhanit ndikon në mbaresat nervore përgjigjëse për shqisën e nuhatjes dhe shijes, kështu që pasi ta lini duhanin, do të vini re se ato do të jenë më të "mprehta". Nëse arrini të qëndroni larg cigares për një muaj, do të shihni që mushkëritë tuaja do të funksionojnë më mirë, nuk do të kolliteni dhe nuk do të keni probleme me frymëmarrjen. Qarkullimi i gjakut do të përmirësohet gjithashtu.



Ju ofron:
Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Logja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër
+355 67 47 39389

1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar

5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR

(djem dhe vajza)

NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË



“Allahu u ka dhënë
besimtarëve
dhuratë të madhe,
kur u solli një të dërguar
nga gjiri i tyre,
i cili ua lexon shpalljet e Tij,
i pastron nga gjynahet
dhe u mëson Librin e urtësinë,
edhe pse më parë,
me të vërtetë, ata ishin
në rrugë krejt të gabuar.”

(Alu Imran, 164)